

**GJYQËSORI** DHE TË  
**DREJTAT THEMELORE**  
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

**2015**

CIP – Katalogizim i publikimit

Biblioteka Nazionale dhe Universitare "Shën. Kliment Ohridski", Shkup

342.72/.73:340.14(497.7)

GJYQËSORI dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë / [autorë  
Neda Çallovska ... etj.]. - Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në  
Republikën e Maqedonisë, 2015. - 76 f. : ilustr. ; 26 cm

Fusnota në tekst. – Publikimi është në suazat e projektit: "Rrjeta 23". -Autorë: Neda  
Çallovska, Jasminka Gollubovska, Voislav Stojanovski, Aleksandar Jovanovski

ISBN 978-608-4790-00-6

1. Çallovska, Neda [Autor]

a) Të drejtat dhe liritë e njeriut - Legjislacioni - Maqedonia

COBISS.MK-ID 99117834

## **Botues**

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë

## **Për botuesin:**

Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev, Kryetar

## **Redaktor**

Dr. Malinka Ristevska Jordanova

## **Autorë**

Neda Çallovska

Mr. Jasmina Gollubovska

Dr. Voislav Stojanovski

Mr. Aleksandar Jovanoski

## **Përktheu:**

Jordana Shemko-Georgievska

## **Lekturë**

Gazmend Qoku

Ky publikim u mundësua me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të Projektit "Rrjeti 23", i cili u implementua përmes: Institutit për Politikë Evropiane; Qendrës për Menaxhimin me Ndryshime dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Qëndrimet e prezantuara në këtë publikim janë qëndrime të autorëve dhe çdoherë nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian. Projektin financiarisht e mbështeti edhe Mbretëria e Holandës.



Kingdom of the Netherlands

# PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE .....	4
HYRJE .....	5
Lista e Shkurtesave .....	8
PËRMBAJTJA .....	9
E KAPITULLIT 23 .....	9
Gjyqësori .....	9
Lufta kundër korrupsionit .....	11
Të drejtat themelore .....	12
Të drejtat e qytetarëve të Bashkimit Evropian .....	13
GJYQËSORI .....	14
Legjislacioni nacional .....	14
Kushtetuta e RM-së .....	14
Ligji për Gjykatat .....	14
Ligji për Këshillin për Verifikimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit .....	15
Ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë .....	15
Ligji për buxhetin e gjykatave .....	16
Ligji për shërbimin gjyqësor .....	16
Gjendja e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë analizuar nga aspekti i standardeve të Kapitullit 23 .....	17
Pavarësia .....	17
Buxheti Gjyqësor .....	23
Paanshmëria dhe përgjegjësia .....	24
Profesionalizmi, kompetenca dhe efikasiteti .....	26
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	28
Konkluzione .....	28
Rekomandime .....	29
TË DREJTAT E NJERIUT .....	30
Mbrojtja nga tortura dhe trajtimi ndëshkues, brutal, jonjerëzor ose përcmues .....	30
Respektimi i jetës private dhe familjare dhe komunikimit .....	31
Liria e bindjes, ndërgjegjes dhe fesë .....	33
Liria e shprehjes, duke përfshirë lirinë dhe pluralizmin e mediave .....	34
Liria e shprehjes .....	35
Liria e mediave dhe qasja deri te informacionet .....	35
Liria e tubimit dhe shoqërimit .....	40

Trajtimi i personave vulnerabil socialë, personave me aftësi të kufizuara dhe parimi i mosdiskriminimit .....	41
Barazia gjinore dhe të drejtat e grave .....	43
KONKLUZIONE DHE RREKOMANDIME .....	44
Konkluzione .....	44
Rekomandime .....	45
TË DREJTAT PROCEDURALE .....	47
Qëllimi dhe metodologjia .....	47
Rezyme e kornizës juridike të BE-së .....	47
E drejta e lirisë dhe sigurisë .....	49
Qasja e barabartë në drejtësi .....	50
E drejta e qasjes deri te avokati në procedurën penale .....	51
Direktiva 2013/48/BE për të drejtën e qasjes deri te avokati .....	52
E drejta e qasjes deri te avokati në procedurën penale të Republikës së Maqedonisë .....	54
E drejta e përkthyesit dhe interpretuesit në procedurën penale .....	57
Direktiva 2010/64/BE mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale .....	57
E drejta e përkthyesit dhe e interpretuesit në Republikën e Maqedonisë .....	59
E drejta e informimit në procedurë penale .....	60
Direktiva 2012/13/BE mbi të drejtën e informimit në procedurë penale .....	60
E drejta e informimit në procedurën penale të Republikës së Maqedonisë .....	62
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	63
Konkluzione .....	63
Rekomandime .....	64
ANEKSI I – Modeli indikativ i Letrës mbi të drejtat .....	66

Kapitulli “më i ri” – Kapitulli 23: Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore është më i rëndësishmi për aderim në BE; katalizator i procesit aderues. Me vendosjen e tij (në vitin 2005) kriteret politike hynë në negociata për anëtarësim në BE. Së bashku me Kapitullin 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria, e përbëjnë boshtin e “sundimit të së drejtës” në Strategjinë e BE-së për zgjerim dhe bazën e “qasjes së re” në negociatat për anëtarësim në BE. Me secilin shtet me të cilin zhvillohen negociata për anëtarësim në BE këta kapituj janë të parët që hapen, kurse mbyllen të fundit. Për ata të cilët nuk janë në negociata, përmbajtja e Kapitullit 23 po bëhet kusht gjithnjë dhe më i rëndësishëm për përparim të mëtejshëm në integrimin në BE. Në çdo rast, thelbi i tyre është miratimi i standardeve demokratike evropiane para anëtarësimit.

Republika e Maqedonisë, e cila dikur ka qenë pararendëse në vendosjen e standardeve demokratike evropiane në rajon, për fat të keq, tani mbetet në fund të bishtit. Në vend të “leksionit të mësuar”, Kapitulli 23 për ne tashmë u bë “leksion i përsëritur”.

Në kohën e botimit të këtij publikimi, Republika e Maqedonisë po ballafaqohet me një nga krizat më të vështira në historinë e vet. Ndikimi i vazhdueshëm i pushtetit ekzekutiv mbi organet dhe institucionet e tjera shtetërore çoi në kthimin pas në zhvillimin e standardeve demokratike, duke përfshirë edhe realizimin e të drejtave të njeriut. Nuk respektohet parimi i ndarjes së pushtetit, kurse partitë në pushtet kryejnë kontroll mbi institucionet shtetërore. Integriteti i institucioneve është rrënuar seriozisht. Përzjerja e drejtpërdrejtë e pushtetit qendror e rrënon pavarësinë e gjyqësorit. Përveç kësaj, është rrënuar seriozisht edhe sistemi i kontrollimit dhe korrigjimit, edhe pse është i vendosur në Kushtetutë dhe në ligje.


Zhvillimi i tillë negativ shpesh i përshkruhet perspektivës euroatlantike të bllokuar të Republikës së Maqedonisë. Narativi dominues, deri kohë më parë, i integritimit evropian e ka theksuar perspektivën për anëtarësim në BE si nxitje kryesore për ndryshime në shoqëri të cilat duhet të

sigurojnë më tepër liri, barazi dhe drejtësi. Sot, gjithnjë e më shumë po theksohet qëndrueshmëria – aftësia e shoqërisë që t’i ruajë dhe zhvillojë vlerat demokratike. Kjo nuk është e mundur pa një sektor civil të fuqishëm dhe të gjallë, i cili do të nxitë qytetari aktive dhe dialog të hapur.

Ky publikim është ndihmë në realizimin e rolit të sektorit civil si vlerësues vigjilent dhe korrigjues i politikave të Qeverisë në fushat e mbuluara me Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore. Ky është një perceptim i organizatave qytetare për realizimin e standardeve demokratike evropiane në Republikën e Maqedonisë, i mbështetur në monitorimin e strukturuar dhe evalvimin e politikave. Njëkohësisht, kjo analizë është fillimi i “raportit në hije” për Kapitullin 23 i cili do të botohet çdo vit. Shpresojmë se konkluzionet dhe rekomandimet do të ndihmojnë në gjetjen e rrugës drejt ruajtjes së zhvillimit të vlerave demokratike, ashtu siç janë garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Njëkohësisht, botimi i këtij publikimi është edhe një ftesë e hapur për dialog të vazhdueshëm publik me përfaqësuesit e tri degëve të pushtetit në Republikën e Maqedonisë, si edhe për përfshirjen e organizatave të tjera qytetare të cilat duan të kontribuojnë në realizimin e rolit të mbikëqyrjes së sektorit civil mbi pushtetin dhe nxitjen e qytetarisë aktive.

Analiza është hartuar në suazat e Projektit “Rrjeti 23”, financuar nga Bashkimi Evropian në suazat e Instrumentit për Mbështetje të Shoqërisë Civile, Programi për vitin 2013.



Qëllimi themelor i Projektit “Rrjeti 23” të cilin e realizuan Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime është një kontribut i strukturuar i shoqërisë civile në monitorimin dhe vlerësimin e politikave të përfshira në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore.

Nëpërmjet këtij projekti, në mënyrë transparente, u janë ndarë 10 grante organizatave të tjera qytetare të cilat zbatuan hulumtime dhe aktivitete të tjera si kontribut ndaj monitorimit dhe vlerësimit efektiv të politikave të përfshira në Kapitullin 23 të aderimit në BE:

Është përgatitur dhe botuar Metodologjia e monitorimit dhe evalvimit të politikave në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, e cila duhet të ndihmojë që përfaqësimi i politikave nga sektori civil në këtë fushë të bazohet në dëshmi dhe argumente.

Më në fund, Projekti rezultoi me krijimin e Rrjetit të Organizatave Qytetare – “Rrjeti 23”, themelues të së cilit janë dhjetë organizata qytetare. Rrjeti ka miratuar *Strategjinë dhe Kodeksin e vet*. Misioni i Rrjetit është që ai të jetë pjesëmarrës relevant në krijimin dhe monitorimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe në argumente, në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, nëpërmjet nxitjes së qytetarisë aktive.

## **Themelues të Rrjetit janë:**

Shoqata e Qytetarëve për Mundësi të Barabarta “Qasje e barabartë” – Shkup

Shoqata e Punëtorëve Financiarë në Pushtetin Lokal dhe në Ndërmarrjet Publike në Republikën e Maqedonisë – Veles

Shoqata “NOVUS” – Strumicë

Shoqata Sheshi Liria – Shoqatë për Aktivizëm, Teori dhe Art – Shkup

Instituti për Politikë Evropiane – Shkup

Instituti për të Drejtat e Njeriut – Shkup

Koalicioni “Të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara” – Shkup

Koalicioni “Të Gjithë për Gjykim të Drejtë” – Shkup

OJQ Infoqendra - Shkup

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë

Qendra për Strategji dhe Zhvillim “PAKTIS” - Prilep

Kjo Analizë është një prej rezultateve kryesore të Projektit “Rrjeti 23”. Ajo në të vërtetë është “raporti i parë në hije” i organizatave qytetare maqedonase mbi gjendjet në fushat e mbuluara nga Kapitulli 23 për aderimin në BE – Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore.

Analiza e ndjek strukturën e Kapitullit 23 për qasje aderuese në BE. Akoma më e rëndësishme është se me këtë analizë këmbëngulet të jepet përgjigje për gjendjet në Republikën e Maqedonisë në raport me kërkesat e acquis, duke përfshirë edhe standardet dhe praktikatat më të mira të BE-së. Edhe përkrah asaj se Republika e Maqedonisë nuk i ka filluar negociatat, struktura dhe përmbajtja e Kapitullit ishte bazë për harmonizimin me standardet dhe praktikatat e BE-së që kur u vendos ky Kapitull në vitin 2005, kurse me rëndësi thelbësore nga vetë fillimi i procesit të integritimit në BE, kur përmbajtjet e këtij Kapitulli ishin pjesë vetëm të kriterëve politike. Kjo është edhe struktura të cilën e ndjekin raportet e Komisionit Evropian për Përparimin e Republikës së Maqedonisë si edhe Programi Nacional për Miratimin e të Drejtës së BE-së.

Sfidë e rëndësishme dhe e njohur ishte të kontrollohet praktika, përkundrejt normatives. Prandaj insistohej që konkluzionet të mbështeten me dëshmi dhe argumente dhe të kenë bazë metodologjike. Konkluzionet e projekteve janë rezultat i hulumtimeve të zbatuara, ndërkaq janë përdorur shumë metoda: anketa e mendimit publik, mbikëqyrja, intervista, studime të rastit, analiza juridike, analiza të

shpenzimeve dhe fitimeve, etj. Të gjitha organizatat, të cilat kontribuuan në këtë analizë, u mbështetën në Metodologjinë për monitorim dhe vlerësim të politikave në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, trajnimet e zbatuara dhe mentorimi. Mandej, konkluzionet e tyre janë prezantuar në diskutime publike, që mundësoi jo vetëm shpërndarje të tyre por edhe kontrollim të tyre.

Në këtë Analizë janë vendosur konkluzionet e organizatave partnere në projekt, të cilat bazohen në mbikëqyrjen e rregullt dhe të strukturuar të këtyre organizatave të ngjarjeve që lidhen me Kapitullin 23. Ishin të dobishme sidomos konkluzionet e mbikëqyrjes së rregullt të lëndëve gjyqësore të cilën e kryen Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe raportet mujore të Komitetit për Gjendjen e të Drejtave të Njeriut në Republikën e Maqedonisë.

Në këtë Analizë janë vendosur konkluzionet e projekteve të zbatuara nga organizatat qytetare të cilave u janë dhënë grante në suazat e këtij Projekti:

- Instituti për të Drejtat e Njeriut: Këshilli i Pavarur Gjyqësor – Synime dhe Sfida
- Koalicioni “Të Gjithë për Gjykim të Drejtë”: Monitorim i implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë
- Shoqata e qytetarëve NOVUS: Pavarësia dhe objektiviteti i gjyqësorit në Komunën e Strumicës në përputhje me Kapitullin 23 – postulate të vendosur apo sfida për reforma
- Shoqata e Punëtorëve Financiarë në Pushtetin Lokal dhe Ndërmarrjet Publike (ShPF): Përcaktimi i burimeve të mjeteve financiare të pushtetit gjyqësor, madhësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor në RM
- Shoqata Qendra për Strategji dhe Zhvillim PAKTIS Media: Sistemi i masave alternative me theks të veçantë mbi gjendjen e implementimit në Komunën e Prilepit
- OJQ Infoqendra: A ekziston liria e shprehjes në Maqedoni?
- Sindikata e Pavarur e Gazetarëve në Maqedoni: (Mos) respektimi i të drejtave të punëtorëve në media

- Koalicioni “Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Grupeve të Margjinalizuara”: Analiza e mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi i bashkësive të marginalizuara në nivel lokal: Komuna e Manastirit, Komuna e Strumicës dhe Komuna e Qendrës
- Shoqata e Qytetarëve për Mundësi të Barabarta “Qasje e Barabartë”: Analiza e zbatimit të Ligjit për Ndhimë Juridike pa Pagesë duke përfshirë edhe analizën (cost-benefit analysis) e shpenzimeve për zbatimin e saj me fokus të veçantë mbi aspektin gjinor
- Shoqata Sheshi Liria – Shoqatë për Aktivizëm, Teori dhe Art – Shkup: Rugët e reja në Shkup dhe të drejtat themelore të qytetarëve.

Projektet kanë përfshirë hulumtime në një apo më shumë komuna në Republikën e Maqedonisë. Sidomos, ishin të rëndësishme hulumtimet dhe diskutimet në terren, midis subjekteve të tanguara edhe më gjerë, qytetarët.

Në Analizë janë përdorur edhe konkluzione të raporteve ndërkombëtare, na atë masë që ka qenë e domosdoshme për shkak të prezantimit të tërësisë dhe kompleksitetit të mbikëqyrjes dhe informimit për këto fusha.

Me këtë Projekt u mundësua edhe krijimi i internet mekanizmit MERC MK-BE Qendra e Resurseve për Kapitullin 23.<sup>1</sup> Ideja ishte që në një vend të gjenden të gjitha burimet dhe dokumentet relevante për Kapitullin 23, kështu që hulumtimi lehtësohet në masë të konsiderueshme. Njëkohësisht, ky mekanizëm do t'i mundësojë “Rrjetit 23” dhe të gjitha organizatave qytetare më gjerë dhe në mënyrë të strukturuar t'i publikojnë shtojcat e tyre për të gjitha përmbajtjet të cilat i përfshin ky Kapitull.

### **Kapitulli 23 është i ndarë në tri fusha të mëdha:**

- Gjyqësori;
- Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit;
- Të drejtat themelore.

Fokusi është vënë te Gjyqësori dhe të drejtat themelore, edhe pse fusha Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit

---

1 merc.org.mk



është e përfaqësuar si përmbajtje. Shkaku për këtë është se projektet e përzgjedhura janë kryesisht nga këto fusha, si dhe nga fakti se rrjetet e tjera tashmë japin kontribut të rëndësishëm në këtë fushë.

Analiza është strukturuar në tre kapituj:

- Përmbajtja e Kapitullit 23;
- Gjyqësori;
- Të drejtat themelore.

Në pjesën Përmbajtja e Kapitullit 23, shkurtimisht është pasqyruar *acquis*, duke përfshirë edhe standardet dhe praktikat më të mira, ashtu siç është prezantuar në hulumtimin analitik të *acquis*, si fazë e parë në negociatat për anëtarësim, kur vendoset niveli i harmonizimit të shtetit me *acquis*. Edhe pse Republika e Maqedonisë nuk i ka filluar negociatat, për të standardet e njëjta janë pikë referimi për monitorimin dhe vlerësimin nga institucionet e BE-së, si edhe në konceptimin e NPAA-së. Këtë Kapitull e përgatitën Mr. Aleksandar Jovanoski nga Instituti për Politikë Evropiane dhe Neda Çallovska nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë.

Në Kapitullin Gjyqësori është pasqyruar korniza kryesore ligjore në Republikën e Maqedonisë, kurse pjesa kryesore i është kushtuar analizës së gjendjeve në raport me standardet në fushën e: pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit dhe kompetencës. Pastaj vijojnë konkluzionet dhe rekomandimet. Autor i këtij kapitulli është Neda Çallovska nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë.


Në kapitullin Të drejtat e njeriut është dhënë një pasqyrë e veçantë për analizën e këtyre të drejtave, mbrojtja dhe respektimi i të cilave kanë qenë shumë aktuale dhe për të cilat janë zbatuar procedura përkatëse hulumtuese nga Rrjeti. Mandej vijojnë konkluzionet dhe rekomandimet. Këtë pjesë e ka punuar Mr. Jasmina Gollubovska nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar pjesës Të drejtat procedurale. Dr. Voislav Stojanovski nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë ka kryer

një analizë të thellë mbi harmonizimin e kornizës juridike të Republikës së Maqedonisë me direktivat përkatëse të BE-së, si edhe të praktikës, me ç'rast veçanërisht janë shfrytëzuar konkluzionet e mbikëqyrjeve të zbatuara të lëndëve gjyqësore. Për përmbajtjen e këtij kapitulli janë dhënë konkluzione dhe rekomandime të veçanta.


Kjo përpjekje e parë për "raport në hije" për Kapitullin 23 në Republikën e Maqedonisë do të jetë i rëndësishëm nëse në të ardhmen nxit dhe instalon sa më shumë konkluzione relevante të sektorit civil në Republikën e Maqedonisë dhe kontribuon për një dialog qenësor midis pushteteve dhe qytetarëve. Prandaj, janë të mirëseardhura të gjitha kritikët, vërejtjet dhe propozimet konstruktive.

Dr. Malinka Ristevska Jordanova



## Lista e Shkurtesave

GREKO	Grupi i Shteteve për Luftë kundër Korrupsionit
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
KPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Ndëshkues Jonjerëzor ose Përçmues
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KOO	Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit
KiE	Këshilli i Evropës
KGJRM	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë



# PËRMBAJTJA E KAPITULLIT 23

Përmbajtja e këtij Kapitulli është prezantuar sipas dokumenteve në dispozicion nga hulumtimi analitik i *acquis* (skrining) të shteteve të cilat kohë më parë e kanë kaluar këtë proces (Serbia dhe Mali i Zi), si edhe nga raportet e Komisionit Evropian.

Përmbajtja e Kapitullit 23 – Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore bazohet në nenin 2 të Marrëveshjes për Bashkimin Evropian, i cili mbështetet në parimet e dinjitetit njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këto parime janë të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe njëkohësisht janë të obligueshme edhe për shtetet kandidatë për anëtarësim. Neni 3 (2) i Marrëveshjes së Bashkimit Evropian dhe neni 67 (1) i Marrëveshjes për Funksionim të Bashkimit Evropian formojnë fushë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Politikat e BE-së, në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, kanë për qëllim ta mbështesin dhe përparojnë Bashkimin në këto fusha.

## Gjyqësori

Sundimi i së drejtës dhe e drejta e gjykimit të drejtë janë vendosur në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe vënë në pah se gjyqësia duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Kërkesat, në këtë drejtim, kanë të bëjnë me përkushtimin e shteteve në shmangien e ndikimeve të jashtme mbi organet gjyqësore dhe investimin e resurseve të caktuara financiare dhe të trajnimeve. Procedurat juridike dhe garancitë për gjykimin e drejtë duhet të respektohen në tërësi.

Standardet e BE-së në fushën e gjyqësorit bazohen në standardet e vendosura me dokumentet e OKB-së dhe në "drejtësinë e butë" të Këshillit të Evropës.

Nga dokumentet e OKB-së më të rëndësishme janë:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila në nenin 10 përcakton se secili ka të drejtë të tërësishtme të barabartë të gjykimit të drejtë dhe publik para një gjykate të pavarur dhe të paanshme e cila do të vendosë për të drejtat dhe obligimet e tij dhe për vërtetësinë e çdo padie penale kundër tij;<sup>2</sup>
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike<sup>3</sup>, i cili në nenin 14 përcakton se të gjithë njerëzit janë të barabarta para gjyqit. Çdo person ka të drejtë që rasti i tij të shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe publike para një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të vendosur me ligj që të vendosë qoftë për vërtetësinë e çdo akuze penale të ngritur ndaj atij personi, qoftë për aktëpadinë për realizimin e të drejtave dhe obligimeve qytetare të atij personi;
- Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në vitin 1985, ka përcaktuar një spektër me standarde të njohura si Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësisë, të cilat kërkojnë gjykatësit, individualisht dhe kolektivisht, t'i respektojnë funksionet gjyqësore dhe të synojnë ta përforcojnë dhe ta mbështesin besimin në sistemin gjyqësor dhe parashikojnë që gjykatësit me pushtet të tërësishtëm të veprojnë, të çliruar nga presionet dhe kërcënimet, të paguar mirë dhe të pajisur për kryerjen e obligimeve të veta.<sup>4</sup> Përveç kësaj, Komisioni për të Drejtat e Njeriut i OKB-së, më 23 prill 2003, ka miratuar Parimet e Bangalorit për Sjelljen e Gjykatave.

Dokumenti kryesor evropian është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ku sundimi i së drejtës është vendosur si themel i konventës në tërësi. Shtetet nënshkruese duhet ta garantojnë të drejtën e procedurës së drejtë gjyqësore (neni 6), sipas së cilës secilit duhet t'i shqyrtohen dhe përcaktohen, në mënyrë të drejtë dhe publike, në afat të arsyeshëm, para gjykatës së pavarur dhe të paanshme të vendosur me ligj, të drejtat dhe obligimet etij qytetare apo vërtetësia e cilado akuzave penale kundër tij.

2 Tekstin e tërësishtëm të Deklaratës mund ta lexoni në këtë link: <http://www.un.org/en/documents/udhr/>

3 Tekstin e tërësishtëm të Paktit mund ta lexoni në këtë link: <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

4 Parimet themelore të pavarësisë së gjykatave mund t'i lexoni në këtë link: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/IndependenceJudiciary.aspx>

Në suazat e Këshillit të Evropës janë miratuar një sërë dokumentesh të cilat i përmbajnë parimet për gjyqësorin, gjykatësit dhe prokurorët publikë:

- Rekomandime të Këshillit Evropian SM/Prep (2010)12 nga Komiteti i Ministrave për vendet anëtare për gjykatësit: pavarësi, efikasitet dhe përgjegjësi;
- Rekomandime të Këshillit Evropian Prep (2000) 19 për rolin e prokurorit publik në sistemin penal;
- Karta Evropiane për Statusin e Gjykatësve (1998);
- Magna Karta për Gjykatësit (parimet themelore) (2010);
- Drejtimit Evropiane për Etikën e Sjelljes së Prokurorit Publik (Drejtme të Budapestit, të miratuara në Konferencën e Prokurorëve të Evropës më 31 maj 2005).

Në përputhje me këto standarde janë vendosur kërkesat e Kapitullit 23 të aderimit në BE në fushën e gjyqësorit:

**Pavarësia e gjyqësorit** trajtohet si pavarësi e jashtme dhe e brendshme. Pavarësinë e jashtme e vendos lidhja midis pavarësisë së gjykatësve dhe parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit. Aspektet e saj kryesore janë ndarja kushtetuese e pushtetit dhe raporti me mediat. Pavarësia e brendshme nënkupton pavarësi të çdo gjykatësi në kryerjen e funksionit të gjykatësit, pa asnjë lloj kufizimi, ndikimi jopërkatës, presioni, kërcërimi apo përzjerje nga cilido pushtet, duke përfshirë edhe brenda në gjykatë, në marrjen e vendimeve.

Fokus primar i jepet pozitës së profesionit të gjykatësit dhe prokurorit publik, kohëzgjatjes së mandateve të tyre, rregullave të qarta dhe transparente për zgjedhje, përparim dhe shkarkim. Në këtë kontekst me rëndësi të veçantë është vendosja, përbërja dhe funksionimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Kapaciteti administrativ dhe pavarësia përkatëse buxhetore janë parakushtet kryesore për sigurimin e rezultateve të qëndrueshme dhe afatgjata prej reformave të zbatuara në gjykata.

**Paanshmëria dhe përgjegjësia** nënkupton veprim profesional për lëndët e dhëna dhe sigurim të integritetit të profesionit. Duhet të sigurohet parandalim i konfliktit

të interesave nëpërmjet rregullave për tërheqje. Është i rëndësishëm sistemi i shpërndarjes së lëndëve – me zgjedhje të rastësishme apo sipas rendit të përcaktuar, si edhe rregullat për tërheqjen e ndonjë lënde. Respektimi i kodeksit të etikës së gjykatësve dhe prokurorëve publikë është gjithashtu relevante në këtë fushë. Sipas standardeve të Këshillit të Evropës, përgjegjësia disiplinore e gjykatësve duhet të jetë pa ndikime të jashtme apo të brendshme, sjellja e cila është çështje e përgjegjësisë disiplinore duhet të jetë e përcaktuar qartë, procedura e zbatuar sipas rregullave të përcaktuara, të ketë të drejtë ankimi, kurse trupat të cilët vendosin të mbajnë përgjegjësi.

Në fushën e **profesionalizmit, kompetencë dhe efikasitetit** është me rëndësi sistemi konsistent i trajnimit të gjykatësve dhe prokurorëve publikë. Kjo nënkupton rol të fuqishëm të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë dhe qëndrueshmëri financiare të sistemit të vendosur për mësim të vazhdueshëm dhe shpërblim të gjykatësve dhe prokurorëve publikë. Në aspektin e efikasitetit, indikatorë të rëndësishëm janë kohëzgjatja mesatare e lëndëve, lëndët e mbetura, si dhe numri i lëndëve të cila mbahen një kohë më të gjatë. Integrimi i teknologjive të reja TIK, ndjekja e statistikës gjyqësore dhe sigurimi i qasjes elektronike në praktikën gjyqësore nacionale janë elementë të rëndësishëm të cilët kontribuojnë mbi profesionalizmin dhe efikasitetin e gjyqësisë.

Në suazat e Këshillit Evropian funksionojnë trupa këshillëdhënës të cilët vendosin standarde dhe e mbikëqyrin zbatimin e tyre.

Komiteti i Ministrave të Këshillit Evropian e ka themeluar **Këshillin Konsultues të Gjykatësve Evropianë (KKGJE)**, si trup këshillëdhënës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e gjykatësve, Kurse qëllimi i **Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë**, është përparimi i efikasitetit dhe funksionimi i të drejtës në shtetet anëtare të KE-së.

## Lufta kundër korrupsionit

Vendet anëtare të BE-së duhet të sigurojnë luftë efektive kundër korrupsionit i cili është një kërcënim serioz ndaj stabilitetit të institucioneve demokratike dhe sundimit të së drejtës. Neni 83 (1) i marrëveshjes për Funkcionim të Bashkimit Evropian e përcakton kompetencën e Bashkimit që të përcaktojë minimum rregulla në përkufizimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e korrupsionit. Konventa për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkësisë Evropiane, e vitit 1995, dhe Konventa për Luftë kundër Korrupsionit në të cilin përfshihen persona zyrtarë të BE-së apo shtete anëtare, e vitit 1997, bazohen në nenin KP (2, c) të Marrëveshjes së Bashkimit Evropian. Kështu fokusi zgjerohet te bartësit e funksioneve publike në Bashkësinë Evropiane dhe te vendet anëtare dhe kërkohen mekanizma efektivë, proporcionalë dhe të drejtë në ligjet penale në luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, është i rëndësishëm Vendimi Kornizë i vitit 2003 për ndalimin e korrupsionit në sektorin privat. Në BE, në vitin 2008, është themeluar Rrjeti i Personave për Kontakt kundër Korrupsionit.

Korniza juridike solide dhe institucionet e përgjegjshme janë kushti themelor në krijimin e politikës koherente në parandalimin dhe shkatërrimin e korrupsionit.

Pritet pronësi politike dhe institucionale në luftën kundër korrupsionit dhe arritjes së një shkalle të lartë të koordinimit të institucioneve nacionale. Ndiqet udhëheqja politike dhe institucionale dhe zbatimi i Strategjisë Nacionale për Luftë kundër Korrupsionit dhe insistohet të sigurohet dosje e suksesit. Në përputhje me qasjen e re dhe përmbajtjen e Kapitullit, strategjitë duhet të sigurojnë koordinim horizontal mbi kontrollin e aktiviteteve politike të pushtetit (sidomos gjatë kohës së procesit të zgjedhjeve), të shpërndarjes së financave publike, privatizimit dhe partneritetit privat-publik, gjyqësorit, policisë, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, shëndetësisë, arsimit dhe sportit, duke i përfshirë edhe mediat. Kapacitetet administrative në institucione, pavarësia në procedurat dhe mjetet përkatesë të buxhetit janë indikatorë kryesorë të kësaj fushe. Gjithashtu, ndiqet sistematikisht puna dhe zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, sidomos në parandalimin e konflikteve të interesit dhe kontrollimin e deklaratave mbi pronësinë të personave të funksioneve publike. Çështje të

rëndësishme janë kontrolli i financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore, mbrojtja e dëshmitarëve të mbrojtur nga institucionet për korrupsion potencial dhe bashkëpunimi horizontal me organizatat joqeveritare.

Në pjesën e kornizës ligjore ndërkombëtare dhe vendase matet përparimi i harmonizimit me legjislacionin e BE-së dhe me instrumentet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Konventën Penale-Juridike kundër Korrupsionit dhe Konventën Qytetare-Juridike kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës, Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit, Konventën e OKB-së kundër Krimit të organizuar Transnacional, Konventën e OECD-së për luftë kundër blerjes së bartësve të huaj të funksioneve publike në transaksionet afariste ndërkombëtare, si dhe transponim me Direktivën 2014/42/BE për ngrirje dhe konfiskim të pronës të fituar padrejtësisht dhe procedurat penale në Bashkimin Evropian. Me rëndësi është sukcesi dhe qëndrueshmëria e implementimit.

Veçanërisht ndiqet zbatimi i legjislacionit nacional, në aspektin e dispozitave për blerje, dispozitave të veçanta gjatë procesit zgjedhor, mashtimit dhe përvetësimit të mjeteve publike, pastrimit të parave, keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimeve zyrtare, keqpërdorimeve të procesit të furnizimeve publike etj.

Mekanizëm i rëndësishëm i KE-së në luftën kundër korrupsionit është **Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GREKO)**,<sup>5</sup> i themeluar në vitin 1999, për të përmirësuar kapacitetin e shteteve anëtare për luftë kundër korrupsionit nëpërmjet monitorimit të harmonizimit të tyre me standardet antikorrupsion të KE-së nëpërmjet një procesi dinamik të evalvimit të ndërsjellë.

Nga aderimi i saj në vitin 2000, Republika e Maqedonisë është objekt i evalvimit në suazat e rrethit të Parë (në dhjetor 2002) të Dytë (në tetor 2005), të Tretë (mars 2010) dhe të Katërt (dhjetor 2013) të evalvimit nga GREKO. Rrethi i katërt i evalvimit nga GREKO, i cili filloi më 1 janar 2012, merrej me "ndalimin e korrupsionit në raport me anëtarët e Parlamentit, gjykatësit dhe prokurorët". Me përzgjedhjen e kësaj teme, GREKO hapi një fushë të re, duke theksuar

5 Më tepër mbi kompetencat e GREKO mund të gjeni në këtë link: [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default_en.asp)

gjatë kësaj karakterin multidisiplinor të kompetencës së vet. Njëkohësisht, kjo temë ka lidhje të qarta me punën e mëparshme të GREKO-s, sidomos me rrethin e saj të parë të evalvimit, i cili ka vënë një theks të fuqishëm mbi pavarësinë e gjyqësisë.<sup>6</sup>

## Të drejtat themelore

Në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes së Bashkimit Evropian për praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, Bashkimi i respekton të drejtat themelore siç janë garantuar me Kartën për të Drejtat Themelore të BE-së. Garantimi dhe përparimi i të drejtave themelore është parimi themelor i të drejtës së Bashkimit dhe njëkohësisht është rezultat i traditave të përbashkëta kushtetuese të vendeve anëtare. Këto parime janë të obligueshme për institucionet e Bashkimit në kryerjen e autorizimeve të tyre dhe për shtetet anëtare të Bashkimit në zbatimin e të drejtës së Bashkimit (Neni 15 i Kartës për të Drejtat Themelore të BE-së). Mbrojtja e të drejtave themelore i mbulon të drejtat qytetare tradicionale, siç janë e drejta e jetës, ndalimi i torturës dhe trajtimit degradues, e drejta e sigurisë dhe lirisë, vendosja e kufizimeve të përcaktuara qartë për përdorim të arrestimit, e drejta e lirisë, e drejta e fjalës dhe e drejta e tubimit dhe shoqërimin. Bashkimi Evropian e garanton jetën private dhe mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me Direktivën e BE-së 95/46/EK të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Mbrojtjen e Qytetarëve, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, Vendimi Kornizë 2008/977, për mbrojtjen e të dhënave personale, ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale në suazat e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në materien penale, kurse Direktiva 2002/58/EK për përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e telekomunikacionit (Direktiva për Privatësi dhe Komunikim Elektronik).

Legjislacioni i BE-së në fushën e të drejtave themelore e garanton barazinë. Ekziston ndalim i përgjithshëm i diskriminimit në shumë baza, sidomos barazia gjinore, kurse dallimet kulturore, fetare dhe gjuhësore duhet të

respektohen. Mandej, të drejtat e fëmijës kanë nevojë për mbrojtje të veçantë. Përmbajtja e këtyre të drejtave buron nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, e cila është ratifikuar nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit. Në përputhje me nenin 21 të Kartës për të Drejtat Themelore të BE-së, diskriminimi kundër përfaqësuesve të pakicave kombëtare është i ndaluar. Legjislacioni në fushën e të drejtave themelore përmban garanci të shumta dhe të rëndësishme juridike.

Në përputhje me Kartën për të Drejtat Themelore të BE-së, niveli i mbrojtjes së të drejtave me këtë Kartë në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë më i vogël se ai i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore. Me Marrëveshjen e Lisbonës, Bashkimi Evropian merr obligimin për të vepruar sipas Konventës.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe të Lirive Themelore siguron respektim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë nga shtetet nënshkruese, duke përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë, por edhe kontroll efikas në rast të kufizimit të tyre. Me qëllim që të sigurohet respektim i obligimeve që për shtetet nënshkruese dalin nga kjo Konventë dhe protokollet e saj, janë baza e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), e cila ka ndikim të veçantë në respektimin e sundimit të të drejtës në shtetet nënshkruese. Domethënë, vendimet e GjEDNJ-së të cilat vënë në dukje shkeljen e të drejtave të qytetarëve, sipas ankesës së dorëzuar paraprakisht në gjykatë, duhet të implementohen nga shtetet nënshkruese në mënyrë që përveç kompensimit të dëmit, i cili duhet t'i jepet viktimës, shteti duhet ta ndryshojë edhe praktikën e shkeljes së të drejtave ose të bëjë ndryshime në legjislacion, me qëllim që të përcaktojë të drejtë të caktuar ose të parashikojë mekanizëm për mbrojtjen e saj.

Trupa të rëndësishëm të cilët veprojnë në fushën e demokracisë dhe të drejtave të njeriut janë:

- **Komisioni i Venecias** - trup këshillëdhënës i Këshillit të Evropës për çështje që lidhen me kushtetutshmërinë dhe demokracinë. Roli i Komisionit të Venecias është të sigurojë ndihmë juridike për shtetet anëtare dhe, sidomos, t'i ndihmojë shtetet të cilat dëshirojnë t'i përshtatin strukturat e tyre juridike dhe institucionale,

6 Të gjitha raportet e GREKO-s për evalvim të Republikës së Maqedonisë gjenden në këtë link:[http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default_en.asp)

në përputhje me standardet evropiane dhe me përvojën ndërkombëtare në fushën e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit. Komisioni punon në tri fusha: a) institucionet demokratike dhe të drejtat fundamentale; b) e drejta kushtetuese dhe e zakonshme; c) zgjedhje, referendume dhe parti politike. Komisioni i Venecias ka dhënë shumë mendime për propozime të akteve juridike në Republikën e Maqedonisë.<sup>7</sup>

- **Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Ndëshkues, Jonjerëzor ose Përçmues (KPT)**, themeluar me Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Jonjerëzor ose Përçmues në vitin 1989, ka vendosur sistem të mbikëqyrjes, nëpërmjet vizitave të drejtpërdrejta në burgje dhe institucione të tjera për personat të cilëve u është kufizuar liria dhe dorëzimit të raporteve të rregullta me rekomandime.
- Në suazat e **OKB-së**, janë me rëndësi të veçantë **Këshilli për të Drejtat e Njeriut** (i cili ndjek Komisionin për të Drejtat e Njeriut), **Komisari i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut** dhe komisionet e veçanta për lloje të caktuara të drejtash, të cilat e mbikëqyrin zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare, nëpërmjet raporteve të shteteve anëtare, i diskuton dhe nxjerr raporte dhe rekomandime për to.

## Të drejtat e qytetarëve të Bashkimit Evropian

Kjo fushë e Kapitullit 23 ka të bëjë me të drejtën e votës dhe mundësinë e qytetarit që të kandidohet në zgjedhjet e Parlamentit Evropian dhe në Zgjedhjet Lokale, të drejtën e lëvizjes së lirë dhe jetesës në territorin e Bashkimit dhe të drejtën e mbrojtës diplomatike dhe konsullore. Këto të drejta janë zakonisht objekt i negociatave në fazat e fundit të aderimit të shteteve candidate.

---

<sup>7</sup> Më tepër mendime të Komisionit të Venecias mund të lexoni në këtë link: <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?country=37&year=all>

# GJYQËSORI

## Legjislacioni nacional

Kornizën juridike në Republikën e Maqedonisë e përbëjnë Kushtetuta, dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet dhe aktet nënligjore.

### Kushtetuta e RM-së

Një prej vlerave themelore të Republikës së Maqedonisë është sundimi i së drejtës dhe ndarja e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 8). Koncepti i ndarjes së pushtetit është me rëndësi të veçantë për sigurimin e shtetit juridik, sepse respektimi i këtij koncepti duhet të sigurojë pavarësi dhe autonomi në punën e të gjitha organeve të pushtetit, në suazat e kompetencave të tyre, pa ndikime dhe presione midis tyre, jashtë nga marrëdhënie të cilat janë rregulluar me ligj. Në bazë të këtij parimi bazohet edhe pavarësia dhe autonomia e gjyqësorit në shtetin tonë.

Në Kushtetutën e RM-së (neni 98) është përcaktuar se gjykata e kryejnë pushtetin gjyqësor në mënyrë të pavarur dhe autonome dhe gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Nuk ekziston kufizim kohor në kryerjen e funksionit të gjykatësit. Themelimi, kompetenca, llojet, ndërprerja, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si edhe procedura para tyre përcaktohen me ligj i cili miratohet me dy të tretat e shumicë së votave në Kuvend. Këto ligje duhet të jenë në funksion të garancive institucionale për pavarësi dhe autonomi të sistemit gjyqësor. Në përputhje me Kushtetutën, funksioni i gjykatësit është inkompatibil me ushtrimin e ndonjë funksioni dhe profesioni tjetër publik ose me anëtarësimin në ndonjë parti politike. Ndalohet organizimi dhe veprimtaria politike në gjykatë.

Në vitin 2005 kanë ndryshuar nenet kushtetuese të cilat lidhen me gjykatën, sidomos me procedurën e emërimit dhe shkarkimit të gjykatësve, e cila nga Kuvendi i RM-së ka kaluar te Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë. Shumica e anëtarëve të Këshillit (8 nga 15) i zgjedhin gjykatësit nga radhët e veta, por në punën e tij, sipas

funksionit, merr pjesë edhe ministri i Drejtësisë. Anëtarësimi i tij nuk ka të drejtë vote, por megjithatë pjesëmarrja e tij nga opinioni perceptohet si përzjerje e pushtetit ekzekutiv në atë gjyqësor.

### Ligji për Gjykatat<sup>8</sup>

Është miratuar me qëllim që ta mbrojë konceptin e gjyqësisë së pavarur dhe autonome, Ligji për Gjykatat e rregullon organizimin dhe kompetencën e gjykatave, zgjedhjen e gjykatësve dhe të gjykatësve-porotë, të drejtat, obligimet dhe imunitetin e gjykatësve, ndërprerjen dhe shkarkimi, nga funksioni i gjykatësit, administratën gjyqësore dhe të jurisprudencës. Përveç kësaj, e rregullon parimisht edhe sistemin gjyqësor informatik, shërbimin gjyqësor, policinë gjyqësore dhe mjetet e punës.

Ky Ligj përcakton se gjykatat në Republikën e Maqedonisë janë organe shtetërore të pavarura dhe autonome, duke e përcaktuar edhe kompetencën gjyqësore dhe rëndësinë e funksionit gjyqësor, raportin e ndërmjetshëm dhe komunikimin me pushtetet e tjera shtetërore, si edhe raportin me qytetarët. Me Ligjin për Gjykatat është përcaktuar se procedurat para gjykatës rregullohen me ligje të veçanta dhe bazohen mbi parimet e: ligshmërisë dhe legjitimitetit, barazisë së palëve, gjykimin në afat të arsyeshëm, drejtësisë, publikut dhe transparencës, kontradiktore, dyshkallësisë, fjalës, menjëhershëmisë, të drejtës së mbrojtjes, përkatësisht të përfaqësimit, vlerësimit të lirë të dëshmimeve dhe ekonomisë.

Me Ligjin për Gjykatat parashikohet edhe procedura e zgjedhjes, përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore, si edhe shkarkimit të gjykatësve dhe gjykatësve-porotë, e cila është në kompetencë të Këshillit Gjyqësor të RM-së. Në nenin 43 të Ligjit është paraparë se gjatë përzgjedhjes së gjykatësve dhe gjykatësve porotë nuk duhet të kryhet diskriminim në bazë gjinie, race, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes sociale dhe kombëtare, bindjes politike dhe fetare, pozitës shoqërore dhe pasurore, si edhe se duhet të sigurohet përfaqësim përkatës dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha bashkësive.

8 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 61/2008, 118/2008, 16/2009, 150/2010 dhe 39/2012.



Për përzgjedhjen e gjykatësit janë paraparë kushte të veçanta dhe të përgjithshme, të cilat varen nga gjykata për ku ka konkuruar gjykatësi. Një nga kushtet e përgjithshme për përzgjedhjen e gjykatësit është edhe rezultati i testeve për integritet dhe testimet psikologjike të cilat i kryen Këshilli Gjyqësor i RM-së.

Kushtet e veçanta parashikojnë kualifikime të nevojshme në varësi të shkallës dhe llojit të gjykatës. Gjykatës në gjykatën themelore mund të zgjidhet person i cili e ka përfunduar trajnimin fillestar në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, kusht i cili ka nisur të zbatohet nga 1 janari 2013. Gjykatësi në gjykatën e apelit duhet të ketë përvojë pune minimum katër vjet pa ndërprerje të stazhit të gjykatësit si gjykatës në gjykatën themelore ose gjykatës në Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Lartë Administrative. Gjykatësi në Gjykatën Administrative nevojitet të ketë minimum katër vjet pa ndërprerje të stazhit të gjykatësit si gjykatës në gjykatën themelore ose pesë vjet stazh me punë juridike në ndonjë organ shtetëror. Gjykatësi në Gjykatën e Lartë Administrative nevojitet të ketë minimum tre vjet stazh pa ndërprerje si gjykatës në Gjykatën Administrative ose person i cili ka gjashtë vjet stazh me punë juridike në ndonjë organ shtetëror. Për gjykatës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune minimum gjashtë vjet stazh të pandërprerë si gjykatës në Gjykatën e Apelit ose si gjykatës në Gjykatën Administrative ose në Gjykatën e Lartë Administrative. Kushtet e veçanta për përzgjedhje të gjykatësve në gjykata e apelit dhe në Gjykatën Supreme kanë filluar të zbatohen nga 1 korriku i vitit 2013.

Për gjykatës-porotë mund të zgjidhet shtetas i moshës madhore i Republikës së Maqedonisë, i cili ka përfunduar minimum arsimin e lartë, i cili e zotëron në mënyrë aktive gjuhën maqedonase, gëzon reputacion në kryerjen e këtij funksioni dhe nuk është më i vjetër se 64 vjet. Gjykatësi-porotë për gjykim të të miturve zgjidhet nga radhët e personave me përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve. Gjykatësi-porotë zgjidhet në afat kohor prej katër vjetësh dhe mund të rizgjidhet përsëri.

## **Ligji për Këshillin për Verifikimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit<sup>9</sup>**

Në shkurt të vitit 2015, Kuvendi i RM-së e miratoi Ligjin për Këshillin për Verifikimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit. Këshilli për Verifikimin e Fakteve është paraparë si trup i ri juridik, i cili do të ketë si qëllim të marrë pjesë në punën e Këshillit Gjyqësor të RM-së. Kompetenca kryesore e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve do të jetë ngritja e procedurës disiplinore dhe procedurës për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të gjykatësve para Këshillit Gjyqësor të RM-së. Këshilli për Verifikimin e Fakteve mund t'i refuzojë iniciativat për përcaktimin e përgjegjësisë, pas kësaj vendimi i tij bëhet përfundimtar, përkatësisht iniciativat e rrëzuara nuk do të shqyrtohen fare nga Këshilli Gjyqësor i RM-së. Këshilli për Verifikimin e Fakteve do të përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët duhet të jenë me patjetër juristë në pension edhe atë: 3 gjykatës, 3 prokurorë publikë, 2 profesorë të së drejtës dhe 1 avokat. Përveç faktit që të gjithë anëtarët duhet të jenë të pensionuar, ata duhet të kenë edhe 15 vjet stazh të pandërprerë, të kenë rezultate të njohura në punën e vet dhe të mos jenë të sanksionuar për disiplinë. Mandati i anëtarëve të zgjedhur është katër vjet dhe nuk kanë të drejtë të rizgjidhen. Minimum 1/3 e anëtarëve është parashikuar të jenë nga radhët e përfaqësuesve të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kandidatët për në Këshillin për Përcaktimin e Fakteve paraqiten në shpalljen publike, kurse zgjidhen nga të gjithë gjykatësit me zgjedhje të fshehta dhe të drejtpërdrejta.

## **Ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë<sup>10</sup>**

Në aspektin e sigurimit të pavarësisë sa më të madhe të gjyqësorit, nëpërmjet konceptit të profesionalizmit dhe efikasitetit, është me rëndësi të veçantë Ligji për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë. Qëllimi i themelimit të këtij institucioni është sigurimi i veprimtarisë profesionale, të pavarur, të paanshme dhe efikase të gjykatësve dhe

9 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.20 , 12.2.2015

10 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 20, 12.2.2015

prokurorëve publikë, por edhe kryerja me profesionalizëm dhe efikasitet të shërbimeve profesionale në gjyqësor dhe në prokurorinë publike. Akademia organizon dhe zbaton trajnim të vazhdueshëm të shërbimeve profesionale në gjyqësor dhe prokurorinë publike, si dhe trajnim të të gjitha subjekteve të cilat marrin pjesë në zbatimin ligjeve nga fusha e gjyqësorit, në kryerjen e veprimtarisë analitike në fushën e teorisë dhe praktikës së gjyqësorit.

## Ligji për buxhetin e gjykatave

Me rëndësi të veçantë për sigurimin e pavarësisë së gjykatave dhe gjykatësve është pavarësia e tyre financiare. Në vitin 2003 është miratuar Ligji për buxhetin e gjykatave, nëpërmjet të cilit sigurohet financimi i gjykatave, gjykatësve, Këshillit Gjyqësor në RM dhe financimi i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë. Për kryerjen e punëve në lidhje me buxhetin gjyqësor formohet Këshilli Gjyqësor i Buxhetit, i cili përbëhet nga kryetari dhe dhjetë anëtarë. Kryetar i Këshillit Gjyqësor të Buxhetit është kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë. Zëvendës i tij është kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës. Anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Buxhetit, janë ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës Supreme në RM, kryetari i Gjykatës Administrative, kryetarët e gjykatave të apelit, dy kryetarët e gjykatave themelore sipas rendit të përcaktuar në Ligjin për Gjykatat dhe drejtori i Akademisë për Trajnimin e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Në punën e Këshillit Gjyqësor të Buxhetit marrin pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Financave, por pa të drejtë vendimmarrjeje.

## Ligji për shërbimin gjyqësor<sup>11</sup>

Me Ligjin për shërbimin gjyqësor rregullohen të drejtat, obligimet, përgjegjësitë e nëpunësve gjyqësorë, sistemi i rrogave dhe kompensimeve të rrogave të nëpunësve gjyqësorë.

Shërbimin gjyqësor e përbëjnë nëpunësit gjyqësorë, persona të punësuar në gjykata të cilët kryejnë punë teknike dhe ndihmëse dhe policia gjyqësore. Nëpunësit gjyqësorë janë persona me status të nëpunësit administrativ. Me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të shërbimit gjyqësor është formuar Këshilli i Shërbimit Gjyqësor të cilin e përbëjnë 11 anëtarë.

Punësimi i nëpunësve gjyqësorë kryhet nëpërmjet shpalljes publike, avancimi nëpërmjet publikimit të shpalljes interne dhe mobiliteti nëpërmjet shpërndarjes dhe marrjes.

Për zgjedhjen e kandidatëve nga konkursi publik formohet Komision për Përzgjedhje për Punësim. Procedura e përzgjedhjes për punësim përbëhet nga përzgjedhja administrative për punësim, provimi për nëpunës gjyqësorë, kontrolli i besueshmërisë së dëshmive dhe intervista, si edhe testi për personalitetin. Kandidati për nëpunës gjyqësor jep provimin për nëpunës gjyqësor. Provimi për nëpunës gjyqësor përbëhet nga dy pjesë: pjesa profesionale dhe pjesa për vlerësim të kapacitetit të kandidatit.

Avancimi i nëpunësve gjyqësorë bëhet nëpërmjet shpalljes interne, kurse qëllimi është t'u mundësohet nëpunësve gjyqësorë avancimi në karrierë, përkatësisht kalimi nga një vend pune me nivel më të ulët në një vend pune me nivel më të lartë, përkatësisht titull më të lartë.

Mobiliteti është lëvizja horizontale e të punësuarit nga një vend pune në tjetër, në suazat e të njëjtit grup të vendeve të punës të përcaktuar me këtë ligj. Mobiliteti kryhet nëpërmjet shpërndarjes, përkatësisht marrjes së të punësuarit në vend pune në nivel të njëjtë, përkatësisht vend pune për të cilin i punësuarit i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara me aktin

11 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/2014, 33/2015 dhe 98/2015

e sistematizimit të vendeve të punës në gjykatën e cila shpërndan dhe merr. Mobiliteti kryhet pa publikim të shpalljes interne, përkatësisht shpallje publike.

Sa i përket përgjegjësisë, nëpunësi gjyqësor është personalisht përgjegjës për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës që ia jep vendi i punës dhe për shkeljen e detyrës zyrtare nëpunësi gjyqësor, përveç administratorit gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore. Përgjegjësia për veprën penale të kryer, përkatësisht për shkeljen nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të nëpunësit gjyqësor.

## **Gjendja e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë analizuar nga aspekti i standardeve të Kapitullit 23**

Parimi themelor i Kushtetutës së Maqedonisë është ndarja e pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe sundimi i së drejtës, që duhet të realizohet nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve nga gjykatat e pavarura. Dispozitat e tilla kushtetuese edhe më pas duhej të përparonin me miratimin e zgjidhjeve ligjore përkatëse, me të cilat duhej të garantohej pavarësia dhe profesionalizmi i gjyqësorit.

Në 25 vjetët e kaluar janë miratuar një numër i madh ligjesh, por edhe amendamentesh të Kushtetutës, me qëllim që të plotësohen standardet e Bashkimit Evropian në pjesën e gjyqësorit, por edhe të mbrohen në mënyrë përkatëse të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe ndërkombëtarisht. Zgjidhjet ligjore hapën mundësi për realizim të gjyqësorit të pavarur, sidomos nga ndikimi i pushtetit ekzekutiv. Në këtë kontekst, me rëndësi të veçantë është zgjedhja e gjykatësve e cila në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me nenin 38 paragrafin 1 të Ligjit për Gjykatat, është pa kufizim kohor të mandatit. Krahasuar me bartësit e tjerë të funksioneve publike, paga e gjykatësve në Republikën e Maqedonisë është relativisht e lartë dhe duhet të kontribuojë në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.

Megjithatë, implementimi dhe zbatimi i zgjidhjeve ligjore mbeti problem me të cilin gjyqësori ballafaqohej që në fillim.

## **Pavarësia**

Sistemi gjyqësor është ende një prej problemeve kryesore me të cilat ballafaqohet Republika e Maqedonisë, sidomos për arsye se edhe pas 25 vjetësh shteti nuk ka arritur të sigurojë sundimin e së drejtës dhe ndarjen e pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ndikimi i pushtetit ekzekutiv mbi gjyqësorin është i pranishëm ende, sidomos vitet e fundit dhe sidomos në lëndët gjyqësore të cilat publiku i njeh si "lëndë politike" siç janë rastet kundër Jovan Vranishkovski dhe përfaqësuesve të Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit, gazetarit Tomisllav Kezharovski, mjekut Dejan Stavriq, kryetarit të Këshillit të Komunës Qendër Miroslav Shipoviq, drejtorëve të disa shkollave në Gostivar dhe dhjetëra ish-funksionarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të lustruar si demok bashkëpunëtorë të regjimit komunist.<sup>12</sup>

Realiteti për partizimin e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, për mosrespektimin e parimit të sundimit të së drejtës dhe mosekzistimi i ndarjes së pushtetit u vërtetua edhe në xhirimet e bisedave të funksionarëve të lartë shtetërorë, të cilat në publik janë nxjerrë nga lideri i Lidhjes Social-Demokratike të Maqedonisë. Domethënë, duke filluar nga 9.2.2015, Lidhja Social-Demokratike e Maqedonisë ka mbajtur 36 pres-konferenca ku janë publikuar informacione se shërbimet shtetërore, në mënyrë të paligjshme, i kanë ndjekur komunikimet e mbi 20.000 qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, si dhe një pjesë të funksionarëve në Qeveri dhe persona të afërm të tyre kanë kryer një numër të madh veprash penale, të cilat lëvizin nga rrezikimi i sigurisë deri në keqpërdorimin e pozitës zyrtare, shoqërim kriminel dhe mashtrim zgjedhor me përmasa të mëdha.<sup>13</sup> Nga bisedat e publikuara një pjesë kishin lidhje edhe me mënyrën se si pushteti ekzekutiv ndikon mbi përzgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve publikë, por edhe si dakordohen vendime për raste të veçanta gjyqësore. Bisedat e publikuara shtesë japin indikacione për lidhjen e pushtetit ekzekutiv me Prokurorin Publik të Republikës

12 Më tepër detaje për këto lëndë gjyqësore mund të lexoni në Raportin Vjetor të Komitetit të Helsinkit për vitin 2013 që gjendet në këtë link: [http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/681/Helsinki\\_Godisen\\_2013.pdf](http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/681/Helsinki_Godisen_2013.pdf)

13 Bisedat e publikuara mund t'i dëgjoni të gjitha në këtë link: <https://www.youtube.com/user/SDSMtube>

së Maqedonisë. Bisedat e tilla nuk kontestohen vetëm nga aspekti gjyqësor por edhe nga aspekti i të drejtave themelore të qytetarëve, sidomos e drejta e privatësisë, nëse vërtetohen të dhënat se janë ndjekur në mënyrë të paligjshme më tepër se 20.000 qytetarë të Republikës së Maqedonisë.<sup>14</sup> Keqpërdorimi i autorizimeve nga DSK-ja dhe shfrytëzimi i sistemit për përgjim për qëllimet e partisë në pushtet është konstatuar edhe në Raportin e grupit ekspert të Komisionit Evropian, i cili vëren mangësi serioze në pesë fusha: ndjekje e komunikimeve, mbikëqyrje e jashtme të trupave të pavarur, gjyqësor, zgjedhje dhe media.<sup>15</sup> Në pjesën e gjyqësorit është konstatuar se ekziston qasje seleksionuese dhe ndikim politik në të gjitha aspektet – nga momenti i zgjedhjes së gjykatësve dhe prokurorëve publikë, procedurat gjyqësore, vlerësimi i gjykatësve, shkarkimi i gjykatësve, funksionimi i Këshillit Gjyqësor, transparenca e përzgjedhjes dhe shkarkimit të gjykatësve, funksionimi i sistemit për shpërndarje të lëndëve.

Procedura për vlerësim vjetor të gjykatësve ndikon pozitivisht mbi efikasitetin në veprimtarinë e tyre, por në të njëjtën kohë e rrezikon kompetencën e gjykatësve dhe sigurinë juridike të qytetarëve. Sistemi i vlerësimit lidhet më tepër me ndjekjen e punës së gjykatësve, në aspektin e shpejtësisë së veprimit dhe marrjes së vendimit, në vend të kompetencës dhe i vendosur në këtë mënyrë ndikon veçanërisht në ngritjen e karrierës së gjykatësve, sepse mund të jetë bazë për ngritje të përgjegjësisë disiplinore ose për shkarkim. Konstatimi i tillë është dhënë edhe në Raportin e Komisionit Evropian mbi Përparimin e shtetit për vitin 2014 me rekomandime konkrete për ndryshim të tij, por akoma nuk janë propozuar ndryshime ligjore në këtë pjesë. Sipas hulumtimit të Shoqatës NOVUS nga Strumica të zbatuar në suazat e Projektit "Rrjeti 23" "Vlerësimi të gjykatësit përjetohet si "konkurs" midis tyre se cili do ta përfundojë vitin me sa më pak aktvendime të anuluar apo të ndryshuara".

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë ka funksionuar tre muaj pa kryetar, përkatësisht mandati të skaduar të

kryetarit dhe në atë periudhë nuk janë mbajtur mbledhje (12 dhjetor 2014 deri 13 mars 2015).<sup>16</sup> Më në fund, në mars është zgjedhur kryetari i Këshillit Gjyqësor, i cili nuk është nga radhët e gjykatësve dhe për të cilin, në Kuvend dhe opinion, gjatë zgjedhjes së tij si anëtar i Këshillit është bërë pyetja për plotësimin e kriterit "jurist i shquar".

Në prill të vitit 2015 Këshilli Gjyqësor ka zgjedhur katërmëdhjetë kryetarë të gjykatave, për herë të parë sipas procedurës së ndryshuar – kryetarët e gjykatave zgjidhen vetëm nga radhët e gjykatësve, të cilët janë vlerësuar më mirë në dy vitet e fundit, kështu që zgjedhja e ngushtuar e kandidatëve kryhet automatikisht. Kriteret e caktuara ligjore për stazh janë shumë të vogla që të krijohet përfaqësimi për gjykatës të mirë, kurse edhe më pak mjedisi rrethues e percepton për gjykatës i cili do të japë drejtime në gjykatat më të ulëta.

Ekzistojnë dyshime se sistemi i ri, i vendosur për zgjedhje/avancim të gjykatësve, nuk i vendos kandidatët në pozitë të njëjtë. Avancimi i gjykatësve nuk bazohet në procedurë tërësisht transparente dhe kriteret objektive. Sipas këndvështrimeve të caktuara, "kriteret e caktuara ligjore për stazh janë shumë të vogla që të krijohet përfaqësimi për gjykatës të mirë, kurse edhe më pak mjedisi rrethues e percepton për gjykatës i cili do të japë drejtime në gjykatat më të ulëta". Tashmë ekziston mjet juridik për kandidatët e pakënaqur – gjykatësi në procedurë për zgjedhje të gjykatësve. Kontestues është edhe përcaktimi i integritetit të gjykatësit vetëm në bazë të testimi për integritet dhe jo nga puna e tij e përgjithshme.<sup>17</sup>

Sa i përket **besimit të qytetarëve në gjyqësor**, Avokati i Popullit, në Raportin më të ri për vitin 2014, konstatoi rritje të mosbesimit duke thënë se "të dhënat statistikore dëshmojnë se procedurat në gjykatat e shkallës së parë zgjasin shumë vite, që në të vërtetë është shkelje e të drejtës së gjyqimit në afat të arsyeshëm.<sup>18</sup> Në shumicën e rasteve, qytetarët ankohen për zgjatjen e madhe të procedurave në

14 Më tepër detaje në pjesën Të drejtat themelore – E drejta e jetës private dhe familjare dhe komunikimet në këtë analizë.

15 Raportin e tërësishtëm të grupit ekspert të Komisionit Evropian mund ta lexoni në këtë link: [http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/newsfiles/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/newsfiles/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)

16 Të dhëna nga ueb-faqja e KGJRM; <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx>

17 Nga diskutimi në Konferencën përmblylëse të këtij projekti, të mbajtur më 9 korrik 2015.

18 Raportin e plotë të Avokatit të Popullit për vitin 2014 mund ta lexoni në këtë link: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2014/GI%202014.pdf>

Gjykatën Administrative, pastaj në procedurat civile, në të cilat parashtruesit kërkojnë realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të caktuara pronësore, përkatësisht të drejtave dhe interesave statusore, kurse më pak për procedurat penale të shkallës së parë. Është i madh numri i ankesave ku qytetarët ankohen se vendimet e gjykatës janë marrë me paragjykim nga gjykatës joprofesionalë, nën presion ose me korrupsion. Qytetarët, në ankesat e tyre, kërkojnë nga Avokati i Popullit ta rishqyrtojë punën e gjykatësve dhe t'i ndryshojë vendimet e tyre." ... "Të dhënat nga puna me lëndë, gjithashtu, dëshmojnë se në vitin raportues numri i ankesave, lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore para gjykatave të shkallës së dytë është rritur dukshëm, kurse ankesat për Gjykatën Supreme janë në nivel të njëjtit me vitin e kaluar."

Hulumtimi i ri i Komitetit të Helsinkit për njohjen e qytetarëve me të drejtat e njeriut dhe me mekanizmat për mbrojtjen e tyre vë në pah mosbesimin e qytetarëve ndaj gjykatave në mbrojtjen e të drejtave të tyre.<sup>19</sup> Pyetja e fundit ka të bëjë me institucionet, në të cilat mund të kërkohet mbrojtja nëse të anketuarit konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e njeriut. Sipas të dhënave, të anketuarit (gjithsej 1001 të anketuar) më së shpeshti Avokatin e Popullit (27%) e konsiderojnë si institucion ku mund të kërkojnë mbrojtje nëse u janë shkelur të drejtat e njeriut. Nuk është i vogël besimi që të anketuarit e kanë shfaqur edhe për organizatat joqeveritare të cilat merren me të drejtat e njeriut (15%) dhe avokatët me 14%. Nga të dhënat e marra mund të vërehet se të anketuarit kanë treguar besim më të ulët ndaj gjykatave sa i përket kësaj çështjeje, përkatësisht vetëm me 11%.


Kjo vërtetohet edhe në analizën e Shoqatës së Qytetarëve NOVUS nga Strumica, e cila në suazat e Projektit "Rrjeti 23" ka bërë analizë të pavarësisë dhe objektivitetit të gjyqësorit në Komunën e Strumicës në përputhje me Kapitullin 23. Pyetjes "A keni besim në sistemin gjyqësor të Komunës së

**Strumicës**", përgjigjet nga 258 qytetarë vënë në dukje se vetëm 6% e të anketuarve kanë besim të tërësishëm në sistemin gjyqësor në Komunën e Strumicës, kurse pothuajse gjysma e tyre (42%) nuk kanë aspak besim tek ai, që është një përqindje e madhe dhe mendimi i tillë i qytetarëve është shqetësues.

Mosbesimi ekziston edhe sa i përket pavarësisë së Këshillit Gjyqësor të RM-së, si organ për përzgjedhjen dhe shkarkimin e gjykatësve në vend. Në analizën për punën e Këshillit Gjyqësor të RM-së, të realizuar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut në kuadër të këtij Projekti<sup>20</sup> qytetarët, në pjesën më të madhe, janë shprehur se përzgjedhja e gjykatësve nuk është objektive, se gjatë përzgjedhjes së gjykatësve kryhet presion mbi Këshillin Gjyqësor dhe kjo ndodh më shumë nga pushteti ekzekutiv. Në pyetjen **A mendoni sipas jush personalisht se përzgjedhja e gjykatësve nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është objektive?** shihet një përqindje e lartë e qytetarëve të cilët janë përgjigjur se përzgjedhja e gjykatësve nga KGJRM-ja nuk është objektive (58,9%). Vetëm 38,2% të qytetarëve të anketuar mendojnë se procesi është objektiv.

**Grafiku 1: Përgjigje në pyetjen "A mendoni sipas jush personalisht se përzgjedhja e gjykatësve nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është objektive?";**

Burimi: Instituti për të Drejtat e Njeriut, "Analiza e pavarësisë së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë – synim dhe sfida"




19 Hulumtimi është kryer nga Viktorija Borovska, Kalina Leçevska, Ana Bilazheva nga Instituti për Shkenca Shoqërore dhe Humaniste, në suazat e projektit "Zmadhimi i transparencës dhe përmirësimi i sundimit të së drejtës nëpërmjet ndjekjes dhe informimit për shkeljen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë", të mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni. Analizën e plotë mund ta lexoni në këtë link: [http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/902/strazuvanje\\_Razbiranje\\_na\\_covekovi\\_prava\\_MK\\_EN\\_AL.pdf](http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/902/strazuvanje_Razbiranje_na_covekovi_prava_MK_EN_AL.pdf)

20 Me anketën të cilën e zbatoi Agjencia Rejtjng, janë përfshirë 1200 të anketuar nga 80 komuna, me spektër reprezentativ të të gjitha bashkësive etnike, mjedisve dhe rajoneve urbane dhe rurale. Anketa është kryer në periudhë nga 22-25 dhjetor 2014. Gabimi i mundshëm statistikor +/-4,3%. Analizën e tërësishme mund ta lexoni në këtë link: <http://www.ihr.org.mk/images/pub/analiza-za-ssrm-konecna.pdf>

Përqindja e qytetarëve shqiptarë të cilët janë përgjigjur se përzgjedhja e gjykatësve nuk është objektive është në lartësi prej 72%, kurse tek maqedonasit 54%. Vetëm 23% e shqiptarëve dhe 43% e maqedonasve konsiderojnë se përzgjedhja e gjykatësve është objektive.

Në lidhje me pyetjen **A e kryen sipas jush përzgjedhjen e gjykatësve KGjRM-së nën presion**, një përqindje e madhe qytetarësh të RM-së (56%) konsiderojnë se KGjRM-ja e kryen përzgjedhjen e kandidatëve për gjykatës nën presion. 23,5% e tyre mendojnë se përzgjedhja kryhet në, presion të tërësishtëm, kurse 32,7% konsiderojnë se përzgjedhja kryhet kryesisht nën presion. Vetëm 39% e qytetarëve konsiderojnë se përzgjedhja nuk kryhet nën presion. Për pyetjen **Kush ndikon mbi pavarësinë dhe autonominë e punës së KGjRM-së**, e cila iu parashtrua atyre të cilët për pyetjen e mëparshme janë përgjigjur se faktorë të caktuar të jashtëm ndikojnë mbi pavarësinë dhe autonominë e KGjRM-së. Përqindja më e madhe e qytetarëve, përkatësisht 52,5% janë përgjigjur se pushteti është ai që kryen ndikimin më të madh. 31,2% janë përgjigjur se të gjithë njëjtë, 5,6% se opozita kryen ndikim dhe 2,8% nuk kanë mendim në lidhje me këtë çështje.

**Grafiku 2:** Përgjigjet në pyetjen: Kush ndikon më shumë mbi pavarësinë dhe autonominë e punës së KGjRM-së? Burimi: Instituti për të Drejtat e Njeriut, "Analiza e pavarësisë së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë – synim dhe sfida"



Është theksuar edhe problemi i mostransparencës së gjykatave. Ueb-faqet ekzistuese të gjykatave nuk mundësojnë kërkim të lehtë të lëndëve. Përveç kësaj, në fillim të këtij viti, ueb-faqet e gjykatave nuk kanë funksionuar më tepër se dy muaj, sepse paska pasur procedurë për furnizim publik.

Grantistët e Projektit "Rrjeti 23" hasën në probleme serioze në marrjen e informacioneve për gjyqësinë. Madje edhe kur Komisioni për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik mori vendim që të sigurohet qasja, kishte raste që ai të mos respektohej.<sup>21</sup> Shumica e gjykatave/gjykatësve, të cilët ishin objekt të hulumtimit ose të cilëve u ishin dërguar pyetësorë (madje edhe anonimë), nuk dhanë informacione, përkatësisht nuk kanë dhënë përgjigje. Përveç kësaj, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, nga qershori i vitit 2014, ka marrë vendim të mos transmetohen në mënyrë audio dhe vizuale mbledhjet e Gjykatës.

Republika e Maqedonisë ka marrë nota negative në gjyqësor në të gjitha raportet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe raportet e Komisionit Evropian, sidomos në Raportin e vitit 2014, ku është theksuar se "ekzistojnë dyshime në dhe jashtë shtetit për ndikimin e mundshëm politik në procese të caktuara gjyqësore" si edhe se "nuk është zgjidhur ende çështja për mangësitë e sistemit të tanishëm për karrierë të gjykatësve edhe pse ekziston kërcënim potencial se ata e përfaqësojnë pavarësinë e gjykatësve".<sup>22</sup> Të ngjashme janë edhe vërejtjet e Stejt Departamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili në Raportin për të drejtat e njeriut për vitin 2013 thekson se në shtet ekziston problem me të drejtën e gjykimit të drejtë dhe me procedurat para gjykatave, sidomos për shkak të presionit politik dhe frikës prej Qeverisë me qëllim që të ndikohet mbi gjyqësorin.<sup>23</sup> Vërejtjet e tilla janë konstatuar edhe nga GREKO, i cili në raportin e vitit 2013 ka konstatuar se nuk janë respektuar dispozitat ligjore të cilat duhet të merren parasysh gjatë përzgjedhjes së gjykatësve dhe me të cilat është përcaktuar se 50% e gjykatësve të rinj të zgjedhur duhet të jenë nga radhët e studentëve të diplomuar në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.<sup>24</sup> Gjithashtu, thuhet se

21 I tillë është rasti me kërkesën e Institutit për të Drejtat e Njeriut për Gjykatën Supreme për dorëzim të vendimeve për ankesë për përgjegjësi disiplinore, përkatësisht për shkarkim të gjykatësve.

22 Raportin e tërësishtëm për përparimin e Republikës së Maqedonisë të Komisionit evropian mund ta lexoni në këtë link: [http://www.sep.gov.mk/data/file/Progres%20Report%202014/Izvestaj%20MK\\_PROV\\_10\\_10\\_2014.pdf](http://www.sep.gov.mk/data/file/Progres%20Report%202014/Izvestaj%20MK_PROV_10_10_2014.pdf)

23 Raportin e tërësishtëm të Stejt Departamentit mund ta lexoni në këtë link: <http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm#wrapper>

24 Raportin e tërësishtëm mund ta lexoni në këtë link: [http://www.pravda.gov.mk/documents/Izvestaj%20na%20GRECO%20za%20eval%20na%20RM\\_Cetvrt%20krug\\_mk.pdf](http://www.pravda.gov.mk/documents/Izvestaj%20na%20GRECO%20za%20eval%20na%20RM_Cetvrt%20krug_mk.pdf)

është informuar nga burime të ndryshme se nepotizmi dhe ndikimi politik luajnë ende një rol të rëndësishëm në praktikë. Problemi me pavarësinë e gjyqësorit është konstatuar edhe në konkluzionet përfundimtare mbi përparimin e shtetit në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të dhëna nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në vitin 2013 gjatë shqyrtimit të Raportit periodik universal, ku kishte disa rekomandime për gjyqësorin që të mbrohet nga ndikimet politike.<sup>25</sup>

Në Raportin për përparimin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2014, Komisioni Evropian rekomandon që "Praktika e Këshillit Gjyqësor në lidhje me procedurat disiplinore dhe procedurat për shkarkim duhet të jetë më proporcionale dhe më transparente. Çështja e rezultateve të dobëta të gjykatësve duhet të shqyrtohet së pari nëpërmjet masave korrigjuese, siç janë përmirësimi në organizatë dhe trajnime, sesa shkarkime. Shkarkimi duhet të kufizohet me sjelljen jokompetente konstante në punë dhe duhet të zbatohet vetëm nëse më parë janë shqiptuar dënime më të lehta disiplinore, siç janë paralajmërimet dhe zvogëlimi i rrogës, të cilat momentalisht përdoren rrallë." Edhe vërejtjet e GREKO-s janë në këtë drejtim, rekomandon se shkarkimi i gjykatësit është i mundshëm vetëm në raste shumë serioze të sjelljes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme, por duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat e rastit. Një pjesë e rekomandimit ka të bëjë me nevojën e heqjes së sanksionit për shkarkimin e gjykatësit në rastet kur konstatohet vetëm shkelje e gjykimit në afat të arsyeshëm. Në pjesën e procedurës disiplinore për gjykatësit rekomandohet që të rishqyrtohen dispozitat ligjore në mënyrë të tillë që shkeljet të jenë lëndë të procedurës së pavarur disiplinore, kurse duke i marrë parasysh parimet e pavarësisë së gjykatave, trupi që duhet ta iniciojë procedurën dhe të kryejë hetim, në lidhje me procedurën disiplinore, duhet të jetë i ndarë nga trupi që vendos për sanksionet.

## Vështrim i Ligjit për Këshillin për Verifikimin e Fakteve

Duke u nisur nga rekomandimet e tilla, shteti vendosi të formojë Këshillin për **Verifikimin e Fakteve**, si trup të ri në sistemin gjyqësor, i cili duhet të iniciojë procedurë disiplinore dhe procedurë për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të gjykatësve para Këshillit Gjyqësor të RM-së. Ligji, me të cilin u përcaktua formimi i këtij trupi, është miratuar me procedurë të shkurtër, pa debat publik dhe pa përfshirjen e opinionit ekspert. Për shkak të mënyrës së miratimit të këtij Ligji, por edhe për shkak të dispozitave ligjore kontestuese, sidomos në pjesën e zgjedhjes së anëtarëve të këtij trupi, shfaqet përsëri dyshimi a është qëllimi mundësimi i pavarësisë më të madhe apo hapja e një mundësi tjetër për ndikim mbi gjyqësorin?

Ky Ligj është kontestues në shumë aspekte. Së pari, mundësia që Këshilli për Verifikimin e Fakteve të rrëzojë iniciativa dhe vendimi i tillë i tij të jetë përfundimtar është në kundërshtim me Amendamentin XXIX të Kushtetutës së RM-së, ku është përcaktuar se një pjesë e kompetencave të KGJRM-së janë ndjekja dhe vlerësimi i punës së gjykatësve dhe të vendos për përgjegjësinë e tyre disiplinore. Këshilli Gjyqësor i RM-së nuk do të ketë mundësi t'i shqyrtojë iniciativat e rrëzuara kështu që ankesat kundër një numri të madh të gjykatësve do të përfundojnë para Këshillit për Verifikim të Fakteve. Roli i tillë i Këshillit për Verifikimin e Fakteve nuk është kushtetues, duke marrë parasysh se ky organ, për dallim nga Këshilli Gjyqësor i RM-së, nuk është paraparë në Kushtetutën e RM-së. Si rrjedhim nga ky ligj do të suspendohet një pjesë e kompetencave kushtetuese të Këshillit Gjyqësor të RM-së. Së dyti, kushti që vetëm gjykatësit, prokurorët, profesorët dhe avokatët që janë në pension mund të jenë anëtarë të Këshillit për Verifikimin e Fakteve është i barabartë me diskriminimin e drejtpërdrejtë në bazë të moshës që është në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se secili, në kushte të njëjta, ka në dispozicion çdo vend pune. Së treti, ligjvënësi, në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare (neni 52) të Ligjit, ka paraparë se përzgjedhja e parë e anëtarëve të Këshillit për Verifikimin e Fakteve do të kryhet nga Komisioni i formuar nga Këshilli Gjyqësor i RM-së, në përbërje prej pesë anëtarëve. Si dispozitat paraprake ashtu edhe këto dispozita nuk janë kushtetuese sepse në kompetencat e

25 Raportin e tërësishëm dhe rekomandimet mund t'i lexoni në këtë link: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G14/053/66/PDF/G1405366.pdf?OpenElement>

parapara me Kushtetutë, të Këshillit Gjyqësor të RM-së nuk është parashikuar funksioni i tij zgjedhor, e aq më pak vetëm nga ana e vetëm 1/3 e anëtarëve të tij. Në këtë mënyrë i jepen kompetenca të reja jokushtetuese Këshillit Gjyqësor të RM-së, kurse suspendohet vullneti i të gjithë gjykatësve të cilët anëtarët e Këshillit për Verifikimin e Fakteve mund t'i zgjedhin vetëm pas përbërjes së tij të parë. Në lidhje me kompetencën e Këshillit për Verifikimin e Fakteve që të diskutojë për zvarritjen e procedurave gjyqësore ajo nuk është shumë e qartë në raport me kompetencën e dhënë të Gjykatës Supreme të RM-së, e cila vendos sipas lëndëve për shkëlqen e së të drejtës në afat të arsyeshëm në mbajtjen e procedurave gjyqësore. Konsiderojmë se nuk ekziston nevoja për përcaktimin e një kompetence të këtuilë paqartë, aq më tepër kur vendimi gjyqësor në këtë fushë është i mjaftueshëm dhe relevant. Kompetenca e Këshillit për Verifikimin e Fakteve, që të diskutojë "për zë të prekur" që trajtohet si iniciativë për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme është e paqartë dhe e përcaktuar shumë gjerësisht duke i dhënë kompetencë si të Prokurorit Publik. Mjafton që Prokurori Publik të ndërmarrë veprimtari për "zë të prekur" duke marrë parasysh se gjithsecili mund të paraqitet si iniciator para Këshillit për Verifikimin e Fakteve, me qëllim që ai të ndërmarrë veprime në interes të përcaktimit të gjendjeve. Kompetenca e dhënë Këshillit për Verifikimin e Fakteve që të veprojë edhe sipas informatave të pranuar për punën e gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave është kompetencë e paqartë dhe jo e tërësishme, duke e marrë parasysh atë që u tha më sipër se, gjithsecili mund të paraqitet si iniciator që të ndërmarrë veprim të Këshillit për Verifikimin e Fakteve. Në kompetencat e Këshillit për Verifikimin e Fakteve është përcaktuar edhe shqyrtimi i raporteve të Këshillit Gjyqësor të RM-së mbi punën e gjykatësve dhe gjykatave në Republikën e Maqedonisë, por është e paqartë se në ç'bazë dhe cili është shkaku për dhënien e kësaj kompetence, si dhe qëllimi për një shqyrtim të tillë. A nuk vendoset në këtë mënyrë kontrolli mbi punën e Këshillit Gjyqësor dhe a nuk vihet në pikëpyetje pavarësia e tij e përcaktuar Ligj që të ketë cilësinë e organit të pavarur gjyqësor.<sup>26</sup>

26 Analizën për funksionimin e Këshillit për Përcaktim të Fakteve mund ta lexoni në analizën për pavarësinë e Këshillit Gjyqësor të PM-së të përgatitur në suazat e këtij projekti nga Instituti për të Drejtat e Njeriut në këtë link: <http://www.ihr.org.mk/images/pub/analiza-za-ssrm-konecna.pdf>

Miratimi i papritur i Ligjit për Këshillin për Verifikimin e Fakteve është kontestues edhe në aspektin e ndryshimeve të propozuara kushtetuese, të cilat kanë për qëllim përfundimin e pavarësisë së Këshillit Gjyqësor, për shkak të problemit të dukshëm me politizimin e tij. Amendamenti i propozuar parashikon përjashtim të ministrit të Drejtësisë nga Këshilli dhe e ndërpret edhe anëtarësimin e kryetarit të Gjykatës Supreme, i cili fitohet sipas funksionit. Amendamenti parashikon 10 anëtarë të Këshillit të jenë gjykatës të zgjedhur nga radhët e tyre, kurse 5 anëtarët e tjerë (të cilët i zgjedh Kuvendi) të jenë profesorë universitarë të drejtësisë, avokatë dhe juristë të tjerë të shquar. Gjithashtu, vendimet e Këshillit të cilat në moment janë përfundimtare, por nëpërmjet Amendamentit XXXIX gjykatësit mund të ankohen ndaj tyre para Gjykatës Kushtetuese të RM-së. Amendamenti i tillë ishte propozuar në pakon e ndryshimit të Kushtetutës dhe për nenet e tjera, të cilat janë ende në procedurën e Kuvendit. Komiteti i Helsinkit së bashku me disa shoqata qytetare kanë dorëzuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë mendim për ndryshimet e propozuara kushtetuese, si dhe për ndryshimet e propozuara në lidhje me Këshillin Gjyqësor.<sup>27</sup> Nga aspekti teorik-juridik pjesëmarrja e ministrit të Drejtësisë në punën e Këshillit Gjyqësor mund të vlerësohet si e natyrshme dhe e dëshirueshme. Ky është shkaku që anëtarësimi i ministrit mund të shihet nëpërmjet prizmit të kontrollit të përbashkët (checks and balances) në suazat e sistemit të ndarjes së pushtetit. Mendimi i Komisionit të Venecias për ndryshimet kushtetuese në RM, të vitit 2005, nuk ka vërejtje në lidhje me anëtarësimin e ministrit në Këshill. Por, duke pasur parasysh perceptimin e qytetarëve, organizatave të huaja dhe vendase për politizimin e gjyqësorit në RM, Amendamenti i propozuar mund të jetë një hap i rëndësishëm në drejtim të parandalimit të ndikimit të pushtetit ekzekutiv mbi atë gjyqësor. Mundësia që gjykatësit të zgjedhin 10 në vend të 8 gjykatësve nga radhët e veta është propozim i cili do ta përforcojë më shumë pushtetin gjyqësor. Momentalisht gjykatësve anëtarë të Këshillit nuk u lejohet të kryejnë funksionin e gjykatësit apo ndonjë funksion tjetër publik. Është mirë që kjo praktikë të mos përdoret dhe të gjithë gjykatësve anëtarë të Këshillit t'u lejohet njëkohësisht të marrin pjesë në punën e rregullt në gjyqësor. Mundësia e këtuilë do të nënkuptonte angazhim

27 Tekstin e tërësishëm mund ta lexoni në këtë link: [http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/796/Pismo\\_do\\_Vlada\\_na\\_RM\\_Ustavni\\_izmeni.pdf](http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/796/Pismo_do_Vlada_na_RM_Ustavni_izmeni.pdf)



të vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të gjykatësve, aktivitet i rëndësishëm në ndjekjen e të drejtës pozitive dhe zbatimit të saj gjyqësor, pjesëmarrje e drejtpërdrejtë në zbatimin e reformave gjyqësore dhe pjesëmarrje në trajnimet e vazhdueshme, të cilat i zbaton Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë. Edhe pse zgjedhja e 5 anëtarëve nga radhët e profesorëve universitarë të së drejtës, avokatëve dhe juristëve të tjerë të shquar është praktikë e mirë ndërkombëtare, do të ishte i dëshirueshëm përcaktimi i një kushti plotësues, i cili do të ketë lidhje me përvojën e këtyre kandidatëve. Një vendim i tillë ekziston në Kushtetutën e Italisë, i cili parashikon minimum 15 vjet përvojë pune në sferën juridike. Në këtë drejtim dhe me qëllim që zgjedhja të kryhet në bazë të meritës, ia vlen të mendohet që avokatët të zgjidhen nga Kuvendi me propozim nga Dhoma e Avokatëve të RM-së. Në lidhje me propozimin, vendimet e Këshillit Gjyqësor të jenë lëndë vlerësimi të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni i Venecias në mendimin e vet për ndryshimet kushtetuese në RM, të vitit 2005, thekson se siguri i raportimit të Këshillit është i dëshirueshëm që të sigurohet e drejta e ankesës e cila mund të realizohet nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese ose Administrative. Shkalla e dytë e procedurave të Këshillit Gjyqësor, nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese, është paraparë në Francë, Kroaci dhe Serbi. Edhe pse ky propozim teoritikisht nuk çon te ndikimet e drejtpërdrejta të pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv mbi atë gjyqësor, është e domosdoshme zgjedhja e një organi më të lartë, i cili do të vendosë për ankesat të gëzojë besim në shoqëri. Në kushte kur është kontestuese se a është përbërja aktuale e Gjykatës Kushtetuese nga radhët e juristëve të shquar, zgjedhja e tyre politike nga Kuvendi, mosrespektimi i praktikës së vet nga ana e Gjykatës, mbyllja e seancave për publikun dhe mospranimi i mendimit të Komisionit të Venecias, flet për zgjedhjen momentale joadekuate si organ të shkallës së dytë. Shoqatat qytetare dhanë rekomandim që t'u mundësohet anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të vazhdojnë me ushtrimin e funksionit të gjykatësit, me qëllim që të anashkalohet mundësia që gjykatësit anëtarë të Këshillit Gjyqësor të humbin kontaktin e drejtpërdrejtë me gjyqësinë e rregullt. Në drejtim të sigurimit të profesionalizmit dhe kompetencës së anëtarëve të Këshillit, të cilët nuk janë gjykatës, nevojitet të parashikohet një kusht shtesë për anëtarësimin e tyre, i cili do të lidhet me përvojën profesionale dhe arritjet në profesion. Në këtë kuptim, anëtarët nga radhët e avokatëve është e dëshirueshme të zgjidhen nga Kuvendi

me propozim të Dhomës së Avokatëve të RM-së. Edhe pse nga aspekti teorik-juridik zgjidhja me të cilën parashikohet që Gjykata Kushtetuese e RM-së të vendos në lidhje me ankesat ndaj vendimeve të Këshillit Gjyqësor është e qëndrueshme, nuk mund të thuhet se momentalisht Gjykata Kushtetuese është organ i cili gëzon reputacion shoqëror në aspektin e kompetencës dhe pavarësisë së saj. Depolitizimi i Këshillit Gjyqësor, nëpërmjet përjashtimit të ministrit të Drejtësisë si anëtar i tij, nuk duhet të zëvendësohet me ndonjë organ nëpërmjet të cilit politika do të fitonte ndikim edhe më të fuqishëm në gjyqësor.

## Buxheti Gjyqësor

Pjesë me rëndësi të veçantë për pavarësinë e gjyqësorit është Buxheti Gjyqësor, me të cilin menaxhon Këshilli i Buxhetit Gjyqësor, i cili në përputhje me Ligjin për Buxhetin Gjyqësor duhet të jetë minimum 0,8% e bruto prodhimit vendor në shtet. Ky nivel duhet të arrihej nëpërmjet kësaj dinamike kohore:

- 0,5% nga BPV në vitin 2012;
- 0,6% nga BPV në vitin 2013;
- 0,7% nga BPV në vitin 2014; dhe
- 0,8% nga BPV në vitin 2015<sup>28</sup>

Megjithatë, në Analizën e Shoqatës së Punëtorëve Financiarë në Pushtetin Lokal dhe Ndërmarrjet Publike “Burimet e financave, madhësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor”, të përgatitur në suazat e Projektit “Rrjeti 23” është konstatuar se niveli i mjeteve financiare, të planifikuara për vitin 2015, nuk e kalon 0,38% të BPV-së. Me këtë shkelet drejtpërsëdrejti Ligji për Buxhetin Gjyqësor

Në analizë është konstatuar se pjesa më e madhe e buxhetit është për pagat e gjykatësve dhe administratën

---

28 Neni 16 i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Buxhetin e Gjyqësorit.

gjyqësore, kurse pjesa tjetër e mbetur është për mallrat dhe shërbimet e domosdoshme të cilat i shfrytëzojnë gjykatat. Në bazë të të dhënave të marra, është konstatuar se nuk ka mjete të mjaftueshme për financimin e gjykatave, prandaj nuk mund të flitet për një shpërndarje përkatëse të mjeteve sepse mjetet e marra janë më të vogla se nevojat reale, dhe si rrjedhojë shfaqet dukuria e vazhdueshme e detyrimeve të pashlyera. Për shkak të gjendjes së këitillë është çrregulluar edhe solvenca e disa gjykatave. Është karakteristik një prej rasteve të gjykatave të analizuar i cili ka dorëzuar të dhënë se në raste të caktuara shlyerja e obligimeve kryhet me vonesë prej 398 ditësh, si dhe se është e pranishme dukuria e bllokimit të llogarisë së transaksionit të disa gjykatave për shkak të mos shlyerjes me rregull të detyrimeve. Borxhet e gjykatave janë eliminuar deri në fund të vitit 2008, por pastaj përsëri kanë filluar të rriten.<sup>29</sup>

Pjesa më e madhe e buxhetit të gjykatave është për rrogat (85%). Është konstatuar një numër i madh gjykatësish në RM, që e dëshmojnë edhe analizat e Këshillit të Buxhetit Gjyqësor. Kjo sidomos ka të bëjë me numrin e gjykatësve në disa gjykata në brendësi të vendit, ku është i dukshëm disproporcioni i numrit të gjykatësve me numrin e lëndëve. Numri i gjykatësve është shkaku që për gjykatësit vlen një ligj special (Lex specialis) sipas të cilit gjykatësit shkojnë në pension sipas sistemit të vjetër (62/65 vjet) dhe jo sipas ndryshimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, sipas të cilit afati për të dalë në pension është tre vjet më shumë për gratë (65 vjet), përkatësisht dy vjet më shumë për burrat (67 vjet). Qëllimi i qasjes së këitillë ka qenë që të zvogëlohet numri i gjykatësve, kurse nëpërmjet kësaj edhe presioni mbi Buxhetin Gjyqësor. Në këtë drejtim, si specifike theksohet nevoja për mbylljen e gjykatave të veçanta në brendësi të vendit. Ka gjykata më të vogla (Krushevë, Vinicë, Berovë...), të cilat janë joracionale sepse kryejnë shpenzime të mëdha për një numër të vogël lëndësh. Mendohet për mbylljen e tyre në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet. Aty do të punonin njësitë e shpërndara të gjykatave përkatëse të të njëjtit rajon apeli.

Nga ana tjetër në gjykata nuk ka sa duhet nëpunës profesionalë, të cilët do të punojnë në përparimin e administrimit me gjykatat duke përfshirë edhe punën financiare.<sup>30</sup>

Gjendja e keqe financiare vërehet edhe nga avokatët dhe gjykatësit. Një konstatim i tillë është dhënë edhe në analizën e Shoqatës së Qytetarëve NOVUS, e cila ka bërë analizë të pavarësisë dhe objektivitetit të gjyqësorit në Komunën e Strumicës, në përputhje me Kapitullin 23. Në analizë thuhet se pjesa e Buxhetit Gjyqësor, i cili veçohet për gjykatën, është mjaft i vogël dhe kjo mund të ketë implikime mbi pavarësinë e vetë gjykatës. Në këtë kontekst, një prej avokatëve të intervistuar konsideron se madje çdo fletë letre është përcaktuar parapakisht se për se do të përdoret sepse financat janë mjaft të dobëta. Në këtë drejtim, përmendet se gjykatësit nuk e marrin Gazetën Zyrtare, kështu që nuk janë të informuar për ndryshimet në ligje dhe ndonjëherë ndodh edhe nga avokatët të kërkojnë libër dhe literaturë. Përveç kësaj, kur gjykata vendos edhe avokat sipas obligimit të shërbimit, ata avokatë në të shumtën e rasteve kanë mbetur, të pa paguar dhe u kanë borxh mjete financiare. Gjithashtu, edhe ish kryetari i Gjykatës Themelore Strumicë mendon se pjesa e Buxhetit Gjyqësor, e cila i jepet Gjykatës Themelore të Strumicës, është i pamjaftueshëm dhe se nevojiten më tepër mjete për punë.

Një pjesë shumë e vogël e Buxhetit Gjyqësor (mesatarisht 0,95% në vit prej mjeteve të planifikuara, përkatësisht 0,87% të buxheteve vjetore gjyqësore të realizuara) i dedikohet investimeve kapitale.

## Paanshmëria dhe përgjegjësia

Njëanshmëria e gjykatësve në raste të veçanta, sidomos kur ekziston motivim politik ose kur janë përfshirë persona nga politika, ndikon mbi besueshmërinë e qytetarëve në gjykata dhe në sigurinë e tyre juridike. Pavarësia dhe

29 Për këtë problem është folur në tryezën e rrumbullakët të Shoqatës të Punëtorëve Financiarë në Pushtetin Lokal dhe Ndërmarrjet Publike "Burimet e financimit, madhësia e mjeteve të siguruar dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor" të mbajtur më 27 prill në Veles.

30 Kjo, gjithashtu është thënë gjatë diskutimit në tryezën e rrumbullakët të Shoqatës të Punëtorëve Financiarë në Pushtetin Lokal dhe Ndërmarrjet Publike "Burimet e financimit, madhësia e mjeteve të siguruar dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor" të mbajtur më 27 prill në Veles.

paanshmëria e gjykatësve shihet edhe nëpërmjet raportit të tyre me pjesëmarrësit e tjerë në procedurë (të akuzuar, të dëmtuar, prokurorë publikë, të paditur, paditës, mbrojtës etj.).

Në analizën e fundit të Komitetit të Helsinkit, nga mbikëqyrja e procedurës gjyqësore, është konstatuar se gjykatësit në përgjithësi janë të paanshëm në raport me pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, por, ekziston një afërsi e caktuar midis gjykatësve dhe prokurorëve publikë, si edhe një raport më i volitshëm nga gjykatësit kah avokatëve më të vjetër dhe më me përvojë, përkundrejt raportit me avokatët me më pak përvojë.<sup>31</sup> Në analizën e përmendur, njëanshmëria e gjykatësve vërehet në shumë lëndë, për shkak të propozimit të dëshmitarëve pas përfundimit të seancës kryesore dhe kthimit të lëndës në fazën e seancës kryesore pa dijeni të të akuzuarve dhe të mbrojtësit të tyre (lënda J.V. etj. KOK nr. 59/12 në Gjykatën Themelore Shkup 1), për shkak të largimit nga salla e gjykimit të gjykatësit - anëtar i Këshillit Gjyqësor gjatë procedurës (lëndët A.D. etj. KOK nr.80/12 dhe T.K. etj. KOK nr. 51/13 në Gjykatën Themelore Shkup 1)

Konstatimi se gjykatësit në përgjithësi janë të paanshëm gjatë gjykimeve, por ende ekzistojnë raste të izoluar ku ekziston njëanshmëri e dukshme, sidomos ndaj prokurorisë publike, është dhënë edhe në analizën më të re të Koalicionit "Të Gjithë për Gjykim të Drejtë", me titull: "Implementimi i standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe të ndershëm".<sup>32</sup> Raporti i tillë është vënë re në një rast për të cilin thuhet se "në lëndën KOK nr.7/14 ku ka 9 persona të akuzuar për shoqërim kriminal dhe për fshehje të tatimit, mbikëqyrësi ka vlerësuar se gjykimi ka qenë pjesërisht i drejtë, duke konsideruar se gjykata ka qenë e njëanshme ndaj prokurorisë. Mbikëqyrësi ka konstatuar se mbrojtja ka pasur vetëm rol formal sepse çdo propozim apo kundërshtim ka qenë refuzuar nga gjykata, kurse njëkohësisht mbrojtja është ankuar se nuk i është dhënë qasje te të gjitha dëshmitë e mbledhura nga PPT-hja, si dhe nga organet e tjera."<sup>33</sup> Përshtypja për

parabazë, përkatësisht trajtimi i favorshëm i prokurorit publik fitohet edhe nëpërmjet rasteve kur prokurorë publik hyn në sallën e gjykimit para pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

Në lidhje me perceptimin e qytetarëve në nivel lokal për objektivitetin e gjykatave, të dhënat e analizave të Shoqatës së Qytetarëve NOVUS nga Strumica dëshmojnë se vetëm 7% e të anketuarve janë përgjigjur se gjykata në Strumicë është transparente dhe objektive, që është në të kundërt me qëndrimet që i kanë pasur përfaqësuesit e intervistuar të organeve gjyqësore. 36% e të anketuarve kanë mendimin se gjykata në Strumicë është pjesërisht transparente dhe objektive, që është një bazë e mirë e cila duhet të mbindërtohet. 35% konsiderojnë se gjykata në Strumicë është jotransparente dhe joobjektive, kurse 22% nuk kanë asnjë mendim në lidhje me këtë pyetje.

Nga analiza e kryer mbi të gjitha vendimet për shkarkimin e gjykatësve dhe sipas procedurave disiplinore, në periudhën 2010-2014, Instituti për të Drejtat e Njeriut konkludon se "ato nuk janë të argumentuara sa duhet sepse nuk përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fakte dhe rrethana të rëndësishme për vendimin e marrë, ajo duhet të jetë e qartë që t'u mundësohet si palëve ashtu edhe opinionit të gjerë kuptim i tërësishëm i cili do të jetë bazë për dorëzim të ankesës nga palët e prekura në kontest, kurse për të gjithë të tjerët bazë për besim në punën e këtij institucioni". Përveç kësaj, janë vënë re edhe një sërë mangësish formale në vetë vendimet.<sup>34</sup>

Në paanshmërinë e gjykatës ndikon edhe puna e gjykatësve, të cilët i përfaqësojnë të gjithë përfaqësuesit e bashkësive në shtet. Në Raportin e Avokatit të Popullit për ndjekjen e zbatimit të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, për vitin 2014, thuhet: "Duke parë shumën e përgjithshme të të dhënave të pranuar, për vitin 2014, nga gjykatat themelore mund të konstatohet gjendja në vijim për përfaqësimin e bashkësive: maqedonas – 80,5 %, shqiptarë – 13,4 %, turq – 1,4 %, romë – 1,0 %, serbë – 1,3 %, vllahë – 1,3%, boshnjakë – 0,6% dhe të tjerë 0,3 %. Tek gjykatat themelore, në raport me vitin e kaluar, vërehet një ulje e lehtë e përfaqësuesve të bashkësisë shumicë, megjithatë vërehet

31 Analizën e tërësishme të procedurave gjyqësore të mbikëqyrura për respektim të të drejtave themelore qytetare dhe politike mund ta lexoni në këtë link:[http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/731/Analysis\\_-\\_Final.pdf](http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/731/Analysis_-_Final.pdf)

32 Analizën e tërësishme mund ta lexoni në këtë link:[http://all4fairtrials.org.mk/Main\\_files/Standardi\\_2015\\_MKD.pdf](http://all4fairtrials.org.mk/Main_files/Standardi_2015_MKD.pdf)

33 Ibid.

34 "Analiza mbi pavarësinë e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë – synime dhe sfida", Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2015, <http://www.ihr.org.mk/images/pub/analiza-za-ssrm-konecna.pdf>

punësimi i pamjaftueshëm i përfaqësuesve të bashkësive me numër më të vogël, prandaj Avokati i Popullit rekomandon "këto institucione të ndërmarrin masa për implementimin e parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat". E ngjashme është edhe gjendja në katër gjykatat e apelit, këtu përmendet se në gjykatat e apelit nuk ka person të punësuar përfaqësues i bashkësisë rome. Sipas kësaj, përveç vllahëve, asnjë bashkësi tjetër pakicë më e vogël në numër nuk është e përfaqësuar në gjykatat në shtet.

Për paanshmërinë e gjykatësve duhet të kontribuojë edhe sistemi për zgjedhje të rastësishme të lëndëve për të cilat veprohet, i vendosur nga Sistemi Informues për Menaxhim Automatik me Lëndët Gjyqësore (SIMALGj). Megjithatë, nuk ekziston besimi se ky sistem për shpërndarje të lëndëve në praktikë siguron zgjedhje tërësisht të rastësishme.

## Profesionalizmi, kompetenca dhe efikasiteti

Në këtë fushë rëndësi të veçantë ka Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, e cila promovon dhe zbaton konceptin e kompetencës dhe mësimin të përditshëm të gjykatësve, prokurorëve dhe personelit gjyqësor. Edhe përkrah rolit të rëndësishëm të Akademisë, në përmbushjen e këtij standardi, ka buxhet të vogël për zbatim të kompetencave të saj. Për vitin 2014 Akademia është miratuar buxhet në madhësi prej 34.946.000,00 denarësh, që është 10.000.000,00 denarë më tepër se vitin e kaluar.<sup>35</sup> Megjithatë, në rebalancin e buxhetit të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, nga buxheti i miratuar janë shkurtuar mjete në shumë prej 4.477.000,00 denarësh. Gjatë vitit 2014 janë realizuar gjithsej 280 trajnime, ku kanë marrë pjesë 7560 pjesëmarrës, prej të cilëve 3844 ishin gjykatës, 1185 prokurorë publikë, 961 bashkëpunëtorë profesionalë nga gjykatat dhe prokuroritë dhe 1570 pjesëmarrës të tjerë – përfaqësues të institucioneve të tjera relevante, organizatave, sektorit qeveritar etj., të ftuar nga Akademia, kurse punojnë në fusha që lidhen me përmbajtjen e trajnimit, që është 10 trajnime më tepër se vitin e kaluar. Raporti vjetor i Akademisë jep pasqyrë të detajuar dhe të

trajnimeve të gjeneratës së pestë të dëgjuesve të trajnimit fillestar 2013/2015, si dhe të planit për punë praktike. Numri prej 13 dëgjues të trajnimit fillestar flet për uljen drastike të interesimit për aplikim të kandidatëve dhe ndërtim të karrierës në gjyqësor dhe prokurorinë publike. Ekzistojnë shumë faktorë për gjendjen e tillë, kurse sidomos pamja e keqe e gjyqësorit në aspektin e pavarësisë, e cila reflektohet edhe në perceptimin e Akademisë, lidhja e marrëveshjes për punë me orar të caktuar të dëgjuesve me Akademinë, dhe për këtë arsye kanë ndërprerje të marrëveshjes paraprake për punësim, si dhe nevoja për mesataren e suksesit prej më së paku minimum 8,0. Kushti i fundit është i panevojshëm sidomos për shkak të faktit se ekzistojnë teste të veçanta për kandidatët në Akademi, të cilët duhet ta përcaktojnë njohurinë dhe profesionalizmin e tyre.

Nga ana tjetër, ekziston perceptimi për përgatitjen e pamjaftueshme të kandidatëve për gjykatës për ushtrimin e funksionit të gjykatësit menjëherë pas përfundimit të trajnimit dhe rekomandohet që të përparohet përgatitja e kandidatëve nga Akademia. Me regrutimin e gjykatësve vetëm nga radhët e Akademisë, përjashtohet mundësia e një numri të madh të bashkëpunëtorëve profesionalë në gjykata që të bëhen gjykatës, por kjo ndikon edhe në motivimin e tyre. Tregohet edhe mundësia që të përgatitet një program i veçantë i Akademisë që këtyre kuadrove t'u sigurojë mundësi të zgjidhen për gjykatës.<sup>36</sup>

Gjatë vitit 2014 dhe 2015 është vënë re jo kompetencë tek gjykatësit në procedurat penale, që udhëhiqen në përputhje me dispozitat e Ligjit të ri për procedurë penale dhe në lëndët civile për përcaktim të diskriminimit, sidomos në pjesën e procedurës para Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe kalimin në barrën e provës. Në lëndën, V.Ç. etj. RO nr. 95/2013 në GjTh Gostivar, e cila kishte të bënte me diskriminimin për shkak të përkatësisë politike, është marrë vendim gjyqësor negativ për paditësin, me vërejtje nga Këshilli Gjyqësor se paditësit para se të dorëzojnë padi duhet të dorëzojnë ankesë në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, edhe pse Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi është trup i pavarur i cili jep mendime dhe rekomandime për ankesat e dorëzuara për diskriminim dhe

35 Raporti i tërësishtëm i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë për vitin 2014 gjendet në këtë link: <http://www.jpacademy.gov.mk/upload/lzvestai%20za%20Akademija/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D%20%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88%202014.pdf>

36 Nga diskutimi në Konferencën përmblyëse të projektit, mbajtur më 9 korrik 2015.

nuk është parakusht për mbrojtje gjyqësore nga diskriminimi. Në pjesën e barrës së provës gjykatësit nuk kanë praktikë, dhe as nuk përpunon të krijojnë praktikë për bartjen e barrës së provës në anën e palës së të paditur. Si shembull do ta japim procedurën A.A. etj. RO 121/13 të Gjykatës Themelore Gostivar, i cila kishte të bënte me përcaktimin e diskriminimit në bazë të përkatësisë politike. Në këtë rast, edhe përkrah numrit të madh të dëshmitarëve me të cilat paditësit treguan se në të vërtetë është kryer diskriminim nga ana e të paditurit, gjykata vendosi të mos e bartë barrën e provës në anën e të paditurit dhe procedurën e ka udhëhequr si procedurë të zakonshme civile në të cilën paditësit duhet ta dëshmonin bazën e kërkesëpadisë.

Ndryshimet e Ligjit për shërbimin gjyqësor, në vitin 2014, ishin miratuar, gjithashtu pa konsultime të palëve të prekura. Sipas të dhënave të Shoqatës së Administratës Gjyqësore, asnjë nëpunës gjyqësor deri më tani nuk është përparuar me shpallje të brendshme. Shpërndarja, e nëpunësve gjyqësorë, sipas parimit të mobilitetit, nuk mund të kontribuojë për përparim të cilësisë dhe efikasitetit, sepse ekzistojnë indikacione se në praktikë nuk respektohet rregulli i kompetencës.<sup>37</sup>

Mbi profesionalizmin e gjykatave dhe sigurinë juridike të qytetarëve, sidomos pjesëmarrësve në procedurat penale, ndikon edhe mospasja e pajisjes për incizim tonik të gjykimeve, më së shpeshti në procedurën penale. Gjendja e tillë shpjegohet me mospasjen e mjeteve të mjaftueshme financiare për realizimin e këtij standardi, të parashikuar edhe në Ligjin për procedurë penale dhe Ligjin për procedurë civile.

Reformat në gjyqësor, të zbatuara nga vitin 2004 e këndej, dhanë më shumë rezultate mbi **efikasitetin** në gjyqësor. Megjithatë, ekzistojnë ende pika kritike. Sidomos është shqetësuese puna në Gjykatën Administrative, e cila nuk vendos në mënyrë meritore kundër vendimeve të organeve shtetërore dhe refuzon të marrë vendime përfundimtare nëpërmjet të cilave do të mbrohen të drejtat e qytetarëve. Në këtë mënyrë, lëndët kthehen pas tek organet shtetërore


të cilat miratojnë vendime të njëjta, duke mos i respektuar qëndrimet e gjykatave administrative, kështu shkelet edhe e drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm. Ekzistojnë disa raste të mbajtjes së procedurave para gjykatave administrative më tepër se 8 vjet, prej të cilëve një madje edhe 18 vjet (rasti S.M.). E drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm shkelet edhe nga gjykatat themelore dhe të apelit, sidomos nëpërmjet zvarritjes së publikimit të aktgjyqimeve. Nuk respektohet afati për përgatitje prej 15 ditësh, i llogaritur nga dita e seancës kryesore, kurse është vërejtur edhe rast i tejkalimit të afatit prej 60 ditësh për lëndë më të komplikuar. Në këtë drejtim është edhe shembulli i lëndës L.B. etj. KO nr. 2917/12 i Gjykatës Themelore Shkup 1, në të cilën nga dita e përfundimit të procedurës së shkallës së parë deri në ditën e dorëzimit të aktgjyqimit kaluan më tepër se 4 muaj, përkatësisht dy herë më shumë se afati i fundit i parashikuar me Ligj. Ky rast, për të cilin ekziston dyshimi edhe për ndikim politik, zhvillohet më shumë se 2,5 vitesh, edhe pse disa prej të akuzuarve u është përcaktuar masa e arrestit. Gjithashtu, shkelja e së drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm është vërejtur edhe në lëndën K.K.K. nr. -534/13 në GjTh Gostivar, e cila mbahet si vepër penale Përdhunim, e paraqitur më 9.10.2008, kur edhe kinse ka ndodhur ngjarja kritike, aktakuza në gjykatë është dorëzuar më 21.6.2011, përkatësisht pas kalimit të 2 viteve dhe 10 muajsh nga denoncimi. Procedura para gjykatës është mbajtur 4 vjet, sepse vendimet e gjykatës së shkallës së parë janë anuluar dy herë nga gjykata e shkallës së dytë dhe ende nuk ka vendim të plotfuqishëm për këtë lëndë. Konsiderojmë se ky rast ku nga dita e paraqitjes së kallëzimit kanë kaluar 5 vjet dhe 10 muaj dhe ende nuk ka vendim të plotfuqishëm, dëshmon se nuk ekziston mbrojtje efikase kur bëhet fjalë për dhunën seksuale mbi gratë.

37 Sipas raporteve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2013 dhe 2024, shumica e punësimeve në shërbimin gjyqësor është me ndërmarrje nga NP "Pyjet e Maqedonisë" (ku pjesa më e madhe e të punësuarve të rinj i fituan vendet e punës me lotari, si edhe nga Sekretariati për Marrëveshjen Kornizë

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### Konkluzione

1. Gjatë vitit të kaluar është përkeqësuar pavarësia e gjyqësorit, për shkak të mosrespektimit të parimit të ndarjes së pushtetit dhe partizimit të institucioneve.
2. Trajtimi i ndryshëm i rastit "Puç" dhe i kallëzimeve penale lidhur me skandalin e përgjimit janë indikacione shtesë për drejtësinë seleksionuese dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv mbi prokurorinë publike dhe gjyqësorin.
3. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë nuk arrin ta realizojë funksionin e vet në përputhje me Kushtetutën – ta garantojë pavarësinë e gjyqësorit, sidomos për shkak të punës jo transparente dhe vendimeve joobjektive për përgjegjësinë disiplinore dhe shkarkimin e gjykatësve.
4. Me Ligjin për Këshillin për Verifikimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit, në vend që të plotësohet rekomandimi i GREKO-s, shkohet në drejtim të kundërt dhe shkelet pavarësia e gjykatësve.
5. Zgjidhjet ligjore të Këshillit për Verifikimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit, si dhe për Këshillin Gjyqësor të RM-së, nuk parashikojnë përgjegjësi të anëtarëve të këtyre dy këshillave dhe as sigurojnë transparencë thelbësore në punën e tyre.
6. Procedura për përparim të gjykatësve nuk e përmbush parimin e transparencës dhe nuk zbaton kritere objektive për cilësi. Nuk ekziston mjet juridik përkatës në raport me realizimin e të drejtës së ankesës të kandidatit ë pakënaqur – gjykatës në procedurën e zgjedhjes së gjykatësve.
7. Nuk respektohet korniza ligjore, për pavarësi financiare të gjyqësisë, që ndikon drejtpërdrejt mbi pavarësinë e tij dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve.
8. Besimi i qytetarëve në gjyqësor është në nivel të ulët.
9. Pjesa më e madhe e ligjeve miratohen me procedurë të shkurtër, pa diskutim gjithëpërfshirës dhe pa përfshirjen e opinionit ekspert.
10. Nuk ka përfaqësim të drejtë dhe adekuat të bashkësive etnike më të vogla në gjyqësor dhe shërbimin gjyqësor.
11. Është përmirësuar efikasiteti i gjykatave, por megjithatë ende shkelet e drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm. Sidomos shqetëson fakti që fare nuk respektohen procedurat të cilat parashikohen si urgjente, si në procedurën penale, ashtu edhe në atë civile, të cilat ndikojnë mbi realizimin e të drejtave të tjera, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.
12. Ekziston mosbesim në pavarësinë e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë, për shkak të lidhjes së Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë në aferën "Përgjimi", por dhe mosndërmarrjen konstante të ndjekjes penale kundër funksionarëve të lartë shtetërorë në rastet e dyshimit të bazuar për korrupsion, si dhe për mosndërmarrjen e ndjekjes me qëllim të mbrojtjes së aktivistëve qytetarë dhe bashkësive të marginalizuara në rastet e sulmeve mbi ta.
13. Ekziston interesim i dobët për paraqitjen e kandidatëve në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, kurse Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë ballafaqohet me mungesë të mjeteve.



## Rekomandime

1. Zgjedhja e Prokurorit të ri Publik të pavarur të Republikës së Maqedonisë, i cili duhet të ngre dhe zbatojë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë nga ana e bartësve të pushtetit ekzekutiv, në bazë të indikacioneve për ndikim të fuqishëm të pushtetit ekzekutiv në gjyqësor, të prezantuara në materialet e përgjimit.
2. Të sigurohet mbikëqyrje e përfuruar e funksionimit të Prokurorisë Publike, gjykatave, Këshillit Gjyqësor të RM-së, Këshillit të Prokurorëve Publikë të RM-së, veçanërisht nga organizatat qytetare.
3. Të përfordhet pavarësia e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, nëpërmjet zgjedhjes së anëtarëve nga vetë gjykatësit dhe leje që të vazhdojnë me ushtrimin e funksionit të gjykatësit, me qëllim që të mos e humbasin kontaktin e drejtpërdrejtë me gjyqësorin. Në drejtim të sigurimit të profesionalizmit dhe kompetencës së anëtarëve të Këshillit, të cilët nuk janë gjykatës, nevojitet që të parashikohet kusht plotësues për anëtarësimin e tyre që lidhet me përvijën profesionale dhe arritjet në profesion. Si rrjedhojë, anëtarët nga radhët e avokatëve është e dëshirueshme të zgjidhen në Kuvend, me propozim nga Dhoma e Avokatëve të RM-së dhe me votim paraprak nga të gjithë avokatët.
4. Të vendoset moratorium i zbatimit të Ligjit për Këshillin për Verifikimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit, duke i pasur parasysh mangësitë e konstatuara.
5. Gjykata Supreme, Këshilli Gjyqësor i RM-së dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të sigurojnë transparencë të plotë në punën e tyre.
6. Të miratohen plotësime të ligjeve ekzistuese si në pjesën e përgjegjësisë efektive të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të RM-së, ashtu edhe në pjesën për sigurimin e transparencës thelbësore në punën e të dy këshillave.
7. Të sigurohet mjet juridik i pavarur dhe efikas për kandidatët e pakënaqur në procedurën për zgjedhje, për përgjegjësi disiplinore dhe në procedurën për shkarkimin e gjykatësve.
8. Gjatë zgjedhjes së gjykatësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë gjyqësorë të respektohet parimi i përfaqësimit të drejtë.
9. Të respektohet e drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm, sidomos në rastet ku procedurat parashikohen si urgjente.
10. Të zbatohen aktivitete për informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre dhe mekanizmat e mbrojtjes, me qëllim që të kthehet dalëngadalë besimi i qytetarëve tek institucionet. Në këtë drejtim, duhet të përfordhet bashkëpunimi midis institucioneve dhe shoqatave të qytetarëve dhe nëpërmjet tribunave të përbashkëta publike, evenimenteve dhe broshurave të informohen qytetarët mbi mundësitë e ngritjes së procedurave përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
11. Gjykata Administrative të fillojë të vendos në mënyrë meritore, kështu që do t'i shkurtojë procedurat administrative dhe do t'i mbrojë të drejtat e qytetarëve.
12. Të ndryshojnë kriteret për pranim në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë me qëllim që aplikimi për në Akademi të jetë më i aksesshëm dhe më joshës për kandidatët e mundshëm.
13. Të përparojë cilësia e trajnimit të gjykatësve dhe prokurorëve të ardhshëm publikë.
14. Të rritet Buxheti Gjyqësor, me shpërndarjen e resurseve përkatëse, në përputhje me Ligjin për Buxhetin Gjyqësor.

## TË DREJTAT E NJERIUT

### Mbrojtja nga tortura dhe trajtimi ndëshkues, brutal, jonjerëzor ose përqësues

Në tre vitet e kaluara, deri te Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i cili siguron ndihmë juridike pa pagesë për viktimat dhe i mbikëqyr procedurat gjyqësore në të cilat si të akuzuar janë personat zyrtarë, janë dorëzuar dhjetëra ankesa nga qytetarët të cilët janë ankuar nga tortura fizike dhe psikike nga policia dhe personat e tjerë zyrtarë. Një pjesë e viktimave janë persona të arrestuar dhe të dënuar, ndaj të cilëve është ushtruar torturë në institucionet e mbyllura (stacione policore, paraburgim, burgje dhe institucione psikiatrike), larg syve të opinionit. Megjithatë, nuk janë të panjohura edhe rastet e torturës nga nëpunësit e policisë, të cilët duke e keqpërdorur obligimin zyrtar, në mënyrë brutale i kanë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të qytetarëve në shtëpitë e tyre ose në vende publike.

Rasti i Zuher Ibrahimovit, person i dënuar i cili pas sulmit nga një polic në INK "Idrizovë" e ka humbur shpretkën dhe njërin veshkë, është karakterizuar si "lëndim i rëndë trupor" në vend që të karakterizohet si "torturë". Polici i akuzuar, pasi kaloi tre muaj në arrest shtëpiak, është kthyer në punë deri në momentin kur dënimi i tij gjashtëmuajor me burgim u rrit në një vit e gjysmë, nga gjykata e shkallës së dytë. Ndërkohë z. Ibrahimov është kthyer të vuajë dënimin me burg në kushte të cilat janë rrezik për jetën dhe për përkeqësimin e gjendjes së tij shëndetësore.<sup>38</sup>

Incidentet e tjera mbetën të pazgjidhura, me kundër kallëzim penal nga policia ose me tërheqje nën presion të viktimave në procedurë. Midis këtyre incidenteve është dhe keqtrajtimi policor i romëve në lagjen "Topansko Pole" kur disa qytetarë janë sulmuar dhe arrestuar edhe pse nuk kanë kryer veprë penale.<sup>39</sup> Përfaqësuesit e njësisë speciale "Alfa", në vitin 2014, pa asnjë shkak kanë sulmuar një djalë më të ri, kurse në një incident tjetër pa shkak është rrahur dhe

ofenduar një i mitur, përfaqësues i bashkësisë rome<sup>40</sup> Edhe përkrah faktit se bëhet fjalë për torturë mbi të mitur, as Prokuroria Publike, as MPB-ja nuk kanë ngritur procedurë zyrtare. Këta shembuj flasin për prani të fenomenit të mosndëshkimit dhe solidaritetit të prokurorisë publike dhe gjyqësorit me policinë.

Shembulli me fëmijën shurdhmemec, i cili në mënyrë të paligjshme është vendosur në Entin Banja BANSKO për të cilin opinionin mori vesh pas disa muajsh të mbajtjes së tij të lidhur me litar për krevati dhe të keqtrajtimin është tregues jo vetëm për moskujdesin e shtetit ndaj këtij grupi të lëndueshëm por edhe se tortura në institucionet e mbyllura është ende realitet. Edhe përkrah faktit se Komiteti i Helsinkit ka dorëzuar kallëzim penal pranë Prokurorisë Publike, ai është refuzuar si i pa bazë.<sup>41</sup>

Në vitin 2014 dhe 2015, katër vrasje të grave dhe vajzave dhe të afërmeve të tyre (duke përfshirë edhe armë zyrtare) nga partnerët të paraqitur më parë si ushtrues të dhunës familjare, sulmet mbi migrantët-refugjatët dhe strehimi i tyre në kushte jonjerëzore,<sup>42</sup> si edhe fekalet e gjetura në ujin e Burgut të Kumanovës,<sup>43</sup> përfunduan pa reagimin përkatës nga institucionet kompetente ose nuk kanë përfunduar fare.

38 Komiteti i Helsinkit, Raporti tremujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë (prill – qershor 2013), fq. 10-11. <http://www.mhc.org.mk/reports/145>

39 ibid, fq. 9-10.

40 Komiteti i Helsinkit, Raporti dymujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë (prill – maj 2014), fq. 11-13. <http://www.mhc.org.mk/reports/219>

41 Komiteti i Helsinkit, Raporti mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë (janar 2015), fq. 2-3. <http://www.mhc.org.mk/reports/271>

42 Komiteti i Helsinkit, Lajmërim: Shteti e ka për detyrë t'i mbrojë migrantët, 2015. <http://www.mhc.org.mk/announcements/295>

43 Komiteti i Helsinkit, Lajmërim: Ujë me fekalet për të dënuarit dhe të burgosurit në Burgun e Kumanovës, 2014 <http://www.mhc.org.mk/announcements/254>



## Respektimi i jetës private dhe familjare dhe komunikimit

Duke filluar nga 9.2.2015, Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë mbajti 36 konferenca për shtyp, me ç'rast prezantoi informacione se shërbimet shtetërore në mënyrë të paligjshme kanë ndjekur mbi 20.000 qytetarë të Republikës së Maqedonisë, si dhe një pjesë të funksionarëve të Qeverisë dhe personave të afërm me ta, kanë kryer një numër të madh veprash penale që lëvizin nga rrezikimi i sigurisë dhe deri te keqpërdorimi i pozitës zyrtare, shoqërimet kriminal dhe mashtrimet zgjedhor në përmasa të mëdha. Gjithsesi, parashtrohet pyetja nëse ato incizime të bisedave janë përgatitur në mënyrë jolegale, a ka të drejtë që dikush t'i publikojë dhe nëse ka, nën çfarë kushtesh mund ta kryejë këtë?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet ta shqyrtojmë praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për rastin "RADIO TWIST A.S. v. SLOVAKIA" (Aplikim nr. 62202/00) ku Gjykata i shqyrton kufizimet e lirisë së shprehjes dhe informimit, në lidhje me të drejtën e privatësisë. Në këtë rast, gjykatat vendase në Slovaki vendosën ta dënojnë publikimin e bisedës, të siguruar në mënyrë të paligjshme, midis dy funksionarëve të qeverisë së atëhershme në të cilën janë shpalosur të dhëna për veprimtarinë korruptuese të funksionarëve. Nga njëra anë kemi përplasje të së drejtës së privatësisë së pjesëmarrësve në bisedime, kurse nga ana tjetër, e drejta e opinionit që të jetë i informuar dhe e drejta e secilit që ta informojë opinionin për çështje me interes publik.

Në arsyetimin e vendimit të vet, Gjykata e ka përpunuar çështjen e ligjshmërisë së bisedës së siguruar, në raport me të drejtat e personit i cili e publikon. Në Republikën e Maqedonisë, madje edhe sipas akuzës kontroverse në rastin "Puç", Zoran Zaev akuzohet se materialet e përpunuara, në mënyrë jolegale, i ka përdorur për qëllime të paligjshme, por jo edhe atë se ai vet i ka përpunuar në mënyrë të paligjshme. Në këtë kontekst, Gjykata shprehet se fakti se incizimi është kryer në mënyrë të paligjshme nga një person i tretë nuk është i mjaftueshëm që të zbatohen përjashtimet nga liria e shprehjes. (§62) Mandej, objekt i vlerësimit është edhe konteksti i bisedimeve që është publikuar në raport të së drejtës së privatësisë së bashkëbiseduesve. Këtu duhet të merret parasysh se Zaevi i ka përdorur incizimet e bisedave në dy kontekste: së pari, që

të dëshmojë se në Republikën e Maqedonisë ekziston praktikë e përgjimit të paligjshëm, nëpërmjet keqpërdorimit të aparatit shtetëror të sigurisë; kurse, së dyti, nëpërmjet përbajtjes së tyre të dëshmojë se bartësit e pushtetit në RM kanë kryer vepra të shumta penale. Në këtë kontekst, Gjykata shprehet se kufizimet e kritikës së pranueshme ndaj personit publik, për shembull politikanit, janë më të gjera se ato të personit privat. Për dallim nga personi privat, personat publikë në mënyrë të vetëdijshme dhe të pashmangshme ballafaqohen me analizë të detajuar të fjalëve dhe veprave të tyre nga gazetarët dhe opinioni më i gjerë dhe si rrjedhojë duhet të tregojnë shkallë të lartë të tolerancës. (§52). Në një rast krejtësisht tjetër "INCAL v. TURKEY" (41/1997/825/1031), Gjykata shprehet se kufizimet e kritikës së pranueshme ndaj Qeverisë janë edhe më të gjera, përkatësisht më të gjera se ato ndaj politikanëve dhe personave të tjerë publikë. Në një sistem demokratik, veprat e përfaqësuesve të qeverisë duhet të jenë nën analizë të detajuar jo vetëm nga pushteti ligjvënës dhe gjyqësor por edhe nga mendimi publik. Aq më shumë, pozita dominuese të cilën e ka Qeveria e përcakton domosdoshmërinë për të qenë i përbajtur nga veprat penale, sidomos aty ku ekzistojnë mënyra të tjera të përgjigjes ndaj sulmeve dhe kritikave nga kundërshtarët e saj (§54). Kështu, sa u përket bisedave të publikuara, nëpërmjet përbajtjes së të cilave Zaevi dëshiron të dëshmojë vepra të kryera penale nga bartësit e funksioneve publike, apo të institucioneve shtetërore, nuk ekziston shkelje e të drejtës së privatësisë së bashkëbiseduesve, deri në momentin kur bisedat janë për çështje që lidhen me obligimin e tyre zyrtar ose me vepra konkrete penale.

Është e domosdoshme të përmendet dhe mendimi i Gjykatës kur bëhet fjalë për hetim të shtetit të procesit të sigurimit të paligjshëm të bisedave. Domethënë, organet e ndjekjes në RM, Prokuroria Publike dhe Ministria e Punëve të Brendshme, rastin e trajtojnë vetëm njëanshëm, përkatësisht e analizojnë vetëm tezën e paraqitur nga Qeveria e RM-së, se incizimet janë siguruar në mënyrë të paligjshme dhe janë përpunuar nga shërbimet e huaja, me ndihmën e individëve të caktuar, të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Prokuroria Publike nuk e shqyrton aspak mundësinë që ato të jenë siguruar përmes keqpërdorimit të autorizimeve të shërbimeve shtetërore të sigurimit dhe keqpërdorimit të sistemit të tërësishëm të sigurisë në shtet. Këtë mundësi nuk e shqyrtojnë as mekanizmat për kontroll mbi punën e

shërbimeve shtetërore të sigurimit. Në rastin "RADIO TWIST A.S. v. SLOVAKIA", organet kompetente sllovaqe, gjithashtu, nuk e kanë shqyrtuar këtë mundësi. Gjykata u prononcua se "kjo është mjaft befusuese, duke e marrë parasysh faktin se incizimi ka të bëjë me bisedë telefonike midis dy funksionarëve të lartë dhe se dyshimi se incizimi është siguruar përmes keqpërdorimit të autorizimeve, nuk duhet të hidhet poshtë që në fillim" (§60). Me fjalë të tjera, shteti mund të hetojë në cilindo qoftë drejtim, por nuk duhet paraprakisht dhe pa rezerva ta pranojë qëndrimin e shërbimeve të sigurimit se veprojnë në përputhje me autorizimet e veta dhe se nuk i kanë tejkaluar ato në rastin kur ekzistojnë indikacione të dukshme për këtë gjë.

Sipas nenit 175 të Ligjit për komunikimet elektronike (LKE), operatorët janë të obliguar t'i sigurojnë të gjitha kushtet e domosdoshme teknike, që të mundësojnë ndjekje të komunikimeve në rrjetet e tyre. Sipas nenit 9 të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve (LNK), urdhër për ndjekje të komunikimeve për zbulim dhe ndjekje të kryerësve të veprave penale miraton gjykata kompetente, kurse sipas nenit 260 të Ligjit për procedurë penale, afati i zgjatjes së ndjekjes së këtitillë të komunikimeve mund të jetë maksimum katërmëdhjetë muaj. Sipas nenit 30 dhe 31 të LNK-së urdhër për ndjekje të komunikimeve për mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit miraton gjykata kompetente, kurse sipas nenit 33, kjo ndjekje e komunikimeve zgjatë më së shumti deri në dy vjet.

Megjithatë, problemi shfaqet te mbikëqyrja e ligjshmërisë së zbatimit të kësaj mase. Sipas LKE-së, operatori nuk është i obliguar të kërkojë dhe përcaktojë ekzistimin e urdhrin nga gjykata kompetente, me të cilin i lejohet organit të autorizuar për ndjekje të komunikimeve ta zbatojë masën, por as ta kontrollojë ose ta masë ndjekjen e përgjithshme të komunikimeve. Obligim i operatorit konsiston vetëm me sigurimin e të gjitha kushteve teknike për zbatim të tij.

Mbikëqyrje mbi punën e operatorëve në këtë sferë kryen vetëm Agjencia për Komunikime Elektronike edhe atë vetëm kur organi i autorizuar e kërkon këtë (neni 175 paragrafi 10 LKE). Kjo do të thotë se pikërisht shërbimi shtetëror është ai i cili duhet të kërkojë mbikëqyrje të operatorit për ndjekje të komunikimeve. Kur bëhet fjalë për mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e zbatimit të autorizimit të Drejtorisë për Sigurim

dhe Kundërzbulim (DSK) dhe ndjekje të komunikimeve nga MPB-ja dhe MM-ja, kjo është në kompetencë të Komisionit për Mbikëqyrje të Punës së DSK-së dhe të Agjencisë për Zbulim në Kuvendin e RM-së dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave për Ndjekjen e Komunikimeve nga MPB-ja dhe MM-ja. Nga praktika e deritanishme u dëshmuua se kjo mbikëqyrje në Maqedoni nuk është e zbatueshme. Në vitin 2008, Esad Rahiq, ish kryetari i Komisionit të Kuvendit për Mbikëqyrje të DSK-së dhe Agjencisë për Zbulim, në intervistë për revistën javore "Globus" deklaroi se "Parlamenti vetëm aktron kontroll të shërbimeve sekrete", edhe përkrah kësaj qëndrimi zyrtar është se Parlamenti ka kontroll të pjesshëm mbi DSK-në. Qëndrim të njëjtë me z.Rahiq ka edhe Tito Petkovski (gjithashtu ish kryetar i Komisionit), kurse bazohet në mungesën e vullnetit për bashkëpunim nga ana e ish drejtorit të DSK-së Sasho Mijalkov.

Me rëndësi të veçantë është edhe neni 19 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit, me të cilin në mënyrë eksplicite ndalohet ndërmarrja e ndjekjes penale apo thirrjes për çfarëdolloj përgjegjësie tjetër të personit, i cili ka zbuluar të dhëna që dëshmojnë se ka korrupsion. Përkatesisht, fakti se përmbajtja e bisedave flet për raste të mundshme të korrupsionit është e mjaftueshme për shtetin ta drejtojë fokusin e vet te përmbajtja dhe rëndësia e tyre, dhe jo te kinse bashkëpunimi me shërbimet e huaja për sigurimin e tyre. Në vijim të këtij argumenti është edhe fakti se Kodi Penal nuk e inkriminon përdorimin e informacioneve të siguruar nga shërbimet e huaja, por vetëm për dhënien e informacioneve shërbimeve të këtilla dhe punën në interes të tyre (neni 316 i KP-së).

Keqpërdorimi i autorizimeve nga DSK-ja dhe shfrytëzimi i sistemit të përgjimit për qëllimet e partisë në pushtet është konstatuar edhe në Raportin e grupit ekspert të Komisionit Evropian, i cili theksoi mangësi serioze në pesë fusha: ndjekja e komunikimeve, mbikëqyrja e jashtme e trupave të pavarur, gjyqësori, zgjedhjet dhe mediat.<sup>44</sup> Në pjesën e komunikimeve, konstatohet mosrespektim i etikës profesionale, parimet themelore të menaxhimit të rrezikshëm dhe mungesë të njohjes së ndjeshmërisë së detyrave zbuluese në suazat e

44 Raportin e tërësishtëm të Grupit ekspert të Komisionit Evropian, mund ta lexoni në këtë link: [http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/newsfiles/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/newsfiles/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf).

DSK-së. Objekt shqetësimi është edhe mungesa e dukshme e shërbimit të trajnuar për të drejtat themelore dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave. Lidhja familjare midis politikanëve në pozita të larta dhe bartësve të funksioneve të larta në DSK, si dhe në Prokurorin Publike që, në përputhje me nenin 8 të Ligjit për Prokurorinë Publike, është e obliguar ta informojë opinionin për situata të veçanta sipas të cilave vepron, sidomos nëse janë të natyrës së tillë që shkaktojnë interesim më të gjerë në opinion ose janë me rëndësi për realizimin e funksionit të Prokurorisë Publike për mbrojtje nga veprimtaritë kriminale dhe veprimtaritë e tjera kundërligjore

## Liria e bindjes, ndërgjegjes dhe fesë

Liria e bindjes dhe liritë fetare të qytetarëve garantohej me të drejtën ndërkombëtare ose me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 2, 16, 18, Paktin Ndërkombëtar të të Drejtave Qytetare dhe Politike, neni 18, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 9 dhe me Kushtetutë neni 19, amendamentet 7 dhe 8 dhe me Ligjin për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze. Në Republikën e Maqedonisë janë vënë re tre raste të kufizimit të lirisë së bindjes dhe lirive fetare, gjatë regjistrimit të bashkësive fetare dhe grupeve religjioze të Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit (KOO), Bashkësisë Bektashiane dhe Manastirit Stavropigial "Shën Joan Gojarti" i përfaqësuar nga ana e Kishës së Krishterëve të Vërtetë Ortodoksë.

Në lidhje me KOO-në, Republika e Maqedonisë refuzon ta regjistrojë Kryepeshkopatën Ortodokse të Ohrit si kishë ose si grup religjioz që në vitin 2004. Me këtë është shkelur neni 9 (e drejta e fesë), neni 11 (liria e tubimit dhe shoqërimit) dhe neni 14 (ndalimi i diskriminimit) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Komiteti i Helsinkit e përfaqëson Kryepeshkopatën Ortodokse të Ohrit para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga viti 2006 dhe pret gjatë vitit 2015 aktgjykimin. Përveç diskriminimit dhe barrierave administrative, me të cilat ballafaqohen përfaqësuesit e kësaj kisha, të cilët në opinion janë stigmatizuar dhe quajtur "tradhtarë, përçarës dhe kriminelë"; z. Vranishkovski (kryepeshkopi i KOO-së) është në ndjekje të vazhdueshme penale nga pushteti. Në 11 vitet e fundit ai ka qenë në burg gjashtë herë, kurse momentalisht

pritet të caktohet gjykim i përsëritur për kinse pastrim parash, ku si të akuzuar janë edhe përfaqësuesit e KOO-së.

Bashkësia Bektashiane ka kontekst para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me pamundësinë e regjistrimit të saj si bashkësi fetare. Gjykata themelore disa herë e pamundëson regjistrimin kinse për mungesë të dokumenteve ose vendimi i fundit i cili sugjeron në një vendim negativ, në bazë të kinse ekzistimit të bashkësisë së njëjtë fetare. Edhe pse ekziston Bashkësi Bektashiane e regjistruar, e cila ka marrë leje në vitin 2010, megjithatë, bëhet fjalë për dy grupe të ndryshme dhe Bashkësia Bektashiane e vitit 2000 kërkon të regjistrohet si Bashkësi Bektashiane Islame, që është emër i ndryshëm nga bashkësia e regjistruar tashmë. Bashkësia Bektashiane Islame bën luftë për regjistrim më tepër se 15 vjet dhe gjendet në labirintet burokratike të dokumenteve të nevojshme për regjistrim, me çka pamundësohet e drejta e besimtarëve që t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre fetare.<sup>45</sup> Kështu shkelen të drejtat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 9 (e drejta e fesë), nenit 11 (liria e tubimit dhe shoqërimit) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në mënyrë identike si në rastin e KOO-së.

Manastiri Stavropigial "Shën. Joan Gojarti" i përfaqësuar nga Kisha e të Krishterëve të Vërtetë Ortodoksë, themeluar nga murgj si persona fizikë, të cilët janë ndarë nga Kisha Ortodokse e Maqedonisë, në vitin 2008 kanë dorëzuar kërkesë për regjistrim të kishës së lartpërmendur si bashkësi/manastir fetar i veçantë i qytetarëve/besimtarëve të KOM. Gjykata Themelore, me vendimin e vitit 2009, nuk e lejon regjistrimin e bashkësisë kinse për shkak të kundërshtisë me Ligjin për bashkësi fetare dhe grupe religjioze, duke thënë se nuk mund të regjistrohen si bashkësi fetare sepse do të shkeleshin ndjenjat fetare të besimtarëve të tjerë, por nuk ka dhënë shpjegim për cilët besimtarë dhe për cilën bashkësi fetare është ky vendim. Kisha e të Krishterëve të Vërtetë Ortodoksë në Manastirin "Shën. Joan Gojarti" u përpoq të formojë shoqëri të qytetarëve, por edhe kjo kërkesë është refuzuar të regjistrohet sipas Ligjit për bashkësi fetare dhe grupe religjioze. Ankesat e këtij grupi janë hedhur poshtë nga instancat më të larta gjyqësore, kurse Gjykata Kushtetuese

45 Dokument i dorëzuar deri te Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Bashkësia Bektashiane Islame: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{"respondent":\["MKD"\],"article":\["9","9-1","9-2"\],"documentcollectionid2":\["CASELAW"\],"itemid":\["001-146470"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{).

e ka hedhur poshtë ankesën për shkelje të barazisë së qytetarëve si parim kushtetues me arsyetim se nuk ka vërejtur diskriminim para institucioneve. Rasti i kësaj bashkësie është para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 9 (e drejta e fesë), nenin 11 (liria e tubimit dhe shoqërimit) dhe nenin 14 (ndalimi i diskriminimit), si edhe në dy rastet e tjera.<sup>46</sup>

Kjo praktikë dëshmon ndalimin e regjistrimit të bashkësive fetare nga vendimet dhe ndikimet politike mbi gjyqësorin, kur bëhet fjalë për regjistrimin e bashkësive të cilat janë ndarë nga dy bashkësitë më të mëdha fetare, ose nga Kisha Ortodokse e Maqedonisë dhe Bashkësia Fetare Islame, të cilat konsiderojnë se me regjistrimin ndikohet drejtpërdrejtë mbi legjitimitetin e kishave mbi besimtarët e fesë krishtere dhe islame dhe bashkimin e tyre të mundshëm me bashkësi të tjera.

## Liria e shprehjes, duke përfshirë lirinë dhe pluralizmin e mediave

Liria e shprehjes, në konceptin më të gjerë, si e drejtë kornizë e përfshin shprehjen, gjuhën dhe mendimin e qytetarëve, si dhe lirinë e mediave dhe qasjen në informacionet me karakter publik. Liria e shprehjes nuk është e drejtë absolute, dhe si rrjedhojë mund të kufizohet nëse i shkel të drejtat e të tjerëve ose nëse shkakton dhe përhapë gjuhën e urrejtjes ose në korrelacion me cenime të caktuar të sigurisë së shtetit, integritetit territorial dhe sigurisë publike, mbrojtjes së rendit dhe parandalimit të trazirave dhe krimeve, mbrojtjes së shëndeti dhe moralit, autoritetit dhe të drejtat e të tjerëve për ndalim të shpërndarjes së informacioneve të besueshme ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë obligohet se do t'i respektojë këto liri dhe të drejta ose Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (neni 19), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat e Qytetarëve dhe Politike (neni 19), Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (neni 10), Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (neni 11). Republika e Maqedonisë ballafaqohet me kritikë gjatë realizimit të të drejtave të përmendura më lartë, si dhe rënien e tyre të vazhdueshme të shënuar në raportet e Komisionit Evropian për progresin e shtetit, por edhe në organizatat e tjera relevante, siç janë OSBE/ODIHR,<sup>47</sup> Reporterët pa Kufij,<sup>48</sup> Fridom Haus për Lirinë e Mediave etj.<sup>49</sup> Nuk ngelen pas edhe kritikantët dhe organizatat joqeveritare, të cilat punojnë në shtet mbi fushën e lirisë së shprehjes dhe mediave që janë në pajtim se pluralizmi i mediave në Republikën e Maqedonisë nuk e reflekton pluralizmin e informacioneve që plasohen në opinion. Vërejtjet e përgjithshme, në lidhje



46 Dokument i dorëzuar deri te Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Krishterët e Vërtetë Ortodoksë: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{"respondent":\["MKD"\],"article":\["9","9-1","9-2"\],"documentcollectionid2":\["CASELAW"\],"itemid":\["001-146472"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{).

47 Raporti i progresit i Komisionit Evropian, 2014: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf). Raporti për ciklin zgjedhor, 2014, OSBE/ODIHR: Raport, zgjedhje, 2014 OSBE/ODIHR: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true>.

48 Indeksi mbi lirinë e mediave, Reporterët pa Kufij, , 2014/15 <http://index.rsf.org/#/>.

49 Liria e Mediave, Fridom Haus, 2014: [https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2014/macedonia#VXg\\_odKqkko](https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2014/macedonia#VXg_odKqkko). Pasqyrim i rënies në Maqedoni të lirisë të mediave në përputhje me raportin e Fridom HAus: <http://www.pravdiko.mk/makedonija-na-117-mesto-sporod-slobodata-na-mediumite/>.

me rënien e lirisë së mediave dhe punonjësve mediatikë, rritja e gjuhës së urrejtjes, si dhe kufizimi i informacioneve që garantojnë mendim kritik dhe shumëllojshmëri, sidomos për çështjen e sundimit të së drejtës dhe funksionimit të pushtetit ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor. Sipas pasqyrit të përgjithshëm të situatës, në Raport jepen informacione për secilën kategori të dhënë, të rëndësishme për lirinë e shprehjes dhe të drejtat e përafërta në përgjithësi.

## Liria e shprehjes

Në përputhje me legjislacionin nacional, liria e shprehjes garantohej me nenin 8 dhe 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë ku qartë theksohet se cenuara është e ndaluar. Në kontekstin më të gjerë, liria e shprehjes e përfshin edhe manifestimin e diversitetit, përkatësisë, liritë dhe të drejtat fetare, të drejtën e shoqërimit të lirë, si dhe të drejtën e protestës. Në tekstin e mëtejshëm janë përpunuar informacionet për të drejtat e përafërta, kurse shkeljet konkrete të lirisë së shprehjes lidhen me mos-ndëshkimin e gjuhës së urrejtjes, mos-transmetimin e informacioneve deri te publiku, për shkak të kontrollit të konsiderueshëm mbi mediat private dhe shtetërore, presionit të shprehur ndaj punonjësve mediatikë dhe etiketimit të mendimit kritik dhe formave të tjera të shprehjes, drejtuar sidomos kah sektori civil dhe bashkësisë LGBTI. Sulmet e vazhdueshme mbi sektorin civil dhe diskreditimi i tyre ishin gjithashtu shqetësuese, sidomos në etiketimin dhe thirrjet e hapura për dhunë ndaj të a.q. tradhtarë dhe të paguar, me çka bëhet përpjekje për kontrollim të tërësishëm të informacioneve të cilat duhet t'i marrin qytetarët. Gjuha e urrejtjes, në këto tre vitet e fundit, vazhdimisht shënon rritje, veçanërisht në drejtim të publikut kritik, sektorit civil dhe bashkësisë LGBTI. Në përputhje me hulumtimet e Komitetit dhe ndjekjen e gjuhës së urrejtjes, nuk mbetet prapa edhe gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike. Karakteristikë për gjuhën e urrejtjes është se ajo haset në media të caktuara proqeveritare, kryesisht në internet dhe zgjerohet në mënyrë të organizuar nëpërmjet faqeve të internetit dhe personave të caktuar publikë. Shqetësuese për gjuhën e urrejtjes është fakti që ajo nuk sanksionohet, me ç'rast inkurajohet përhapja e saj.<sup>50</sup>

Në vitin 2015 janë vërejtur sulme fizike mbi aktivistë dhe gazetarë kritikues, të cilët njihen nga opinioni më i gjerë për punën e tyre shumëvjeçare ose prezencën e tyre në sektorin civil. Komiteti konstatoi se fushata shumëvjeçare aktive dhe etiketimi i sektorit joqeveritar si “tradhtarë”, “mercenarë të huaj”, “sorosoidë”, “komunarë” mund të rezultojë me dhunë. Është regjistruar rast sulmi mbi aktivistë të OJQ “Sheshi Liria”.<sup>51</sup> Për rritjen e sulmeve ndaj gazetarëve, shih “Liria e mediave dhe qasja deri te informacionet”.

## Liria e mediave dhe qasja deri te informacionet

Në vazhdimësi vërehet kufizim i qasjes deri te informacionet, nëpërmjet kontrollit mbi mediat, sidomos nëpërmjet shërbimit publik Radio-Televizioni i Maqedonisë (RTM). Liria e shprehjes, mediat dhe punonjësit mediatikë rregullisht janë objekt i kritikës në raportet e përparimit të shtetit të Komisionit Evropian. Në mënyrë komplementare në raportet mbi lirinë e mediave dhe për profesionin e gazetarit, në raportet e OSBE/ODIHR, në lidhje me shkallën e objektivitetit të transmetimit të informacioneve deri te qytetarët, sidomos gjatë zgjedhjeve, konstatohet rënie e vazhdueshme e cilësisë së informacioneve, njëanshmëri dhe arbitraritet i mediave nacionale kah pushtetit ekzekutiv. Në fushën e lirive të mediave dhe në korrelacion me lirinë e shprehjes janë konstatuar këto dobësi:

- Dialog i ndërprerë midis pushtetit ekzekutiv dhe organizatave qytetare, që i përfaqësojnë interesat e gazetarëve dhe mediave në tërësi. Në fund të vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014, në mungesë të debatit publik dhe përfshirjes së shoqatave të gazetarëve, janë miratuar pako ligjesh me të cilat rregullohen mediat, për të cilat janë bërë vërejtje serioze nga ana e punonjësve mediatikë: Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale

50 [www.govornaomraza.mk](http://www.govornaomraza.mk).

51 Informim për publikun: <http://mhc.org.mk/announcements/284#>. VxgrUNKqgko.

mediatike,<sup>52</sup> që i rregullon të drejtat dhe obligimet e radiodifuzerëve, si edhe kompetencat e mekanizmit të pavarur apo të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike për kontroll mbi implementimin e obligimeve të ndërmarra, si dhe dhënia dhe marrja e licencave të radiodifuzerëve ose të dënohen mediat për shkak të mosrespektimit të obligimeve, në përputhje me ligjin. Mandej, Ligji për Mediat,<sup>53</sup> që i rregullon parimet themelore dhe kushtet që duhet të plotësohen nga ana e edituesve të mediave, i përcakton termet redaktor përgjegjës dhe redaksi, të drejtën e gazetarit që ta thotë mendimin dhe qëndrimin e vet dhe të refuzojë të kryejë urdhër apo detyrë. Ligji, gjithashtu, i rregullon çështjet për mbrojtjen burimit të informacioneve, impresumit, transparencës në punën e botuesit të medias dhe të drejtën e korigjimit dhe përgjigjes për informacionin e botuar. Në përputhje me raportet e organizatave ndërkombëtare dhe vendase, keqpërdorimi i kompetencave të mekanizmit të pavarësisë apo të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike është i dukshëm në raport me politikën joobjektive ndëshkuese drejtuar mediate kritikuere, mos-përbushjes dhe jo-objektivitetit gjatë veprimit dhe ndëshkimit të mediave gjatë zgjedhjeve të vitit 2014 dhe mungesës së kritikës së tërësishme ndaj radiodifuzerit publik Radio-Televizioni Maqedonas, për shkak të njëanshmërisë në informimin publik dhe mosrespektimin e Statutit të Shërbimit Publik. Domethënë, RTM-ja nuk i plotëson standardet e vendosura me zgjidhjet e reja ligjore dhe pothuajse në tërësi i anashkalon informacionet e ndryshme kritike. Si një shembull i qartë, për punën e shërbimit publik dhe njëanshmërisë së tij ndaj pushtetit ekzekutiv, është distancimi dhe mos-transmetimi i informacioneve në publik për protestat antiqeveritare në tre vitet e kaluara, veçanërisht me sjelljen injoruese në vitin 2015. RTM-ja nuk i ka transmetuar protestat e studentëve, gjimnazistëve dhe të tjerëve dhe i ka injoruar tërësisht konferencat për shtyp të partive opozitare që i kanë shpallur audio-materialet për

aferën më të madhe të përgjimit të qytetarëve në historinë e Republikës së Maqedonisë. Këto ngjarje nuk janë ndjekur fare nga redaksia e RTM-së në gjuhën maqedonase, kurse redaksia në gjuhën shqipe i ka transmetuar informacionet.<sup>54</sup> Si rrjedhojë, vërehet qartë presioni dhe kontrolli i pushtetit ekzekutiv mbi punën e shërbimit publik, që qytetarët e financojnë me pagim të obliguar të taksës mujore të radiodifuzionit.

- **Censura dhe auto-censura e gazetarëve nëpërmjet Ligjit për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje.** Ndryshimet e ligjeve në fushën e mediave filluan në vitin 2012 me përjashtimin e gazetarëve nga përgjegjësia penale për dëm të shkaktuar ndaj nderit dhe reputacionit të personit fizik dhe juridik. Në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Liritë dhe Praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 10), nevoja e miratimit të një ligji për përgjegjësinë qytetare ndaj ofendimit dhe shpifjes është në pakon e reformave që duhej t'i bëjë Republika e Maqedonisë. Me Ligjin për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje rregullohet përgjegjësia qytetare për dëmin e shkaktuar ndaj nderit dhe reputacionit të personit fizik dhe juridik nëpërmjet ofendimit dhe shpifjes. Ligji e garanton lirinë e shprehjes dhe informimit, si një prej bazave kryesore të shoqërisë demokratike. Megjithatë, vetëm një vit pas implementimit të Ligjit u vërejt keqpërdorim i tij nga bartësit e funksioneve të larta publike që e kanë shfrytëzuar ligjin që t'i qërojnë hesapet me mediat dhe gazetarët kritikë. Nga miratimi i Ligjit për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, në nëntor të vitit 2012 e deri në fund të vitit 2014, madje një e treta e procedurave në gjykatën në Shkup janë procese në të cilat si palë janë gazetarët, punonjësit mediatikë ose mediat. Numri më i madh i këtyre procedurave – 82 (75%) kanë përfunduar, kurse 28 (25%) janë në vijim. Është interesante të thuhet se, nga fillimi i vitit 2015 deri në momentin e përfundimit të këtij hulumtimi, në Gjykatën Themelore Shkup 2, janë iniciuar 26 procedura të reja gjyqësore, prej të cilave gjysma (13) janë për media dhe gazetarë. Për disa nga këto lëndë

52 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184, 26 dhjetor 2013, e enjte, viti LXIX, nr. 4457: <http://www.slv.esnik.com.mk/issues/b063254742a44129b8dfe1221762ddb4.pdf>.

53 Ibid., 7, nr. 4458.

54 Raporti i Qendrës për Zhvillim të Mediave: [http://mdc.org.mk/izvestaj-4-monitoring-na-mediumsko-zakonodavstvo/crm\\_izvestaj\\_monitoring-na-avmu-mioa-mrt-sobranie-i-mediumi\\_-dek-2014](http://mdc.org.mk/izvestaj-4-monitoring-na-mediumsko-zakonodavstvo/crm_izvestaj_monitoring-na-avmu-mioa-mrt-sobranie-i-mediumi_-dek-2014).

nuk është mbajtur ende asnjë seancë sepse pritet përgjigje e padisë ose të përcaktohet gjykatësi i cili do ta kryejë procedurën.<sup>55</sup> Duket qartë trysnia që kryhet mbi mediat nëpërmjet sistemit gjyqësor, kurse çon kah zmadhimin të censurës dhe auto-censurës mbi lirinë e shprehjes, informimit publik dhe mediave në tërësi.

- Duke pasur parasysh lidhjen midis pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor, që është vërtetuar me audio-incizimet e publikuara nga partitë opozitare në koalicion, gjykatat kanë vendosur dënime në të holla për bartësit e funksioneve publike në shuma të mëdha vetëm për mediat dhe gazetarët kritikë. Gjithashtu, redaktorët dhe gazetarët e afërm me pushtetin ekzekutiv shpesh shfaqen si të paditur dhe paditës për të cilët gjykata vendos në procedurë të shpejtë dhe në favor të tyre. Si shembuj më eklatantë, që flasin për njëanshmërinë e gjykatës, janë rastet ku paditësit ose të paditurit janë persona publikë, sidomos kritikë ndaj punës së pushtetit ekzekutiv për vitin 2014 dhe 2015: drejtori i Drejtorisë së Sigurimit dhe Kundërzbulimit, Sasho Mijalkov, me kërkesë dëmtuese të fituar për ofendim dhe shpifje në lartësi prej 9.000 eurosh kundër gazetës ditore “Fokus”.<sup>56</sup> Me qëllim që të mos fiket një prej mediave më prestigjioze kritike në shtet, mjetet ishin mbledhur nëpërmjet thirrjes solidare për mbështetje nga qytetarët. Sulmet mbi këtë medium dhe procedurat gjyqësore kundër ish redaktorit Nikolla Mlladenov, i cili humbi jetën në aksident automobilistik, në rrethana të dyshimta, vazhdoi me presion mbi redaktoren e re të emëruar, gazetaren Jadranka Kostovska. Në kundërshtim me procedurat, kundër mediave dhe gazetarëve kritikë, përpjekjet për fitim të padive kundër bartësve të funksioneve publike, është një golgotë e vërtetë. Në rastin e Qytetarëve për Maqedoni Evropiane (QME), si shoqatë qytetarësh të cilët i padit për ofendim dhe shpifje ministri i Financave Zoran Stavrevski dhe zëdhënësi i VMRO-DPMNE-së, Aleksandar Biçikliski dhe i Partisë Serbe, Malisha Stankoviç, vazhdon nga viti 2011. Në katër vitet e

55 Hulumtim i OJQ Infoqendra zbatuar në suazat e projektit “Rrjeti 23”: “Cili është çmimi i lirisë së shprehjes?” (hulumtimi kryer mbi zbatimin dhe ndikimin e Ligjit për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje në Maqedoni), Shkup, prill 2015.

56 *ibid.*, 10.

kaluara, të akuzuarit nuk janë paraqitur në seanca, kurse gjykata në mungesë nuk ka marrë vendim edhe pse ka autorizim të tillë.

- **Mungesa e mbështetjes dhe veprimit gjyqësor**, në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Analiza e aktgjykimeve gjyqësore, në përputhje me Ligjin për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, që kishte për qëllim t’i përforcojë mekanizmat e shprehjes së lirë dhe lirisë së mediave, ka dhënë efekt të kundërt. Përveç keqpërdorimit të zgjidhjes ligjore, nga bartësit e funksioneve të larta publike, pushteti gjyqësor refuzon ta ndjekë praktikën e GjEDNj-së. Siç konstatoi edhe analiza e OJQ Infoqendra në suazat e “Rrjetit 23”, gjykatat nuk i ndjekin parimet, dhe as nuk i respektojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga analiza mund të nxirret përfundimi se gjykatat e zbatojnë pak ose aspak testin me tri pjesë që është i obliguar gjatë përcaktimit se a janë përmbushur kushtet për kufizimin e lirisë së shprehjes. Ky test e parashikon: (1) Kufizimi duhet të përcaktohet me ligj; (2) Kufizimi duhet të ketë qëllim legjitim dhe (3) Kufizimi duhet të jetë i domosdoshëm për një shoqëri demokratike. Sipas rasteve, për të cilat janë ngritur lëndë gjyqësore, gjykatat më shpesh duhet t’i përmbahen qëllimit të legjitimitetit nga testi me tri pjesë, që në të vërtetë i referohet paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ndërkaq në të është vendosur lista përfundimtare e qëllimeve për shkak të të cilave mund të imponohet kufizimi i të drejtës së lirisë së shprehjes.<sup>57</sup>
- Praktika e deritanishme dhe analiza e aktvendimeve të plotfuqishme dëshmon se ekziston dallim drastik në punën e gjykatës, kur bëhet fjalë për procese në të cilat si palë shfaqen politikanët/funksionarët shtetëror, përkundërt rasteve ku nuk ka involvim të tyre, as si paditës as si të paditur. Si në rastet kur njëra nga palët është funksionar shtetëror, përkatësisht politikan, është e qartë që ato zhvillohen shpejt, përkatësisht është e dukshme tendenca për procedurë urgjente nga gjykata. Gjithashtu, në raste të tilla zbatimi i

57 *ibid.*, 10.

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika e Strasburgut, që midis të tjerash, parashikon që bartësit e funksioneve publike të kenë prag më të madh të tolerancës, në raport me kritikën, nuk është ndjekur dhe është në drejtim të mbrojtjes së nderit dhe reputacionit të funksionarëve, përkundrajt lirisë së shprehjes.<sup>58</sup>

- Diskreditimi publik, dënimet me burg dhe ndjekja e gazetarëve për shkak të informacioneve dhe mendimeve të nxjerra në publik në rastet e gazetarëve Tomislav Kezharovski dhe Jadranka Kostova. Rasti i gazetarit Tomosllav Kezharovski, i cili ishte akuzuar për rrezikim të dëshmitarit të mbrojtur, me tekstin e botuar në vitin 2008 për rastin “Likuidimi”, ishte arrestuar në vitin 2013, kurse pastaj, nëpërmjet keqpërdorimit të masës paraburgim, në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën është privuar nga liria pothuajse dy vjet.<sup>59</sup> Në një procedurë tërësisht të njëanshme gjyqësore, gazetari është dënuar me katër vjet dhe gjashtë muaj burg,<sup>60</sup> që epilogun e fundit ta presë në shkurt të vitit 2015 nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Apelit në Shkup, që u vonua dhjetë muaj për shkak të kinse labirinteve burokratike, duke shkelur nenin 5 (e drejta e lirisë) dhe nenin 6 (e drejta e gjyqimit të drejtë).<sup>61</sup> Si rrjedhojë, vendimi i shumëpritur është marrë në janar të vitit 2015 me zvogëlim të dënimit me burg deri në dy vjet, pothuajse identike me kohën e kaluar në paraburgim, gazetari Kezharovski është shpallur si fajtor.<sup>62</sup> Në lidhje me përndjekjen e gazetares Jadranka Kostova, pushteti ekzekutiv e ka shfrytëzuar të a.q. Ligj për lustrim dhe pas fjalimit të saj publik për rastin Nikolla Mladenov, në mënyrë të shpejtë, është shpallur bashkëpunëtorë e shërbimeve sekrete në vitet 1991-

1993.<sup>63</sup> Është përforcuar edhe presioni mbi gazetarët e tjerë kritikë, siç janë Borjan Jovanovski dhe anëtarët e familjes së tij dhe ndaj gazetarëve të cilët janë shënjestër edhe të kërcënimeve me vdekje, që tani për tani mbeten të pazgjdhura nga Ministria e Punëve të Brendshme.<sup>64</sup>

- **Korrupsioni në media:** Republika e Maqedonisë nuk i përmbahet përcaktimit për ta hequr korrupsionin në media, që është rezultat i strukturës së pronësisë dhe lidhjes së afërme me pushtetin ekzekutiv dhe përkatësinë partiake që ndikon mbi lirinë e mediave. Domethënë, në studimin e rastit, të përpunuar nga gazetari Vlado Apostollov, anëtar i Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Mediave (SPGM), konstatohet se një nga shkaqet kryesore për rënien e lirisë së mediave është pikërisht korrupsioni sistematik i vendosur nëpërmjet strukturës pronësore të mediave dhe financimit të mediave nëpërmjet fushatave reklamuese të qeverisë.<sup>65</sup> Marrëdhëniet e afërme personale të pronarëve me pushtetin ekzekutiv, të cilat i thekson Apostollov, ishin përcaktuar me informacionet e nxjerra nga partitë e opozitës në audio-materialet. Domethënë, bartësit e funksioneve të larta publike, siç është shefi i kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë dhe drejtori i Agjencisë për Sigurim dhe Kundërzbulim, janë në lidhje direkte me mediat private nacionale: “Sitell”, “Kanal 5” dhe “Alfa” dhe ndikojnë mbi përmbajtjen, mënyrën dhe kohën e shpalljes së informacioneve për evenimentet me rëndësi për partinë në pushtet VMRO-DPMNE. Aq më tepër që edhe shërbimi publik i radiodifuzionit, nëpërmjet strukturës udhëheqëse, është i uzurpuar tërësisht nga pushteti ekzekutiv dhe politika redaktuese varet nga nevojat e tyre gjatë informimit publik të qytetarëve.<sup>66</sup> Edhe pse, anëtarët e partive dhe anëtarët e familjes më të ngushtë, në përputhje me Ligjin për shërbime audio dhe audiovizuale (neni 38), nuk mund të jenë pronarë të mediave dhe internet-portaleve, ky

58 Ibid., 10, fq. 16, konkluzione të analizës.

59 Lajmërim për Publikun, 26 korrik, 2013: <http://www.mhc.org.mk/announcements/143#.VXgTv9Kqkqk>.

60 Lajmërim për Publikun, 23 tetor, 2013: <http://www.mhc.org.mk/announcements/154#.VXgT7dKqkqk>.

61 Raporti mujor MHK nëntor-dhjetor 2014: [http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/861/Dvomesecen\\_izvestaj\\_noemvri\\_dekemvri\\_2014.pdf](http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/861/Dvomesecen_izvestaj_noemvri_dekemvri_2014.pdf)

62 Raporti mujor KHM janar 2015: <http://mhc.org.mk/reports/271#.VXgXAdKqkqk>.

63 Raporti mujor KHM mars 2015: <http://mhc.org.mk/reports/281#.VXgZo9Kqkqk>.

64 Set lajmesh për kurorën e varrimit të dërguar në shtëpinë e Borjan-it Jovanovskit: <http://www.time.mk/c/5276636d22/skandalozono-mrtovecki-venec-ispraten-za-novinarot-borjan-jovanovski.html>.

65 Studim i rastit: “Mediat, pronarët, gazetarët dhe të drejtat e punëtorëve”, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Mediave (SPGM), Shkup, 2015.

66 Ibid., 20.



Ligj nuk respektohet aspak. Në mungesë të mekanizmit të pavarur, për kontroll të strukturës së pronësisë së mediave dhe politikës së barabartë të dënimit, liria e mediave mbetet të jetë e kushtëzuar nga pushteti ekzekutiv, i cili dominon me investimet nëpërmjet reklamave me interes publik në mediat nën kontrollin e saj, duke vendosur raport financiar të varur mbi lirinë e informimit publik dhe mediave në tërësi. Mungesa e transparencës së Qeverisë në shpenzimin e të hollave publike për reklamim dhe vendosje të sistemit ishte shpallur vitin e kaluar. Siç thotë Apostollov: “Qeveria jo vetëm që nuk ishte transparente para qytetarëve të vet por ajo informacionin për shpenzimet rreth reklamave e ka fshehur edhe nga Komisioni Evropian”. Verën e vitit 2013 zëvendëskryeministri Fatmir Besimi mori obligimin para eurokomisarit të atëhershëm, Shtefan Fyle, se do të dorëzojë informacione të detajuara për shpenzimet e fushatave, megjithatë madje gjashtë muaj më vonë Komisioni Evropian pranoi se nuk ka marrë një të dhënë të tillë. Vitin e kaluar, pas një presioni pesëvjeçar nga Brukseli dhe nga publiku në Maqedoni, pushteti i shpalli shumat e shpenzuara për reklama, vetëm për vitin 2012, 2013 dhe për gjashtë muajt e parë të vitit 2014.<sup>67</sup> Në këtë periudhë Qeveria ka zhvilluar 27 fushata në media, për të cilat ka shpenzuar 18 milionë euro. Analiza e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, për këto të dhëna thotë se shpërndarja e fushatave nuk ka kritere të qarta, i vetmi që ekziston është shkelur. Në raportin qeveritar thuhet se një prej kriteve për distribuim të fushatave është shikimi dhe rejtingu i mediave, megjithatë në vitin 2013 televizioni “Alfa” ka emituar gjashtë herë më tepër reklama qeveritare se “Sitell”, edhe pse ka pasur shikim nëntë herë më të vogël? Me kaq shumë mjete në media, Qeveria bën sulm të vërtetë dhe e çorienton tregun e reklamave, që është dëm për vetveten. Analiza e ShGM-së dëshmon se Qeveria, në vitin 2013, me 7,2 milionë euro, ka zënë hapësirë të njëjtë në media, aq sa kanë së bashku “Procter & Gembell”, “Koka-kola” dhe “One”.<sup>68</sup> Në përputhje me parregullsitë e vërejtura, në tre vitet e fundit, në Republikën e Maqedonisë vërehet edhe rënditje jopërkatese e fuqive në garën midis

partive politike, përfaqësim i pabarabartë në media në favor të partive në pushtet, sjellje të papërgjegjshme, të pabarabartë dhe korruptive të partive në pushtet, nëpërmjet donacioneve të mbledhura, presioneve mbi administratën publike si trupi më i madh votues dhe sistemit të pa-ndëshkueshmërisë që e cenon në vazhdimësi të drejtën e votës.<sup>69</sup> Mandej, në përputhje me organizatat vëzhguese vendase dhe ndërkombëtare, gjatë zgjedhjeve në vitin 2014, është vënë re njëanshmëri në informimin për bartësit e funksioneve të larta publike, në favor të partisë në pushtet dhe trajtim të pabarabartë në promovimin e partive politike në media, në favor të VMRO-DPMNE-së. Zgjedhjet e zbatuara në vitin 2014 dhe zgjedhjet lokale të zbatuara në vitin 2013, i vërtetojnë dyshimet mbi shkeljen e të drejtës së votës së qytetarëve. Njëkohësisht, i çon të gjitha proceset demokratike në stagnim të plotë. Me braktisjen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë nga ana e opozitës dhe mosnjohjen e rezultateve të zgjedhjeve, filloi kriza politike që rezultoi me shpalljen e audio-incizimeve për kinse veprimet korruptive, kriminale, parregullsitë në zgjedhje dhe ndikimin mbi mediat nga partitë e koalicionit në pushtetin ekzekutiv.

- **Ndalimi i informimit:** Kufizohet edhe e drejta e informimit të opinionit, kur bëhet fjalë për punën e Gjykatës Kushtetuese, duke marrë parasysh vendimin e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, seancat publike në Gjykatën Kushtetuese tashmë të mos transmetohen me regjistrim audio dhe video. Kjo praktikë vlerësohet si censurë gjatë informimit publik për çështje me interes publik, siç ishte diskutimi për ndryshimet kontestuese në Ligjin për ndërprejren e shtatzënisë. Sa për rikujtim, ky precedent nga kryetari ishte bërë për herë të parë në qershor të vitit 2014, ndërkaq kësaj i parapriu vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ta refuzojë kërkesën për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të nenit 110 alineja 3 të Kushtetutës, që kanë lidhje me lirinë e shprehjes publike dhe informimin për ngjarjet e 24 dhjetorit 2012.<sup>70</sup>

67 Projekt hulumtues gazetaresk mbi strukturën e pronësisë së mediave në Maqedoni: <http://www.mediapedia.mk/>.

68 *ibid.*, 20, fq. 12.

69 Raport, zgjedhje, 2014 OSBE/ODIHR: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true>.

70 [http://mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/764/Mesecen\\_Juni\\_2014.pdf](http://mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/764/Mesecen_Juni_2014.pdf).

## Liria e tubimit dhe shoqërimit

Liria e shoqërimit dhe e drejta e protestës janë të drejta të përafërta të garantuara me legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar. Në përputhje me kornizën juridike ndërkombëtare, këto dy të drejta komplementare përfaqësohen në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 18, 19, 20, 21 dhe 22, pastaj në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 9 dhe 11 dhe në përputhje me legjislacionin nacional. Kushtetuta e Maqedonisë në nenin 20 dhe 21 dhe Ligji për fondacione dhe shoqata të qytetarëve, Ligji për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe Ligji për tubime publike, i garantojnë të drejtat e shoqërimit të lirë dhe protestës paqësore në korrelacion me të drejtën e shprehjes së lirë. Në Republikën e Maqedonisë, në tre vitet e kaluara, vërehen përpjekje për pengimin e tubimeve publike në forma të ndryshme, si edhe përpjekje për asfiksimin e të drejtës së protestës paqësore nga pushteti ekzekutiv. Në punën rrjedhëse, të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe raportet që i përgatit nëpërmjet mbikëqyrjes së këtyre dy të drejtave, janë konstatuar këto praktika:

- Pengimi i tubimeve apo protestave publike nga nëpunës policorë, të cilët e kanë siguruar protestën me vendosjen e kordonit në vendin e shënuar për protestë, si edhe përpjekje për frikësim me pretekst se pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve të cilët nuk protestojnë.
- Provokime/ofendime verbale nga nëpunësit policorë, me dhe pa uniformë, drejtuar qytetarëve/organizatorëve të protestave.
- Mbrojtje me heshtje dhe mosmarrje të përgjegjësisë për ofendimet verbale të thëna apo për zbatimin e forcës ndaj qytetarëve gjatë protestës nga nëpunësit policorë. Është vërejtur praktikë e refuzimit të legjitimitit të nëpunësit policor nëpërmjet tërheqjes së nëpunësit policor nga protesta dhe metoda të tjera, me çka pamundësohet procedura para organit kompetent në rastin Sektori i Punëve të Brendshme në MPB.
- Presion dhe etiketimi i qytetarëve, si politikisht të padëshirueshëm dhe lidhja e tyre me partitë opozitare,

nga pushteti ekzekutiv nëpërmjet fushatave aktive dhe simultane kundër qytetarëve.

- Vendosja e kordonit (unazës) së nëpunësve policorë rreth qytetarëve që protestojnë. Kjo praktikë duhet të ndiqet në të ardhmen, duke pasur e parasysh se më parë nuk është vënë re si karakteristikë për sigurimin e protestave paqësore dhe tubimeve publike.
- Dy raste të legjitimitit të qytetarëve pas përfundimit të protestës me ndjekje paraprake të qytetarëve. Bëhet fjalë për protestat e të falimentuarve të mbështetura nga Shoqata e Qytetarëve "Solidariteti" dhe legjitimimi i një anëtarit nga kjo organizatë, kurse në rastin e dytë, student i cili ka përdorur dron për xhirimin e protestave të studentëve. Të dyja rastet janë regjistruar në vitin 2014.
- Është vënë re praktika e marrjes së video-materialeve dhe fotografive nga gazetarët dhe qytetarët gjatë protestave në dy raste. Më konkretisht, bëhet fjalë për fshirjen e materialeve të gazetarëve gjatë demonstratave të dhunshme në Lagjen Gjorçe Petrov dhe në Bit Pazar, që ndodhën vitin 2014.
- Forca e tepruar dhe e joproportionale, e përdorur nga policia gjatë protestave paqësore dhe demonstratave të dhunshme. Komiteti ka konstatuar përdorim të forcës së tepruar dhe joproportionale gjatë protestës paqësore të të falimentuarve, të mbajtur në shkurt të vitit 2014, dhe gjatë protestave spontane të qytetarëve, në maj të vitit 2015. Në lidhje me demonstratat e dhunshme është vërejtur forcë e tepruar gjatë protestave në lagjen Gjorçe Petrov, me rastin e vrasjes së një të riu nga lagja, të mbajtura në maj dhe demonstratat kundër aktgjykim të të a.q. rast "Liqeni i Smilkovës" në fund të qershorit 2014.
- Kundërprotesta qeveritare të organizuara si mjet për shtypjen e mendimit kritik dhe shoqërimit të qytetarëve. Janë regjistruar dy raste më serioze të protestave të organizuara nga VMRO-DPMNE nëpërmjet pushtetit ekzekutiv, në periudhën nga 2013 deri 2015: Sulme mbi Komunën Qendër nga të a.q. Shoqata e Qytetarëve "Veritas" në qershor 2013. Duke e pasur parasysh se për këtë rast ka audio-incizime, të cilat partitë e opozitës i publikuan në vitin 2015, duhet të shënohet

se asnjë demonstrues nuk është legjitimuar dhe dënuar, si dhe asnjë bartës i funksionit të lartë publik (Kryeministri Nikolla Gruevski shfaqet si organizator) për organizimin e demonstratave dhe keqpërdorimin e funksioneve publike të të gjithë pjesëmarrësve, prej të cilëve një pjesë ishin të punësuar në administratën publike. Në vitin 2015, me fillimin e publikimit të audio-incizimeve për qeverisjen kriminele të pushtetit ekzekutiv, ishte organizuar kundërprotestë nga Ndërmarrja e Komunikacionit Publik, në muajin maj, me nxjerrjen e autobusëve të transportit publik para ndërtesës së partisë opozicionere LSDM.

- Etiketimi dhe cenimi publik i privatësisë, reputacionit, nderit dhe dinjitetit të një numri aktivistësh, për shkak të dukshmërisë dhe këmbënguljes së tyre, vazhdon të jetë një prej mënyrave më të përfaqësuara nëpërmjet të cilave pushteti ekzekutiv përpiqet t'i asfiksojë lëvizjet formale dhe joformale, shoqatat e qytetarëve dhe protestat paqësore. Duke i vendosur mekanizmat për shkaktim të frikës nga etiketimi apo lidhja e qytetarëve, si pjesë e partive opozitare, ndikon mbi përzgjedhjen e tyre që të mos t'i praktikojnë të drejtat e veta.<sup>71</sup>

## Trajtimi i personave vulnerabil socialë, personave me aftësi të kufizuara dhe parimi i mosdiskriminimit

Korniza ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke filluar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat Civile, Politike dhe Ekonomike dhe Sociale, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe deklaratat konkrete dhe konventat që u kundërvihen të gjitha formave të diskriminimit, e obligojnë shtetin të sigurojë minimum kushte dhe aktivisht të miratojë politika publike inkluzive, me çka do ta zvogëlojë

dhe eliminojë diskriminim në shoqëri.<sup>72</sup> Karta e të Drejtave Themelore të BE-së e ndalon diskriminimin. Me direktivat e BE-së 2000/43, 2000/78 dhe 2006/54 KE ndalohet diskriminimi në bazë të gjinisë, racës apo prejardhjes etnike, fesë apo bindjes, aftësive të kufizuara, moshës apo orientimit gjinor. Si shtet kandidat, Republika e Maqedonisë duhet t'i harmonizojë dhe zbatojë të gjitha këto direktiva. Njëkohësisht, shteti ka obligim t'i identifikojë grupet vulnerable dhe të marginalizuara dhe t'u mundësojë kornizë juridike dhe politike inkluzive, nëpërmjet të cilës do të sigurohet qasje e barabartë deri te të drejtat dhe obligimet. Republika e Maqedonisë ballafaqohet me shkeljen e barazisë, si parim kushtetues në përputhje me preambulën e grupeve të pakicave grupeve vulnerable dhe të marginalizuara (shiko diskriminimin).

Në raport me gjendjet e grupeve vulnerable dhe të marginalizuara, në nivel lokal dhe në suazat e projektit "Rrjeti 23", Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara" zbatoi anketë në tri komuna: Qendër, Strumicë dhe Manastir, ku përcaktoi formalitet në zbatimin e planeve lokale aksionare. Emëruesi i përbashkët për të tri komunat është ekzistimi i kornizës formale të akteve, që duhet të kontribuojnë në arritjen e barazisë gjinore, kushteve më të mira për mjekim të përdoruesve të drogave dhe mbrojtje nga diskriminimi i njerëzve, përfaqësuesve të bashkësisë LGBTI. Në nivel lokal është konstatuar nivel i ulët i njohjes së gjendjeve dhe nga kjo rrjedh pamundësia e zbatimit të politikave përkatëse publike, që do të kryenin dallim thelbësor në luftën kundër diskriminimit. Vendosija e mekanizmave, siç janë Komisionet për barazi midis burrave dhe grave, apo planet aksionare që kanë për qëllim ta përmirësojnë mbrojtjen shëndetësore të grupeve vulnerable, mungojnë për shkak të kompetencave të kufizuara, mosbashkëpunimit me mekanizmat e pavarur të nivelit qendror (Komisioni për Ndalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit) dhe me organizatat lokale qytetare që punojnë në këto fusha. Mosnjohja e nevojave të njerëzve të bashkësisë LGBTI nuk mund të kontribuojnë në krijimin e politikave publike, të

71 Raportet mujore dhe vjetore të Komitetit të Helsinkit, i cili i ka mbikëqyruar të gjitha protestat paqësore dhe demonstratat në periudhën nga viti 2013 deri në 2015: <http://mhc.org.mk/pages/reports#>. VXhDYNKqkko.

72 Diskriminimi – Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit mbi Gratë, OKB, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor – Këshilli i Evropës dhe konventat e tjera shoqëruese si ndalim për diskriminim në arsim, të drejtat e fëmijës etj.

cilat do të mundësojnë mbrojtje nga dhuna dhe format e diskriminimit me të cilat ballafaqohen ata. Njëkohësisht, senzibiliteti i pamjaftueshëm dhe mosnjohja e nevojave të grupeve të marginalizuara dhe vulnerable të anëtarëve të komisioneve, si dhe bashkëpunimi minimal me organizatat qytetare dhe publikun ekspert, e bëjnë të pamundur qasjen deri te të drejtat dhe drejtësia e këtyre grupeve.<sup>73</sup>

## Bashkësia LGBTI

Diskriminimi dhe raporti injorues i Prokurorisë Publike në rastet e sulmeve, dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe kimit nga urrejtja, si dhe mohimi sistematik i ekzistencës së bashkësisë nga pushteti ekzekutiv, në përputhje me raportet e Komisionit Evropian dhe organizatave joqeveritare që i përfaqësojnë të drejtat e tyre, janë problemi më i dukshëm për Republikën e Maqedonisë. Domethënë, bashkësia ballafaqohet me gjashtë sulme në evenimente publike që janë mbajtur në objekte apo gjatë mbajtjes së "Marshit të tolerancës", të organizuar nga Komiteti i Helsinkit kundër të gjitha homofobive dhe transfobive në vitin 2013. Në dy vitet e kaluara, bashkësia ka luftuar me institucionet dhe sistemin gjyqësor, që refuzojnë ta njohin dhunën sistematike dhe të strukturuar, kurse njëkohësisht dhe të mbrojnë nga diskriminimi, duke përfshirë edhe orientimin seksual në nenin 3 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.<sup>74</sup> Fushata e përforcuar homofobike, në vitin 2014, ka rezultuar me propozim-amendamentet kushtetuese me të cilat bëhet përpjekje për shtypjen e tërësishme të bashkësisë nëpërmjet përkufizimit të rreptë të martesës, si bashkësi midis një burri dhe një gruaje.

Më 23 tetor 2014 është regjistruar edhe sulmi i gjashtë mbi objektin ku po mbahej evenimenti publik për shënimin e funksionimit dyvjeçare të LGBTI-së Qendra për Mbështetje, e cila ka qenë shënjestër e sulmeve nga themelimi i saj në tetor të vitit 2013. Amendamentet Kushtetuese janë ndërprerë për shkak të krizës politike, por nuk mungon fakti se pushteti

ekzekutiv vazhdon me diskreditimin, diskriminimin dhe nxitjen publike të dhunës ndaj bashkësisë.<sup>75</sup> Prokuroria Publike vazhdon të mos veprojë sipas obligimit zyrtar, edhe pse sulmet mbi bashkësinë janë informacione publike, si edhe ta dallojë krimin dhe gjuhën e urrejtjes ndaj bashkësisë.

## Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale

Liria e lëvizjes dhe qasjes deri te transporti publik i personave me aftësi të kufizuara fizike në Republikën e Maqedonisë nuk është çështje me interes apo prioritet për pushtetin qendror dhe lokal. Edhe pse Republika e Maqedonisë është obliguar të sigurojë trajtim të barabartë apo qasje deri te të drejtat dhe drejtësia pa diskriminim, megjithatë ky obligim nuk reflektohet në mjediset dhe vetëqeverisjet lokale, kurse si rrjedhim vështirësohet jeta e grupeve vulnerable nëpërmjet kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe qasjes deri te shërbimet dhe të mirat publike. Rezultatet e hulumtimit "Rrugët e reja në Shkup dhe të drejtat themelore të qytetarëve", i zbatuar nga "Sheshi Liria", në suaza të këtij Projekti, dëshmojnë qartë për mosrespektimin e të drejtës për lëvizjen e lirë dhe papengesa të qytetarëve me aftësi të kufizuara fizike, që nuk mund të gëzojnë qasje të barabartë në lirinë e lëvizjes dhe shërbimet publike dhe të mirat publike, sepse pengesat fizike (parkimi i mjeteve motorike, rrugët e pa-adaptuara për personat me kufizim fizik) në të a.q. hapësirë e lirë për lëvizje, siç janë trotualet dhe sinjalizimi i qarkullimit, bëjnë të pamundur lëvizjen e pavarur, madje në shumë raste edhe lëvizjen me shoqërim. Planifikimi urban jopërkates dhe sensibilizimi i autoriteteve publike, për nevojat e kësaj kategorie të qytetarëve, si dhe vetëdija e ulët për ekzistencën e tyre, çojnë kah kufizimi i tërësishëm i të drejtës së garantuar kushtetuese, siç është lëvizja e lirë dhe qasja e barabartë deri te të drejtat dhe drejtësia. Së këtejmi, hapësira publike, vetvetiu, mundëson diskriminim të rritur ndaj këtij grupi të qytetarëve.

73 Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara" Analiza e mekanizmave për mbrojtje nga Diskriminimi i grupeve të marginalizuara në nivel lokal: Komuna Manastir, Komuna Strumicë dhe Komuna Qendër, Shkup 2014/2015.

74 Raporti vjetor i Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi: <http://mhc.org.mk/reports/282#.Vbl0eqSqkko>, Shkup, 2014

75 Te fusnota 69 ibid.62


## Romët – lëvizja e lirë, diskriminim në bazë etnike dhe racore

Në përputhje me raportet e Rrjetit kundër diskriminimit, romët në Republikën e Maqedonisë ballafaqohen me një shkallë të lartë të diskriminimit, ndarjes dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes në kalimet kufitare në shtet. Domethënë, qasja deri te të drejtat dhe drejtësia mbetet e kufizuar dhe injorohet si nga gjykatat kompetente ashtu edhe nga mekanizmi i pavarur për mbrojtje nga diskriminimi apo Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. Edhe përkrah numrit të madh të ankesave, Komisioni, prej tri vjetësh, nuk ka vendosur për asnjë ankesë ndaj ndarjes së fëmijëve romë në shkollat fillore në Manastir. Kthimi i romëve nga kalimet kufitare ka marrë përmasa të mëdha. Qytetarët e bashkësisë etnike rome kanë dorëzuar ankesa deri te organizatat joqeveritare sepse nuk kanë besim në institucionet dhe sistemi gjyqësor nëpërmjet të cilëve janë të aksesshme informacionet për diskriminim racor dhe etnik.<sup>76</sup> Komiteti i Helsinkit ka zbatuar "Testim të situatës", si mjet për dëshim të diskriminimit sistematik të qytetarëve dhe profilizimit racor nga shërbimet kufitare. Raporti i tillë ndaj bashkësisë etnike rome ka të bëjë me praktikën jokushtetuese të cilën e ka vendosur Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2013, si arsyetim për numrin e rritur të azilkërkuessve për shkaqe ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Tendenca për kthimin e romëve nga kalimet kufitare, nga institucionet në Republikën e Maqedonisë edhe më tej e kufizon të drejtën e lëvizjes së lirë të qytetarëve të kësaj bashkësie etnike.

## Barazia gjinore dhe të drejtat e grave

Janë shqetësuese gjendjet me numrin e rritur të denoncimeve të dhunës kundër grave dhe dhunës familjare që në vitin 2014/2015 ka rezultuar me një numër të rritur të femicideve apo vrasjeve të kryera nga burrat në bashkësinë martesore apo të marrëdhënies të afërme personale me gratë. Në përputhje me raportet e Rrjetit kundër dhunës mbi gratë dhe dhunës familjare, femicidi është forma më e rëndë e dhunës mbi gratë

dhe mund të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e dhunës familjare apo dhunës të partnerit intim.<sup>77</sup> Në Republikën e Maqedonisë, vetëm në vitin e fundit ka katër raste të femicidit. Këto janë vrasjet e grave dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të kryera nga partneri/bashkëshorti/ish-bashkëshorti, të cilat kanë ndodhur në periudhën maj-nëntor 2014.<sup>78</sup> Shteti nuk i ka plotësuar kushtet për sigurimin e mbrojtjes së drejtë të grave-viktima të dhunës familjare apo ndonjë dhune tjetër. Në përputhje me raportet e Komisionit Evropian dhe organizatave joqeveritare, që e përbëjnë Rrjetin e sipërpërmendur, nevojiten ndryshime të rrënjësishme në kornizën ligjore për mbrojtjen e viktimave, përmirësimin e kushteve në qendrat e strehimit "Shellter" si dhe vigjilencë e shtuar, profesionalizëm dhe reagim përkatës nga nëpunësit policorë, të cilët vijnë në kontakt me viktimat.



76 Raporti vjetor i Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi për vitin 2014: [http://mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/928/\\_\\_\\_\\_\\_2014.pdf](http://mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/928/_____2014.pdf).

77 Termi feminidit shënon vrasjen me dashje të gruas, sepse është grua, por përkufizimi më i gjerë e shpjegon këtë term si vrasje të grave dhe vajzave për shkak të gjinisë, torturës ose vrasjes mizogjenike të gruas, vrasjes në emër të nderit, vrasje drejtuar grave në kontekstin e konfliktit të armatosur, feticid, sakatim gjenital me vdekje. Femiciditetin e kryen mashkulli, shpesh partner i tanishëm apo i mëparshëm, kurse i pararend keqtrajtim shumëvjeçar në familje, kërcënime dhe frikësime, dhunë seksuale apo situata ku gratë janë më pak të fuqishme dhe kanë resurse më të vogla se partneri i vet.

78 Burimi, Rrjeti për Mbrojtje të Grave nga Dhuna dhe Dhuna Familjare: <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/05-12-2014-fizichko-nasilstvo-i-femitsid/>.

# KONKLUZIONE DHE RREKOMANDIME

## Konkluzione

1. Shteti nuk siguron mbështetje përkatëse juridike, mjekësore, psikologjike dhe sociale për viktimat nga tortura, nuk zbaton politikë të zero tolerancës ndaj akteve të torturës dhe nuk e mposhtë fenomenin e mosndëshkimit të nëpunësve shtetërorë.
2. Partia politike në pushtet, me keqpërdorimin e sistemit për përgjim, i ka shkelur të drejtat themelore të njeriut të qytetarëve, sidomos të drejtën e privatësisë, të drejtën e sigurisë dhe të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të minimum 20.000 qytetarëve. Përfaqësuesit e lartë qeveritarë, me keqpërdorimin e pozitës së vet zyrtare dhe autorizimit, kanë ndërmarrë një numër të madh të veprimeve joligjore, që flasin për korrupsion dhe cenim të parimit të shtetit juridik, ndarjes së pushtetit dhe sundimit të së drejtës.
3. Është rritur presioni mbi shoqërinë civile, mbi aktivistët dhe përfaqësuesit e sektorit civil dhe asfiksioni i strukturuar i lirisë së shprehjes, shoqërimin dhe të drejtës së protestës në vitin 2014 dhe 2015, me qëllim që të parandalohet kritika ndaj pushtetit ekzekutiv.
4. Është rritur numri i rasteve të regjistruara të gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja që nuk janë identifikuar nga Prokuroria Publike, e cila ka kompetencë të veprë sipas detyrës zyrtare nëse këto raste janë transmetuar në mediat publike.
5. Liria e mediave dhe qasja deri te informacionet me karakter publik vazhdon të jenë të kufizuara përmes ndryshimit të ligjeve pa përfshirjen e publikut ekspertë dhe palëve të interesuara. Presioni mbi gazetarët kritikë vazhdon nëpërmjet shqiptimit të dënimeve me burg, proceseve të lustrimit apo kërcënimeve për jetën dhe diskreditimin e nderit dhe reputacionit nga mediat proqeveritare.
6. Shërbimi publik radiodifuziv nuk i plotëson obligimet ligjore, as standardet ndërkombëtare dhe të drejtën e objektivizimit dhe shumëllojshmërisë së dhënies së informacioneve me karakter publik. Radio-Televizioni Maqedonas është nën kontrollin e pushtetit ekzekutiv, kurse një numër i madh i mediave nacionale private punojnë nën direktivën e partive që janë në pushtet.
7. Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike, si mekanizëm i pavarur për kontroll të mediave dhe të informimit objektiv, ka qasje selektive për ndëshkimin e mediave kritike, kurse punon në dobi të mediave proqeveritare dhe të pushtetit ekzekutiv. Është e theksuar sidomos politika e mosndëshkimit të mediave, të cilat e kanë shkelur Kodin Zgjedhor gjatë zgjedhjeve në vitin 2014.
8. Partizimi i Gjykatës Kushtetuese rezulton me kufizim të qasjes të informacioneve deri te publiku gjatë seancave publike për çështje me interes publik.
9. E drejta e protestës kufizohet nëpërmjet formave të pengimit të tubimeve publike ose vazhdon praktika e etiketimit, ofendimit dhe shpifjeve ndaj aktivistëve qytetarë. Informimi proqeveritar i publikut merr përmasa të mëdha dhe ka për qëllim t'i diskreditojë të gjitha lëvizjet formale dhe joformale, që u kundërvihen politikave të pushtetit ekzekutiv. Nëpunësit e policisë e kufizojnë të drejtën e protestës paqësore nëpërmjet moslejimit të qasjes deri te institucionet para të cilave shprehet pakënaqësia. Janë regjistruar edhe raste të përdorimit të forcës së tepruar dhe të joproporcionale për shpërndarjen e turmës.
10. Liria e bindjeve dhe liria fetare për regjistrimin e denominacioneve, që dalin nga kisha ortodokse dhe bashkësia fetare islame, duken të pamundshme për qytetarët të cilët duan të regjistrojnë bashkësi fetare, në përputhje me legjislacionin nacional.
11. Shkelja e të drejtës së informimit të lirë dhe mediave gjatë zgjedhjeve ndikon mbi të drejtën votuese të qytetarëve, për shkak të korrupsionit dhe ndikimit mbi mediat nga pushteti ekzekutiv, me çka shkaktohet manipulim, informim i njëanshëm i qytetarëve dhe garë e pandershme zgjedhore midis partive politike.
12. Diskriminimin, dhunën mbi gratë dhe Bashkësinë LGBTI i karakterizojnë mungesa e qasjes deri te të drejtat dhe drejtësia e grupeve vulnerable dhe të marginalizuara në Republikën e Maqedonisë.

13. Liria e lëvizjes dhe qasjes deri te shërbimet dhe të mirat publike për qytetarët me aftësi të kufizuar është pamundësuar për shkak të mosrespektimit të standardeve nga ana e autoriteteve publike gjatë intervenimit në hapësirën publike.


## Rekomandime

1. Të implementohet urgjentisht Direktiva 2012/29/BE për vendosjen e minimum standardeve për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave nga krimi, kurse mekanizmat mbikëqyrëse, siç janë Komisioni për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit në Kuvend, Sektori për Kontroll të Brendshëm në MPB dhe sidomos Avokati i Popullit, të kenë rol proaktiv në mbrojtjen nga tortura dhe të veprojnë sipas zërit të arritur dhe me iniciativë personale.
2. Të sigurohet mbikëqyrje efikase nga Kuvendi mbi punën e DSK-së dhe të përforcohen kapacitetet e Komisionit të Kuvendit për Kryerje të Mbikëqyrjes mbi DSK-në.
3. Të respektohet Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe dispozitat ndëshkuese të Kodit Penal për praktikumin e së drejtës së shprehjes së lirë nga nëpunësit policorë dhe bartësit e funksioneve të larta publike, si dhe sanksionim të tyre gjatë pengimit të tubimit publik apo kufizimit të lirisë së shprehjes, shoqërimit dhe aktiviteteve të tjera në formë të protestës paqësore.
4. Prokuroria Publike të veprojë sipas detyrës zyrtare në rastet e gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja, në përputhje me Kodin Penal.
5. Prokuroria Publike të zbatojë hetim themelor për lidhjen e mediave me pushtetin ekzekutiv.
6. Të përfshihet publiku ekspert gjatë ndryshimeve të ligjeve ekzistuese, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe palët e prekura ose shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve.
7. Të propozohet rritja e numrit të ekspertëve të pavarur dhe përfaqësuesve të organizatave qytetare në këshillin mbikëqyrës në Shërbimin Publik të Radiodifuzionit (RTM) dhe të kryhet hetim i tërësishëm për mosplotësim dhe punë në kundërshtim të Kushtetutës dhe ligjeve, që i përfshijnë liritë e mediave, sidomos për mosrespektimin

e standardeve ndërkombëtare dhe normave nacionale ligjore të objektivitetit dhe shumëllojshmërisë së shpërndarjes së informacioneve me karakter publik.

8. Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike ta zbatojë me përpikëri rolin e vet të trupit rregullator të pavarur, ndërsa sidomos të sigurojë objektivitet të mekanizmit të pavarur gjatë zgjedhjeve, si edhe të zbatojë rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Misionit OSBE/ODIHR në raport me qasjen e barabartë ndaj politikës së ndëshkimit të mediave.
9. Të respektohet praktika e transmetimit të tërësishëm audio dhe video të debateve publike, me qëllim që të sigurohet transparencë dhe publicitet në punën e Gjykatës Kushtetuese, sidomos për çështje me interes publik.
10. Të përforcohen mekanizmat e kontrollit të jashtëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjatë kufizimit të së drejtës së protestës paqësore apo gjatë tubimit publik, nëse pengohet nga nëpunësit policorë. Njëkohësisht të ngriten procedura për përgjegjësi penale për përdorimin e forcës së tepërt dhe joproporcionale nga nëpunësit policorë gjatë protestës dhe departizim të tërësishëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
11. Regjistrimi i bashkësive fetare dhe respektimi i lirisë së bindjes dhe lirive fetare, të mundësohet në përputhje me praktikën pozitive gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
12. Bashkësitë vulnerable dhe të marginalizuara:
  - Ndryshime të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe përfshirjen e orientimit seksual si bazë për diskriminim.
  - Përmirësimi i qasjes deri te drejtësia për bashkësinë etnike rome, mekanizmat e pavarur dhe përfundimisht identifikimi i diskriminimit racor dhe etnik, si edhe kufizimi i të drejtës së lëvizjes së lirë në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe të drejtën ndërkombëtare.
  - Përmirësim të kornizës së përgjithshme ligjore, në përputhje me standardet ndërkombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna familjare, sidomos nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së sektorit civil në përpilimin e kornizës përkatëse ligjore.

- Zmadhimi i aktivitetit të Prokurorisë Publike dhe veprimi në lidhje me rastet e dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja ndaj bashkësisë LGBTI.
  - Ngritja e procedurave dhe hetimeve, me qëllim që të inicimit të përgjegjësisë penale për të gjitha palët e përfshira, në gjashtë sulmet e regjistruara mbi objektet dhe individët si viktime të krimit nga urrejtja, nga ana e gjykatave kompetente dhe nga Prokuroria Publike.
13. Pushteti ekzekutiv dhe organet e pushtetit lokal të mundësojnë pjesëmarrje thelbësore të qytetarëve gjatë marrjes së vendimeve për intervenime në hapësirën publike.





## TË DREJTAT PROCEDURALE

### Qëllimi dhe metodologjia

Si rezultat i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim, të nënshkruar midis Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian në vitin 2001,<sup>79</sup> Qeveria e RM-së miratoi Program Nacional për Miratimin e të së Drejtës së BE-së.<sup>80</sup> Para se të bëhet anëtare me të drejta të plota në BE, gjatë negociatave për aderim, nga Republika e Maqedonisë do të kërkohet ta harmonizojë tërësisht të drejtën vendase me të drejtën e BE-së. Qëllimi themelor i kësaj analize është ta paraqesë teoritikisht dhe praktikisht zhvillimin e të drejtës penale, me një pasqyrim të veçantë për pjesën e të drejtave procesuale në procedurën penale, si në BE ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi specifik lidhet me kontrollin e harmonizimit të kornizës dhe praktikës juridike maqedonase me legjislacionin e BE-së. Fokusi i analizës është mbi të drejtat për përkthyes dhe interpretues, informimin dhe qasjen deri te avokati gjatë procedurës penale, si dhe të drejtën për informim të personit tjetër dhe përfaqësisë së konsullatës për privim nga liria. Zgjedhja e këtyre të drejtave konkrete bazohet në direktivat tashmë të miratuara në BE në fushën e të drejtës penale.

Për arritjen e qëllimit të përmendur, janë përdorur metodat e hulumtimit juridik, krahasimi dhe gjykimi juridik, si dhe metoda empirike. Metoda e hulumtimit juridik lidhet me instrumentet themelore ndërkombëtare në fushën e të drejtës penale që dalin nga Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe sidomos Bashkimi Evropian, si dhe hulumtimi në fushën e legjislacionit përkatës vendas. Metoda e krahasimit është përdorur me qëllim që të përcaktohet lidhja, ngjashmëritë dhe dallimet midis standardeve ndërkombëtare, përkundrejt legjislacionit vendas dhe domosdoshmërisë së aproksimacionit së tij. Metoda empirike lidhet me përcaktimin e nivelit të zbatimit të dispozitave normative që tashmë ekzistojnë në Republikën e Maqedonisë në praktikë. Për këtë qëllim janë përdorur tri analiza të partnerëve në suazat e Projektit “Rrjeti 23”, praktika e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe hulumtimet e tjera në dispozicion.

79 [http://www.sep.gov.mk/data/file/SSA/SSA\(1\).pdf](http://www.sep.gov.mk/data/file/SSA/SSA(1).pdf)

80 E fundit, revizioni i tetë i programit gjendet në: <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/00npaa2014narativenobjavuvanje.pdf>

## Rezyme e kornizës juridike të BE-së

Kompetenca e Bashkimit Evropian (BE), në sferën e të drejtës penale, filloi me nënshkrimin e *Marrëveshjes së Mastrohittit* të vitit 1992.<sup>81</sup> Me këtë Marrëveshje është shënuar krijimi i “Shtyllës së Tretë” të Bashkimit. BE-ja u zotua për “respektim të të drejtave themelore, ashtu siç janë garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (KEDNJ) dhe të cilat do t’i “përbëjnë parimet e përgjithshme” të së drejtës së BE-së. Sipas *Marrëveshjes së Mastrohittit*, si një nga qëllimet e BE-së është parashikuar zhvillimi i bashkëpunimit të afërm, në fushën e të “drejtës dhe punëve të brendshme”, midis të tjerash edhe nëpërmjet “bashkëpunimit gjyqësor në materien penale”. Në vitin 1997 është nënshkruar *Marrëveshja e Amsterdimit*.<sup>82</sup> Nëpërmjet saj, BE-ja vendosi një qëllim edhe më ambicioz – vendosjen e “rajonit të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë”. Shtylla e tretë e quajtur “Drejtësia dhe punët e brendshme” është riemërtuar si “Bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në materien penale”. Marrëveshja ka sjellë një instrument të ri juridik të quajtur “Vendimi kornizë”. Këto vendime iu dedikuan shteteve-anëtare të cilat duhet ta ndryshonin legjislacionin e vet nacional me qëllim të arritjes së qëllimeve të përbashkëta. Mbledhja tematike e BE-së, e mbajtur në Tampere në vitin 1999,<sup>83</sup> rezultoi me vendosjen e parimit “njohja e ndërsjellë e vendimeve gjyqësore”. Ky parim është paramenduar si “Gur-themeli i bashkëpunimit në jurisprudencë”.

*Karta e të Drejtave Fundamentale të BE-së (KDFBE)* është miratuar në vitin 2000.<sup>84</sup> KDFBE u dedikohet si institucioneve të BE-së, ashtu edhe shteteve anëtare në rastet kur e zbatojnë të drejtën e BE-së. Nenet 47-50 i garantojnë të drejtat procesuale për mjet efikas juridik, gjykim të drejtë dhe prezumim i pafajësisë, kurse në nenin 52 thuhet “Në atë masë në të cilën kjo kartë i mban të drejtat që përputhen me të drejtat që përmbahen në KEDNJ, rëndësia dhe spektri i këtyre

81 Treaty on European Union, Official Journal of the European Union, C 191, 29 July 1992.

82 Treaty of Amsterdam Amending the Treaty on European Union, the Treaties Establishing the European Communities and Related Acts, Official Journal of the European Union, C 340, 10 November 1997.

83 Council of the European Union. Tampere European Council, 15-16 October 1999, Presidency Conclusions (not published in the Official Journal of the European Union).

84 Official Journal of the European Union, C 364, 18 August 2000.

të drejtave do të jetë i njëjtë si dhe ato të përcaktuara në KEDNJ". Megjithatë, BE-ja do të ketë kompetencë të sigurojë "mbrojtje gjithëpërfshirëse". Deri në vitin 2009, KDFBE-ja nuk kishte fuqi obliguese juridike, por nëpërmjet nenit 6 (1) të *Marrëveshjes së Lisbonës* i është dhënë "rëndësi e njëjtë juridike" si ajo e marrëveshjeve themelore të BE-së. Në vitin 2004, nga Komisioni Evropian, është miratuar *Propozim i Vendimit Kornizë për të Drejta të Caktuara proceduese në Procedurën Penale*.<sup>85</sup> Propozimi përbëhej nga garantimi i pesë të drejtave themelore (qasje te ndihma juridike, interpretim dhe përkthim pa pagesë, sigurim i ndihmës për personat që nuk kanë mundësi ta ndjekin procedurën, e drejta e komunikimit dhe informimit të dyshuarve dhe akuzuarve për të drejtat e tyre nëpërmjet sigurimit të Letrës për të Drejtat.<sup>86</sup> Propozimi nuk është miratuar për shkak të mos pajtimit të gjashtë shteteve anëtare, sipas të cilave ai ka qenë shumë "ambicioz" dhe se "vetëm mund t'i zëvendësonte të drejtat e garantuara me KEDNJ"). Prandaj, është dakorduar qasja "hap pas hapi", me miratim shkallë-shkallë të instrumenteve juridike të veçanta, mëvetësisht për secilën të drejtë procesuale.

*Marrëveshja e Lisbonës* ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2009.<sup>87</sup> Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, BE-ja fitoi kompetencë të qartë në fushën e të drejtës procesuale penale në lidhje me personat e dyshuar apo të akuzuar që kanë kryer vepër penale. Harmonizimi i mënyrës se si do të zhvillohen procedurat penale në BE u bë e mundshme. Aktet juridike në këtë fushë miratohen në formën e "Direktivave" të obligueshme, në vend të "Vendimeve kornizë". Për herë të parë në historinë e vet, BE-ja ka kompetencë të miratojë minimum rregulla në formën e direktivave që mund të lidhen me "të drejtat e personave në procedurën penale", si edhe "pranimi i përbashkët i dëshmimeve". Në vitin 2010 është miratuar "Programi i Stokholmit",<sup>88</sup> i cili lidhet me përforsimin e të drejtave procesuale të të dyshuarve dhe personave të akuzuar në procedurat penale. *Programi i Stokholmit* bën thirrje për krijimin e strategjisë, e cila do të bazohet në "solidaritet dhe oportunitet" dhe e cila do "t'i drejtojë politikat e BE-së në harmonizimin e të drejtës

procesuale dhe materiale penale". Në Periudhën nga viti 2010 deri në 2013 janë miratuar tri direktiva: Direktiva 2010/64/BE për të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale,<sup>89</sup> Direktiva 2012/13/BE për të drejtën e informimit në procedurën penale<sup>90</sup> dhe Direktiva 2013/48/BE për të drejtën qasje deri te avokati.<sup>91</sup> Përveç këtyre direktivave, në procedurën e miratimit janë edhe tri direktiva të tjera që lidhen me masat mbrojtëse procesuale për fëmijët e dyshuar dhe të akuzuar në procedurën penale, ndihmë juridike paraprake për të dyshuarit dhe akuzuarit, që janë privuar nga liria dhe prezumimi i pafajësisë dhe e drejta të jetë i pranishëm gjatë procedurës penale.<sup>92</sup>

Për qëllimet e kësaj analize janë përpunuar vetëm direktivat e miratuara. Duke pasur parasysh se dispozitat e direktivave të analizuarra, që lidhen me Urdhër arrestin Evropian janë në korrelacion të drejtpërdrejtë me Vendimin kornizë 2002/584/PVR të vitit 2002<sup>93</sup> dhe për to është e domosdoshme analizë e përgjithshme lidhur me Urdhër arrestin evropian, ato nuk janë shqyrtuar në këtë analizë.

85 COM(2004) 328 final, Brussels, 28 April 2004.

86 COM(2004) 328 final, Brussels, 28 April 2004.

87 Consolidated versions of the Treaty on European Union and the Treaty on the Functioning of the European Union, Official Journal of the European Union C 115, 9 May 2008.

88 Official Journal of the European Union C 115, 4 May 2010.

89 Directive 2010/64/EU of the European Parliament and of the Council of 20 October 2010 on the right to interpretation and translation in criminal proceedings (OJ L 280, 26.10.2010, p.1).

90 Directive 2012/13/EU of the European Parliament and of the Council of 22 May 2012 on the right to information in criminal proceedings (OJ L 142, 1.6.2012, p.1).

91 Directive 2013/48/EU of the European Parliament and the Council of 22 October 2013 on the right of access to a lawyer in criminal proceedings and European arrest warrant proceedings and on the right to have a third party informed upon deprivation of liberty, and to communicate with third persons and with consular authorities (OJ L 294, 6.11.2013, p. 1).

92 [http://europa.eu/rapid/press-release\\_MEMO-13-1046\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-13-1046_en.htm)

93 2002/584/JHA: Council Framework Decision of 13 June 2002 on the European arrest warrant and the surrender procedures between Member States, Official Journal L 190 , 18/07/2002 p.1.

## E drejta e lirisë dhe sigurisë

Gjatë viteve të kaluara vazhdimisht jepen vërejtje në lidhje me përcaktimin dhe vazhdimin e masës paraburgim nga gjykatësi, zgjatja kohore e masës, mospërdorimi i masave më të lehta alternative, mbingarkesa, kushtet e jetës dhe mbrojtja shëndetësore jopërkatese. Edhe pse legjislacioni vendas dhe standardet ndërkombëtare theksojnë që masa paraburgim të përdoret vetëm si përjashtim, dhe jo si rregull, kohëzgjatja të jetë e vendosur në kohën më të shkurtër dhe së pari të shqyrtohet mundësia për shfrytëzim të masave parandaluese më të lehta, ekziston ndjenjë se paraburgimi ndonjëherë përdoret si masë ndëshkuese, kurse në raste të caktuara edhe si metodë frikësimi.

Paraburgimi zgjat shumë (42% e të burgosurve kalojnë më tepër se pesë muaj në qendrat e paraburgimit) dhe masat alternative nuk shfrytëzohen sa duhet. Mbikëqyrja gjyqësore nuk jep asnjë rezultat. Sipas Ligjit për procedurë penale, të gjithë individët e privuar nga liria kanë: qasje të shpejtë tek avokati i pavarur me përzgjedhje të vet; të marrin, me kërkesë të tyre, kontroll të pavarur mjekësor; dhe të mund të kontaktojnë me anëtar të familjes. Këto dispozita për procedurën penale ndonjëherë nuk respektohen nga pushteti. Kjo prirje është sidomos reale kur bëhet fjalë për qasje të shpejtë të kontrollit mjekësor i pavarur, që pothuajse asnjëherë nuk respektohet.

Paraburgimi ndonjëherë përdoret si ndëshkim, ose ka për qëllim t'i frikësojë të dyshuarit/akuzuarit dhe për këtë flasin rastet kur paraburgimi përcaktohet edhe për vepra më të lehta penale, sidomos rasti i fundit i personave të gjykuar-pjesëmarrësve në protestën më 5.5.2015, që u mbajt para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në këto incidente ishin arrestuar më tepër se dyzet e dy persona, prej të cilëve pjesa më e madhe ishin mbajtur 24 orë në disa stacione policore në Shkup. Pjesa më e madhe e të arrestuarve nuk ishin pjesë e grupit që u ndesh me policinë, kurse një pjesë e tyre fare nuk kanë marrë pjesë në këtë protestë. 15 personave u është përcaktuar masa paraburgim, një person është mbajtur në arrest shtëpie, kurse dy persona ishin në ikje. Nga personat e arrestuar, pesë ishin studentë, kurse dy ishin përfaqësues të Plenumit të Studentëve.

Personat ishin të dyshuar për pjesëmarrje në turmë që do të ndalojë personin zyrtar në kryerjen e veprimtarisë zyrtare (neni

384 paragrafi 1 i Kodit Penal). Dënimi për këtë veprë penale është nga tre muaj deri në tre vjet, prandaj konsiderohet për veprë penale më e lehtë, për të cilën, në parim, nuk duhet të përcaktohet masa e paraburgimit, por duhet të shfrytëzohen masat e tjera alternative që janë në dispozicion për sigurimin e prezencës.

Konsiderojmë se vendimet e tilla ndikojnë mbi kufizimin e të drejtës së protestës, sidomos për shkak të faktit që si arsye për paraburgimin është thënë se të arrestuarit mund ta përsërisin veprën penale, duke pasur parasysh se ka paralajmërime për protesta të reja. Gjithashtu, vendimet për paraburgim dhe për ngritjen e procedurave penale kundër studentëve, mund të konsiderohen edhe si paralajmërime për qytetarët e tjerë të cilët duan të marrin pjesë në protestat që mbahen në këtë periudhë. Për krahasim, kundër pjesëmarrësve në protestat e dhunshme kundër Komunës Qendër, që u mbajtën në vitin 2014, nuk është ngritur asnjë procedurë gjyqësore, prandaj konsiderojmë se ekziston drejtësi seleksionuese.

Në periudhën nga 22 maj deri më 6 qershor janë mbajtur seancat kryesore për tre grupet e demonstruesve, të cilët ishin ndjekur penalisht dhe, përveç dy të akuzuarve, të gjithë të tjerët e pranuar fajin, prandaj pjesës më të madhe i ishte përcaktuar dënimi me kusht burg prej tri muajsh, që nuk do të zbatohet nëse në afat prej një viti nuk e përsërisin veprën. Njërit nga të akuzuarve, i cili e pranoi fajin, i ishte përcaktuar dënimi burgim me dhjetë muaj, për shkak të dënimit të mëparshëm për të njëjtat vepra penale. Vetëm dy nga demonstruesit nuk e pranuan fajin dhe gjykata njërit prej personave i përcaktoi dënim me burg dy vjet e katër muaj, për shkak të dënimit të mëparshëm, kurse personit të dytë i është përcaktuar dënim me burgim të kushtëzuar prej shtatë muajsh, që nuk do të realizohet nëse në afat prej dy vjetësh nuk kryen veprë të re penale.

## Qasja e barabartë në drejtësi

Duke e pasur parasysh nevojën për një qasje më të madhe të institucioneve për qytetarët e Republikës së Maqedonisë, me status më të ulët material dhe shoqëror dhe duke u nisur pikërisht nga parimi i qasjes së barabartë në drejtësi, më 28 dhjetor 2009 është miratuar Ligji për ndihmën juridike falas, i cili filloi të zbatohet më 7.7.2010.

Në përputhje me këtë ligj, të drejtë të ndihmës juridike falas kanë shtetasit e Republikës së Maqedonisë, me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, të cilët janë persona që shfrytëzojnë ndihmën sociale, shfrytëzues të së drejtës të shtesës invalide, të cilët nuk realizojnë të ardhura të tjera, në bazë të fitimit apo të hyra në pasuri të patundshme, përdorues të pensionit më të vogël, të cilët jetojnë në bashkësi familjare me dy ose më shumë persona, të cilët i mban ai me të holla dhe familje apo prind i vetëm me një apo më shumë fëmijë të mitur, të cilët e kanë të drejtën e shtesës fëmijërore.

Të drejtë të ndihmës juridike falas ka edhe fëmija në rrezik dhe fëmija për të cilin ekzistojnë baza të dyshimit se ka kryer veprim i cili me ligj është paraparë si vepër penale kundërvajtje në procedurën e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të fëmijës para Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Qendrës për Punë Sociale, në raste dhe kushte të përcaktuara me Ligjin për të Drejtat e Fëmijëve. Përveç tyre, të drejtë të ndihmës juridike falas kanë edhe kërkuesit e të drejtës së azilit, personit të cilit i është njohur e drejta e azilit, personat e zhvendosur brenda shtetit, si dhe person i shpërngulur apo i ndjekur i cili në territorin e Republikës së Maqedonisë ka vendqëndrim, shtetasit e huaj, personi pa shtetësi, i cili ka qëndrim ligjor në Republikën e Maqedonisë dhe shtetasi i vendit anëtar në Bashkimin Evropian.

Ligji i përcakton këto forma të ndihmës juridike falas: ndihmë juridike paraprake dhe ndihmë juridike në procedurat administrative dhe gjyqësore. Ndhimë juridike paraprake ofrojnë seksionet rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe shoqatat e autorizuara, kurse avokatët ofrojnë ndihmë juridike në procedurat administrative dhe gjyqësore.

Kërkesa për ndihmë juridike falas miratohet në të gjitha procedurat gjyqësore dhe administrative, nëse me këtë zgjidhet një çështje me interes për kërkuesin e ndihmës juridike dhe jko për të drejtat nga fusha e sigurimit social, shëndetësor, pensional

apo invalidor, marrëdhëniet e punës, mbrojtjes së fëmijëve, viktimave të dhunës familjare, mbrojtjes së viktimave prej veprave ndëshkuese, mbrojtjes së viktimave nga tregtia me njerëz, njohjes së të drejtës së azilit dhe çështjeve pronësore-juridike. Ajo nuk mund të miratohet nëse kërkuesi, apo një anëtar i familjes së tij, me të cilin jeton në të njëjtën amvisëri ka pasuri e cila arrin apo tejkalon pesë rroga mesatare bruto të paguara në Republikën e Maqedonisë në muajin paraprak.

Kërkesa për ndihmë juridike falas paraqitet personalisht ose nëpërmjet postës në 34 seksione rajonale të ministrisë në formular të përcaktuar të cilit i bashkëngjitet deklaratatë për gjendjen materiale-sociale të parashtruesit të kërkesës dhe të anëtarëve të familjes me të cilët jeton në amvisëri të përbashkët, si dhe pajtim për kontroll në të gjitha të dhënat për gjendjen e tyre pronësore. Sipas kërkesës së paraqitur vendos Ministria e Drejtësisë.

Ndihma juridike falas financohet nga Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Mjetet financiare janë dedikuar për pagesën e shpërblimit të për ndihmën e ofruar juridike, në pajtueshmëri me Tarifën e shpërblimeve dhe Kompensimit të shpenzimeve për punën e avokatëve e reduktuar për 30% dhe për kompensimin e shpenzimit të shoqatës së autorizuar të qytetarëve për ndihmën e ofruar juridike paraprake në përputhje me Tarifën për kompensim të shpenzimeve për punën e shoqatave të qytetarëve për kryerjen e punëve të ndihmës juridike paraprake.

Duke u nisur nga dispozitat restriktive të këtij ligji në lidhje me mundësimin e ndihmës juridike falas, në vitet e zbatimit të tij janë bërë një numër i madh analizash, të cilat e vërtetojnë faktin se ligji nuk korrespondon me nevojat reale të qytetarëve për ndihmë juridike falas. Ligji nuk mundëson që të gjithë qytetarët të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Sidomos kontestues është neni i ligjit i cili thotë se ndihmë juridike falas nuk mund të miratohet nëse kërkuesi apo ndonjë anëtar i familjes së tij, me të cilin jeton në të njëjtën amvisëri ka pasuri e cila arrin apo i tejkalon pesë rroga mesatare bruto të paguara në Republikën e Maqedonisë në muajin paraprak, që do të thotë se ndihmë juridike falas nuk mund të realizojnë personat të cilët janë pronarë të vendbanimit përkatësisht pronës së patundshme e cila kushton mbi 2500 euro. Neni i konceptuar në këtë mënyrë e kufizon mundësinë e qytetarëve të cilët gjenden në rrezik social dhe të cilëve u është rrezikuar asistencë që ta realizojnë të drejtën e ndihmës juridike falas.

Analiza e fundit, në lidhje me këtë ligj, e përgatitur nga shoqata e qytetarëve për Qasje të Barabartë dëshmon se ekziston rritje e numrit të personave të cilët kërkojnë, por edhe marrin ndihmë juridike falas, por megjithatë numri i tillë nuk përputhet me numrin e personave të cilët gjenden në rrezik social. Në këtë analizë thuhet se buxheti i akorduar nga Ministria e Drejtësisë për LNJP për 2013 është 414.409,00 denarë për kompensim të avokatëve dhe për shoqatat e qytetarëve, ndërsa nëse ai ndahet me numrin e përgjithshëm të banorëve në RM do të fitohet një mesatare prej rreth 0,20 denarësh për banor. Kjo shumë është më e lartë nëse merret parasysh buxheti i përgjithshëm, i vlerësuar për implementimin e LNJP llogaritur në analizë në pjesën e shpenzimeve dhe është rreth 11,23 denarë për banor. Për vitin 2014, shumat janë rritur minimalisht me 0,37 denarë për banor ose 11,40 denarë nga buxheti i vlerësuar. Republika e Maqedonisë, sipas Entit Shtetëror të Statistikës, në vitin 2013, ka pasur gjithsej 34.612 amvisëri përfituese të ndihmës sociale në të holla, prej të cilave 8.233 janë gra bartëse të amvisërive, me numër të përgjithshëm të anëtarëve të amvisërive (me bartës) 131.185 prej të cilëve 59.708 janë gra. Nëse bëhet relacion midis përfituesve të ndihmës sociale në të holla dhe buxhetit të LNJP-së, për 2013, do të konstatohej se përfituesit e ndihmës sociale në të holla, mesatarisht do të marrin 11,00 denarë për amvisëri ose rreth 50,00 denarë për gratë bartëse të amvisërisë. Gjithsesi, këto shuma janë më të mëdha nëse merren parasysh shumat e përgjithshme të vlerësuara për zbatimin e LNJP-së të bëra në këtë analizë, për 669,73 denarësh për amvisëri, përkatësisht 2.815,59 denarësh për gra bartëse e amvisërisë. Benefiti është për të gjithë anëtarët e amvisërive.

Për vitin 2014 nuk kemi qasje të të dhënave për përfituesit e ndihmës sociale në të holla.

Megjithatë, numrat flasin se efektiviteti i mjeteve të shpenzuara është më i vogël nëse merret parasysh se vetëm 75 persona, në vitin 2013, përkatësisht 114, në vitin 2014, nga kërkuesit e ndihmës juridike falas e kanë fituar atë. Nëse krahasohet numri i qytetarëve të cilët e kanë realizuar këtë të drejtë me buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë prej 414,409,00 denarësh, në vitin 2013, mesatarisht çdo kërkues i ndihmës juridike do të merrte rreth 5.525, 00 denarë, përkatësisht 5.676,00 denarë për gratë kërkuese (73).

Në vitin 2014 rritet buxheti i përgjithshëm, por gjithashtu rritet edhe numri i kërkesave të miratuara, kështu që prej 770.701.00

denarësh të buxhetit të përgjithshëm, mesatarisht çdo kërkues duhet të marrë 6.760,53 denarë ose nëse merret numri i grave që e kanë realizuar këtë të drejtë (97) mesatarisht do të fitonin nga 7.945, 00 denarë.

Për qëllimet e kësaj analize janë intervistuar qytetarë, në lidhje me informimin e tyre mbi ligjin, që ndikon në mënyrë të veçantë mbi realizimin e të drejtës së ndihmës juridike falas. Konkluzioni i nxjerrë nga intervistat e realizuara është se qytetarët nuk janë të informuar sa duhet për këtë ligj, kushtet dhe mënyrën e realizimit të kësaj të drejte. Qytetarët, të cilët e kanë realizuar këtë të drejtë, janë të pakënaqur nga avokatët që u janë caktuar, sepse nuk u është përkushtuar vëmendje e mjaftueshme lëndëve të tyre, me supozimin se për shkak të shumës së reduktuar prej 30% të cilën avokatët e marrin për këto raste.

Sidomos është e rëndësishme që ky ligj, si fushë për miratim të ndihmës juridike falas nuk e ka parashikuar diskriminimin, prandaj shfaqen probleme për ngritjen procedurave gjyqësore për përcaktimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, sidomos tek grupet dhe bashkësitë e marginalizuara, duke përfshirë edhe popullatën rome.

## E drejta e qasjes deri te avokati në procedurën penale

Nenet 14 (3) (g) PNDKP, 6 (3) KEDNJ dhe 47 KDFBE përcaktojnë se secili ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit sipas përzgjedhjes së vet, ndërsa nëse nuk ka mjete që të paguajë mbrojtës, të marrë avokat zyrtar pa pagesë, kur këtë e obligojnë interesat e drejtësisë. Në një aktvendim të KEDNJ-së, e cila është kthesë në këtë fushë, është theksuar se e drejta e gjykimit të drejtë obligon, si rregull, qasja deri te avokati të sigurohet që në marrjen në pyetje të të dyshuarit nga policia.<sup>94</sup> Sigurimi i avokatit, përveç tjerash shërben edhe si masë mbrojtëse, nëpërmjet të cilës ndalohet pranimi me forcë i fajit nëpërmjet torturës apo keqtrajtimeve të tjera. Në pikëpamjet e veta përfundimtare për Gjeorgjinë, Komiteti për të Drejtat e Njeriut i OKB-së përcaktoi se çdo i dyshuar “duhet të ketë qasje urgjente deri te avokati”.<sup>95</sup> Sipas OKB-së ndihma e

94 Salduz v Turkey (36391/02), 27 November 2008, para. 55.

95 UN Human Rights Committee (HRC), UN Human Rights Committee: Concluding Observations, Georgia, 5 May 1997, CCPR/C/79/Add.75, 5 May 1997, CCPR/C/79/Add.75, para. 27.

avokatit duhet të sigurohet "pa kurrfarë restriksionesh, ndikimesh, presionesh apo përzjerjes jokompetente nga cilado palë".<sup>96</sup> Nëse i dyshuari, apo i akuzuari, deklaron se preferon të përfaqësohet nga avokati, autoritetet doemos duhet ta ndërpresin hetimin deri në momentin kur të sigurohet avokati. Neni 8 i KEDNJ-së (e drejta e privatësisë) e garanton privilegjin e besueshmërisë midis të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Sipas praktikës së GjEDNJ-së midis të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ekziston karakter i raportit privat dhe të besueshëm.<sup>97</sup>

## Direktiva 2013/48/BE për të drejtën e qasjes deri te avokati

Direktiva 2013/48/BE për të drejtën e qasjes deri te avokati, e cila do të hyjë në fuqi më 27 nëntor 2016,<sup>98</sup> është Direktiva e tretë e miratuar në fushën e të drejtës procesuale penale, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Lisbonës. Përveç asaj që garanton të drejtën e qasjes deri te avokati, Direktiva ka të bëjë edhe me të drejtën e lajmërimit të personit tjetër për privim nga liria dhe komunikimi me atë person, si e drejtë e lajmërimit dhe komunikimit me përfaqësitë diplomatike konsullore gjatë kohës së privimit nga liria (neni 1). Në parathënien e Direktivës thuhet se ajo lidhet me mbindërtimin e neneve 3 (ndalim të torturës), 5 (të drejtës së lirisë dhe sigurisë), 6 (të drejtës së procedurës të drejtë gjyqësore) dhe 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së. Direktiva 2013/48/BE i referohet edhe Direktivës 2012/13/BE për të drejtën e informimit në procedurë penale e cila, siç është përshkruar më parë, u mundëson të dyshuarve dhe të akuzuarve të informohen në kohë për të drejtën e qasjes deri te avokati, si dhe personave të arrestuar apo të paraburgosur t'u sigurohet Letër e të Drejtave e cila përmban informacion për të drejtën e qasjes deri te avokati. Direktiva, u referohet gjithashtu edhe Udhëzimeve të Këshillit të Evropës për drejtësi sipas masës së fëmijëve të vitit 2010,<sup>99</sup> duke i promovuar të drejtat e fëmijëve.

96 General Comment No. 13, Article 14 (Administration of Justice), Equality before the Courts and the Right to a Fair and Public Hearing by an Independent Court Established by Law, 13 April 1984, para. 9.

97 *Campbell v the United Kingdom* (13590/88), 25 March 1992, para. 48.

98 <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1433872282373&uri=CELEX:32013L0048>

99 [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/childjustice/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/childjustice/default_en.asp)

Direktiva ka të bëjë me personat e akuzuar dhe të dyshuar në procedurën penale, zbatohet në momentin kur personi nga autoritetet është informuar, sipas detyrës zyrtare apo në ndonjë mënyrë tjetër, se është i dyshuar ose se akuzohet për kryerjen e veprës penale, pa marrë parasysh se a është privuar nga liria ai person. Direktiva zbatohet deri në përfundim të procedurës. Me përfundimin e procedurës nënkuptohet vendimi përfundimtar lidhur me çështjen se a e ka kryer veprën, atje ku kjo është e zbatueshme, shqiptim i dënimit dhe zgjidhje sipas ankesës. Direktiva zbatohet nën kushte të njëjtat edhe ndaj personave të cilët nuk janë të dyshuar apo të akuzuar, por të cilët gjatë hetimit nga ana e policisë do të marrin statusin e personave të dyshuar apo të akuzuar (neni 2 (1) (3)).

### a) E drejta e qasjes deri te avokati

Autoritetet duhet të sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar të kenë të drejtën e qasjes tek avokati në momentin dhe në mënyrë që do t'u mundësojë personave të praktikojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, në mënyrë praktike dhe efektive. E drejta duhet të sigurohet pa shtyrje të panevojshme. Personat e dyshuar dhe të akuzuar duhet të kenë qasje tek avokati në një prej këtyre rasteve, që në atë kohë do të jetë më i hershëm:

- para marrjes në pyetje nga policia ose organi gjyqësor;
- pas përfundimit të hetimit ose procedurës së grumbullimit të provave nga organet hetimore;
- pa shtyrje të panevojshme pas privimit nga liria; dhe
- kur ata thirren që të paraqiten në gjykatën që ka kompetencë penale, në një afat të arsyeshëm para se ato të paraqiten në gjykatë.

Për realizimin e suksesshëm të së drejtës së qasjes tek avokati, autoritetet për personat e dyshuar dhe të akuzuar duhet të sigurojnë:

- të drejtën të takohen personalisht dhe të komunikojnë me avokatin i cili i përfaqëson, duke e përfshirë edhe marrjen në pyetje paraprake të policisë ose organit tjetër gjyqësor;
- të drejtën që avokati i tyre të jetë i pranishëm dhe të

marrë pjesë në mënyrë efektive gjatë marrjes në pyetje. Pjesëmarrja të ketë karakter i cili nuk do të jetë në dëm të shfrytëzimit efektiv të kësaj të drejte. Në rastet në të cilat avokati merr pjesë në marrjen në pyetje, pjesëmarrja e tillë duhet të evidentohet; dhe

- të drejtën që avokati i tyre të marrë pjesë gjatë procedurës hetimore ose procedurës tjetër të grumbullimit të provave, në rast kur u lejohet të jenë të pranishëm gjatë këtyre procedurave, e veçanërisht gjatë:
- identifikimit të personave ose sendeve;
- ballafaqimeve; dhe
- rikonstruksionit të ngjarjeve.

Përrjashtime nga këto rregulla janë të mundshme vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe gjatë procedurës hetimore paraprake, përkatësisht procedurës hetimore vetëm nëse këto përrjashtime janë të arsyeshme në aspekt të rrethanave konkrete të rastit, bazuar në një nga këto arsye relevante:

- atje ku ekziston nevojë e domosdoshme për parandalimin e kërcënimit serioz të jetës, lirisë ose integritetit fizik të ndonjë personi; dhe
- atje ku ndërrmarrja e masave urgjente nga organet hetimore është me rëndësi vendimtare për parandalimin e rrezikut të konsiderueshëm të procedurës penale.

Direktiva e garanton edhe besueshmërinë e komunikimit midis personave të dyshuar dhe të akuzuar dhe avokatit të tyre. Komunikimi minimum duhet të përfshijë takime, korrespondencë dhe biseda telefonike. E drejta e qasjes deri te avokati përfshihet në nenin 1-4 të Direktivës.

## **b) E drejta e informimit të personit tjetër për privim nga liria dhe e komunikimit**

Autoritetet duhet të sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar të cilët janë të privuar nga liria, nëse dëshirojnë, të kenë të drejtë pa shtyrje të panevojshme, të zgjedhin më së paku një person që ta njoftojnë për privimin e tyre nga liria. Në rastet kur personi i dyshuar ose i akuzuar është fëmijë, autoritetet duhet të mundësojnë që bartësi i përgjegjësisë prindërore të njoftohet menjëherë pas privimit nga liria, si dhe

për arsyet e privimit. Përrjashtim nga ky rregull është i mundur vetëm kur njoftimi do të jetë në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës dhe në këtë rast duhet të njoftohet një person tjetër përkatës i rritur. Me nocionin "fëmijë" Direktiva nënkupton një person i cili nuk ka mbushur 18 vjet. Përveç rregullave të veçanta lidhur me fëmijët, autoritetet duhet t'i marrin parasysh nevojat e veçanta të personave vulnerabil të dyshuar dhe të akuzuar gjatë realizimit të të drejtave të garantuara me Direktivë. (neni 13).

Autoritetet mund të heqin përrkohësisht dorë nga zbatimi i të drejtës së informimit, në aspekt të rrethanave konkrete të rastit, bazuar në një nga këto arsye relevante:

- atje ku ekziston nevojë e domosdoshme për parandalimin e kërcënimit serioz të jetës, lirisë ose integritetit fizik të ndonjë personi; dhe
- atje ku ndërrmarrja e masave urgjente nga organet hetimore është me rëndësi vendimtare për parandalimin e rrezikut të konsiderueshëm të procedurës penale.

Nëse autoritetet vendosin të heqin dorë nga zbatimi i së drejtës së informimit për privimin nga liria të një fëmije, janë të obliguar të sigurojnë se për privimin, pa shtyrje të panevojshme, do të njoftohet organi përkatës kompetent për mbrojtjen e mirëqenies së fëmijëve. Përveç kësaj, autoritetet duhet pa shtyrje të panevojshme, personave të dyshuar dhe të akuzuar t'ua mundësojnë të drejtën e komunikimit me person tjetër, siç është për shembull, një familjar sipas zgjedhjes së tyre. E drejta për të njoftuar personin tjetër për privimin nga liria është edhe komunikimi me këtë person, e përrshirë në nenin 5 dhe 6 të Direktivës.

## **c) E drejta e komunikimit me përfaqësinë konsullore**

Autoritetet për personat e dyshuar dhe të akuzuar, të cilët nuk janë shtetas dhe janë privuar nga liria, duhet ta mundësojnë të drejtën e informimit të përfaqësisë konsullore dhe komunikimin e pashtyrë me përfaqësinë, nëse këto persona janë dakord me këtë. Në rastet kur personat e dyshuar dhe të akuzuar posedojnë dy ose më tepër shtetësi, ato mund të zgjedhin cilën përfaqësi konsullore do ta njoftojnë, përkatësisht me cilën përfaqësi do të komunikojnë. Përveç të drejtës së informimit dhe komunikimit, personat e dyshuar dhe të akuzuar kanë të

drejtë të vizitohen nga zyrtarët konsullorë, të bisedojnë dhe të korrespondojnë me ta dhe të drejtë që t'u mundësohet përfaqësim ligjor të siguruar nga përfaqësia konsullore.

### **ç) Shmangie e përkohshme dhe heqje dorë nga e drejta e informimit dhe e komunikimit**

Nëse autoritetet vendosin që përkohësisht të shmangin mundësimin e të drejtave të informimit dhe të komunikimit, këto shmangie duhet:

- të jenë proporcionale dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e domosdoshme;
- të jenë me kufizim kohor të rreptë;
- të mos bazohen vetëm në llojin dhe seriozitetin e veprës penale të supozuar; dhe
- të jenë pa pasoja të dëmshme për drejtësinë e përgjithshme të procedurës.

Shmangiet e përkohshme në lidhje me të drejtën e komunikimit midis të dyshuarve dhe të akuzuarve me persona tjerë mund të lejohet vetëm me vendim të argumentuar përkatës, të miratuar nga organi gjyqësor ose organ tjetër dhe që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Çdo vendim i tillë doemos duhet të evidentohet.

Në rast se personat e dyshuar dhe të akuzuar heqin dorë nga e drejta e informimit dhe e komunikimit, kjo heqje dorë do të lejohet vetëm kur autoritetet do të binden se:

- personit të dyshuar dhe të akuzuar, me gojë ose me shkrim, nëpërmjet njoftimit të qartë dhe të mjaftueshëm, i është sugjeruar për përmbajtjen e të drejtës përkatëse dhe për pasojat e mundshme nga mosshfrytëzimi i saj; dhe
- heqja dorë është bërë vullnetarisht dhe pa mëdyshje.

Heqja dorë, që mund të kërkohet me gojë ose me shkrim, duhet të evidentohet dhe të përmbajë një shpjegim për rrethanat në të cilat është kërkuar. Autoritetet duhet të mundësojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar të kenë mundësi ta tërheqin kërkesën, si dhe t'i informojnë këta persona për një mundësi të tillë. Shmangiet e përkohshme

dhe heqja dorë nga e drejta e njoftimit dhe e komunikimit përfshihen në nenin 8 dhe 9 të Direktivës.

## **E drejta e qasjes deri te avokati në procedurën penale të Republikës së Maqedonisë**

Neni 12 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë përcakton se personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria ka të drejtë për mbrojtës në procedurë policore dhe gjyqësore. E drejta e qasjes tek avokati (mbrojtës) në procedurën penale është e rregulluar në nenin 71 të LPP-së, ku thuhet se çdo person i dyshuar ose i akuzuar për veprë penale ka të drejtë për mbrojtës gjatë procedurës penale kundër tij. I akuzuari, para marrjes së parë në pyetje ose para ndonjë veprimi tjetër për të cilin obligimi i tillë është paraparë me këtë ligj, doemos duhet të këshillohet se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së vet, me të cilin mund të këshillohet vet dhe se mbrojtësi mund të jetë pjesëmarrës gjatë marrjes së tij në pyetje. Në përputhje me nenin 78 të LPP-së mbrojtësi është i autorizuar që, në dobi të të akuzuarit, t'i marrë të gjitha veprimet që mund t'i marrë i akuzuari.

E drejta e qasjes tek avokati përcaktohet edhe në Ligjin për policinë ku në nenin 34 thuhet se i akuzuari ka të drejtë në përfaqësim dhe këshillim nga mbrojtësi gjatë procedurës policore. Përveç kësaj, neni 43 i Ligjit për policinë përcakton se fletëthirrja me shkrim, me të cilën thirren qytetarët për të grumbulluar informata të nevojshme dhe të domosdoshme për kryerjen e punëve të policisë, mes tjerash, përmban edhe këshillë për të drejtën e mbrojtësit në procedurën policore, ndërsa në nenin 63-e thuhet se gjatë zbatimit të identifikimit përveç nëpunësve policorë, të cilët e kryejnë këtë metodë dhe personit të dyshuar ndaj të cilit kryhet identifikimi, mund të marrë pjesë edhe mbrojtësi i të dyshuarit. Sipas neni 206 të LPP-së, nëse i akuzuari nuk ka avokatin e vet ose nuk mund të kontaktojë me të, do t'i dorëzohet listë e avokatëve kujdestarë e përpiluar nga Dhoma e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë. Nëse i akuzuari fillimisht nuk ka dashur mbrojtës, por më vonë ka shprehur dëshirë që të marrë mbrojtës, marrja në pyetje do të ndërpritet dhe sërish do të vazhdohet kur i akuzuari do të marrë mbrojtës me të cilin mund të këshillohet. Sipas neni 90 të Ligjit për drejtësi për fëmijët,<sup>100</sup> mbrojtja e fëmijës në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore është e detyrueshme.

<sup>100</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013.



Sipas Komitetit për Parandalim të Torturës pranë Këshillit të Evropës, evidenca e personave të arrestuar në stacionet policore, që janë vizituar në vitin 2010, flet për faktin se një pjesë e madhe e personave të burgosur nuk kanë qasje deri te avokati. Komiteti, si shembull e jep stacionin policor të “Gazi Babës” (ku qasja deri te avokati u është mundësuar vetëm 44 prej 752 personave të paraburgosur, që është më pak se 6%). E ngjashme ka qenë edhe situata me stacionet policore “Bit Pazar” dhe “Qendër” në Shkup. Sipas nëpunësve policorë, me të cilët kanë biseduar anëtarët e Komitetit, qasja deri te avokati zakonisht është mundësuar vetëm kur personi i arrestuar ka pasur mundësi të paguajë për përfaqësim. Si përjashtim nga ky rregull ceket stacioni policor në Veles, i cili e ka ruajtur listën e avokatëve të cilët përfaqësojnë me detyrë zyrtare dhe të cilëve mund t’u paraqiten personat e arrestuar.<sup>101</sup>

Në kuadër të Projektit “Rrjeti 23”, organizata partnere Koalicioni “Të gjithë për një gjykim të drejtë” monitoroi implementimin e standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në Gjykatën Themelore Shkupi 1. Nga analiza del se në 42 procedura gjyqësore të vëzhguara, personi i akuzuar ka pasur mbrojtësin e vet, ndërsa në dy raste i është emëruar mbrojtës me detyrë zyrtare. Në katër raste ose në 7% i akuzuari i parë nuk ka pasur mbrojtës, por procedura është mbajtur për vepra penale për të cilat mbrojtja nuk është e detyrueshme.<sup>102</sup> Në lidhje me këshillën për ndihmë falas juridike nga mbrojtësi, në 15 raste personi i akuzuar është këshilluar për këtë të drejtë, ndërsa në dhjetë raste nuk është këshilluar. Sipas Koalicionit, numri i vogël i personave të këshilluar për këtë të drejtë çon në konkluzion se gjykatat nuk kontrollojnë çdoherë nëse personi i akuzuar është financiarisht i aftë t’i mbulojë shpenzimet e mbrojtjes. Vëzhguesit kanë shënuar se vetëm në 53% të procedurave mbrojtësit kanë qenë të përgatitur në mënyrë cilësore për rastin dhe nuk kanë lënë përshtypje se nuk i përfaqësojnë në mënyrë përkatëse klientët e vet.<sup>103</sup>

Në kuadër të Projektit “Rrjeti 23”, organizata partnere Qendra e Strategjive dhe e Zhvillimit “PAKTIS” – Prilep e realizoi Projektin “Sistemi i masave alarmuese me vështrim

101 <http://www.cpt.coe.int/documents/mkd/2012-04-inf-eng.pdf>, para. 18.

102 Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare për Gjykim Korrekt dhe të Drejtë– Raport për periudhën nëntor 2014 – prill 2015, maj 2015, fq. 25. I arritshëm nëpërmjet: [http://all4fairtrials.org.mk/Main\\_files/Standardi\\_2015\\_MKD.pdf](http://all4fairtrials.org.mk/Main_files/Standardi_2015_MKD.pdf).

103 Ibid.,fq. 26-27.

të veçantë mbi gjendjen e implelementimit në Komunën e Prilepit.<sup>104</sup> Nga intervistat e realizuara me 12 avokatë, konstatohet se ata gjatë punës së vet nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë e nenit 58-b(3) të LPP-së, që të gjykuarve, të cilëve u është shqiptuar dënim me para deri në 90 gjoba ditore ose 1.800 euro në kundërvlerë të denarit ose dënim me burg deri në tre muaj, të parashtrajnë kërkesë që të zëvendësojnë dënimin me punë me dobi të përgjithshme.

Në lidhje me pyetjen se cilat janë arsytet për shfrytëzimin e rrallë të mbrojtësit në stacione policore, nga analiza për Mbrojtjen efektive në procedurat penale të Republikës së Maqedonisë, 48% e të anketuarve janë përgjigjur se të dyshuarit nuk janë të informuar në mënyrë korrekte për të drejtën e mbrojtësit, 18% se policia me qëllim i mashtron duke i manipuluar, kërcënuar dhe ngjashëm, ndërsa 9% se qytetarët nuk u besojnë avokatëve. Në lidhje me pyetjen A u ndihmon policia ose prokuroria të dyshuarve ose të akuzuarve për të gjetur mbrojtës, 47% janë përgjigjur ndonjëherë, 29% çdoherë dhe 24% shpeshherë. Në lidhje me pyetjen se a ekziston skemë kujdestarie ose plan për thirrje të avokatit në raste urgjente që të sigurohet e drejta e mbrojtësit ndaj personit të privuar nga liria, madje edhe në rast kur ky person nuk mund të ketë avokat, 30% janë përgjigjur se ekziston një listë e përpiluar nga Dhoma e Avokatëve, 23% janë përgjigjur me jo, por personit i mundësohet shikim në regjistrin e përgjithshëm/listën me emrat e avokatëve, 20% se mbrojtësin e angazhon familja/të afërmit e të dyshuarit, ndërsa 13% se gjykata ka listë të avokatëve me të cilët bashkëpunon. Në lidhje me pyetjen a mund të konsultohet i dyshuari me mbrojtës para marrjes së parë në pyetje, 67% janë përgjigjur çdoherë, 22% ndonjëherë, 6% asnjëherë dhe 5% shpeshherë. Në lidhje me pyetjen a i lejohet avokatit të këshillojë personin gjatë marrjes në pyetje, 37% janë përgjigjur çdoherë, 26% asnjëherë, 21% ndonjëherë dhe 16% shpeshherë.<sup>105</sup>

Në kuadër të Projektit “Rrjeti 23”, organizata partnere Shoqata e Punëtorëve Financiarë të Vetëqeverisjeve Lokale dhe të Ndërmarrjeve Publike e zbatoi Projektin „Përcaktimi i burimeve të mjeteve për financimin e pushtetit gjyqësorë, lartësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre në

104 Analiza që doli nga projekti ende nuk është e arritshme për publikun.

105 Shih fusnotën 113.

pavarësinë e pushtetit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.<sup>106</sup> Sipas hulumtimit, në pjesën e obligimeve të pashlyera në vazhdimësi transferohen edhe obligimet e pashlyera që kanë të bëjnë me obligimet për kurimin e personave të paraburgosur dhe obligimet për mbrojtësit e angazhuar me detyrë zyrtare. Këto lloje të shpenzimeve në gjykata të caktuara janë prej 5,46 deri në 34,85%. Nga analiza e llogarive vjetore dhe e raporteve vjetore të Buxhetit Gjyqësor, Shoqata konstatoi se në gjykata shpenzimet për avokatë janë ndër tre llojet më të rëndësishme të obligimeve të pashlyera dhe të maturuara (bashkë me shërbimet kontraktuese dhe komunale). Tre lloje të shpenzimeve përbëjnë pothuajse 95% të shumës së përgjithshme të detyrimeve të maturuara e të pashlyera. Sipas Shoqatës, kjo madhësi dhe strukturë e përcakton nevojën për racionalizimin e ardhshëm të shpenzimeve tjera, por edhe për sigurimin e burimeve plotësuese të mjeteve me të cilat pa pengesë do të financohen këto shpenzime. Konkluzionet e tilla e vënë në pikëpyetje interesin e avokatëve më me përvojë që të ofrojnë shërbimet si dhe cilësinë e përfaqësimit të personave të akuzuar.

### **a) E drejta e njoftimit të personit tjetër dhe përfaqësisë konsullore për privim nga liria**

Neni 34 i Ligjit për policinë përcakton se gjatë zbatimit të autorizimeve policore si: thirrje, privim nga liria, arrestim dhe ndalim, nëpunësi policor doemos duhet që menjëherë ta njoftojë personin në gjuhën që e njeh, ndër tjerash, për të drejtën që i dyshuari ose i akuzuari të njoftojë anëtarë të familjes së vet ose person të afërt të tij. Në përputhje me nenin 69 të LPP-së, personi i arrestuar ose i privuar nga liria do të këshillohet edhe për të drejtën që të njoftojë anëtarë të familjes së vet ose person të afërt të vet, gjegjësisht përfaqësinë diplomatike konsullore të shtetit, shtetas i të cilit është personi, për arrestimin ose privimin e tij nga liria. Sipas nevojës ose me kërkesë të personit të arrestuar ose të privuar nga liria do t'i sigurohet ndihmë përkatëse mjekësore. Neni 159 i LPP-së përcakton se personi i privuar nga liria, i cili është ndaluar, doemos duhet të njoftohet për të drejtën e informimit të familjes ose personit tjetër sipas zgjedhjes së tij. Në mënyrë plotësuese, në nenin 161 të LPP-së, ceket se personi i cili është shtetas i huaj ka të drejtë që të kontaktojë me përfaqësitë diplomatike konsullore të vendit të tij. Policia do t'i ndihmojë që të kontaktojë me përfaqësitë diplomatike konsullore apo me ndonjë përfaqësues tjetër me status diplomatik, i cili i përfaqëson interesat e vendit të tij. Për çdo person të ndaluar,

nëpunësi për pranim përpilon procesverbal të veçantë në të cilin futen të dhënat për, mes tjerash, kohën kur është këshilluar për të drejtat e tij, kur ka kontaktuar me familjen, mbrojtësin, mjekun dhe përfaqësinë diplomatike konsullore. Në këto të drejta të akuzuarit mund të thirren menjëherë ose në çdo kohë derisa janë të ndaluar.

Në përputhje me neni 175 të LPP-së, gjykata është e obliguar në afat prej 24 orësh për paraburgimin ta informojë familjen e personit të paraburgosur, përveç nëse personi këtë e kundërshton. Për paraburgimin do të informohet organi kompetent për punë sociale, nëse është e nevojshme që të merren masa për kujdesin e fëmijëve dhe anëtarëve tjerë të familjes, për të cilët kujdeset personi i paraburgosur. Neni 178 përcakton se shefat e përfaqësive diplomatike konsullore të Republikës së Maqedonisë, me leje të gjykatësit të procedurës paraprake i cili e realizon procedurën hetimore, kanë të drejtë që ta vizitojnë edhe pa mbikëqyrje dhe të bisedojnë me personin e paraburgosur shtetas i shtetit të tyre. Leja për vizitë kërkohet nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Në përputhje me nenin 98 të Ligjit për drejtësinë e fëmijëve, fëmija thirret nëpërmjet prindërve, gjegjësisht kujdestarit, përveç nëse kjo nuk është e mundur, për shkak të nevojës për veprim urgjent ose të rrethanave tjera. Prindërit, përfaqësuesi ligjor, gjegjësisht organi për kujdestari, detyrimisht dhe menjëherë, por më së voni për dy, orë njoftohen për thirrjen e fëmijës.

Në lidhje me pyetjen se a mund ta informojë personin e tretë personi i privuar nga liria, nga analiza e Mbrojtjes efektive në procedurat penale të Republikës së Maqedonisë për këtë, 47% janë përgjigjur çdoherë, 23% ndonjëherë, 18% shpeshherë dhe 12% asnjëherë. Në lidhje me pyetjen se a mund të kontaktojë personi me persona të tretë, 41% janë përgjigjur asnjëherë, 25% çdoherë, 17% ndonjëherë dhe 17% shpeshherë. Në lidhje me pyetjen se a mund që ta informojë përfaqësinë e tij diplomatike konsullore personi i privuar nga liria, 41% janë përgjigjur çdoherë, 29% shpeshherë, 18% ndonjëherë dhe 12% shpeshherë. Në lidhje me pyetjen se a e ndihmon personin policia që të gjejë informata kontaktuese të përfaqësisë diplomatike konsullore për arrestimin e tij, 34% janë përgjigjur çdoherë, 33% – ndonjëherë, 20% shpeshherë dhe 13% asnjëherë. Në lidhje me pyetjen se a mund të komunikojë çdoherë me përfaqësinë diplomatike personi i privuar nga liria, 36% janë përgjigjur çdoherë, 36% shpeshherë, 14% ndonjëherë dhe 14% asnjëherë.

<sup>106</sup> Analiza që doli nga projekti ende nuk është e arritshme për publikun.

## E drejta e përkthyesit dhe interpretuesit në procedurën penale

Neni 14(3)(f) i Paktit Ndërkombëtarë mbi të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) dhe 6(3)(e) i KEDNJ-së e garanton të drejtën e përkthyesit dhe interpretuesit falas, për personat e dyshuar dhe të akuzuar në rast kur ata nuk e kuptojnë gjuhën ose gjuhët që përdoren në gjykatën kombëtare. Përkthimi verbal dhe me shkrim i procedurës së shkruar është me rëndësi thelbësore për personin, kundër të cilit mbahet procedurë penale, i cili doemos duhet të njoftohet me kallëzimin penal ose me aktakuzën kundër tij. Sipas Komitetit për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara, kjo e drejtë është “me rëndësi të veçantë në lëndët në të cilat mosnjohja ose vështirësitë në kuptimin e gjuhës që përdoret në gjykata janë pengesa kryesore gjatë realizimit të të drejtave të mbrojtjes.”<sup>107</sup> Sipas GJEDNJ-së, madje edhe kur mbrojtësi i të akuzuarit do të heq dorë nga kjo e drejtë, gjykatësi i cili në atë moment e ushtron funksionin është “mbrojtësi përfundimtarë i drejtësisë së procedurës” dhe, si i tillë, doemos duhet të ketë “kujdes të jashtëzakonshëm” për të drejtat e të akuzuarit, veçanërisht kur do të konstatojë se ai nuk e kupton ose ka vështirësi gjatë kuptimit të gjuhës në të cilën mbahet procedura.<sup>108</sup> Sipas kësaj, mospajtimi i interpretuesit gjatë kohës së procedurës penale është i barabartë me shkeljen e nenit 6 të KEDNJ-së.

Nga ana tjetër, autoritetet nuk janë të obliguara që të sigurojnë interpretim nëse i akuzuari e flet gjuhën në të cilën mbahet procedura, por kërkon t'u drejtohet autoriteteve në gjuhë tjetër. Sipas Komitetit për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara, nëse “personi ka mundësi që në mënyrë përkatëse ta kuptojë dhe të shprehet në gjuhën zyrtare”, autoritetet nuk janë të detyruara të sigurojnë interpretim.<sup>109</sup> As në fillim, e as në fund të procedurës, shteti nuk ka të drejtë të kërkojë nga personat e dyshuar ose të akuzuar që të paguajnë për përkthim ose interpretim. Kjo ka të bëjë edhe me rastet në të cilat i akuzuari do të gjykohej në mënyrë të plotfuqishme. GJEDNJ-ja ka përcaktuar shkelje të nenit 6 të

KEDNJ-së në rastin ku autoritetet kanë kërkuar nga personat e gjykuar që t'i kompensojnë harxhimet e interpretimit gjatë procedurës gjyqësore.<sup>110</sup>

## Direktiva 2010/64/BE mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale

Direktiva 2010/64/BE mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale, që hyri në fuqi më 27 tetor 2014,<sup>111</sup> është Direktiva e parë në fushën e të drejtës procesuale penale, pas hyrjes në fuqi të *Marrëveshjes së Lisbonës*. Në parathënien e Direktivës thuhet se ajo është miratuar me qëllim që të lehtësohet zbatimi i të drejtës së gjykimit të drejtë në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së dhe interpretimit të tij nëpërmjet praktikës së GJEDNJ-së. Sipas Direktivës, e drejta e përkthyesit dhe e interpretuesit në procedurën penale zbatohet që nga momenti kur personi nga autoritetet njoftohet me detyrë zyrtare ose në mënyrë tjetër, se është i dyshuar ose i akuzuar për kryerje të veprës penale, e deri në përfundimin e procedurës. Pas përfundimit të procedurës nënkuptohet vendimi përfundimtar në lidhje me pyetjen se a është kryer vepra, atje ku është i zbatueshëm shqiptimi dhe zgjidhja sipas ankesës [neni 1(2)]. Kjo e drejtë sigurohet falas, pa dallim të rezultatit përfundimtarë të procedurës penale (neni 4).

### a) E drejta e interpretimit

Për personat e dyshuar dhe të akuzuar, të cilët nuk e kuptojnë gjuhën e procedurës penale, Direktiva imponon sigurim të pashtyrë të interpretuesit para autoriteteve hetimore dhe gjyqësore, duke përfshirë edhe marrjen në pyetje në polici, të gjitha shqyrtimet gjyqësore dhe diskutimet e domosdoshme të përkohshme. E drejta e interpretimit, kur është e domosdoshme për mbrojtjen e drejtësisë në procedurë, duhet të sigurohet edhe gjatë komunikimit

107 General Comment No. 13, Article 14 (Administration of Justice), Equality before the Courts and the Right to a Fair and Public Hearing by an Independent Court Established by Law, 13 April 1984, para. 13.

108 Cuscani v the United Kingdom (32771/96), 24 September 2002, para. 39.

109 Yves Cadoret, Hervé Le Bihan v France (323/1988), 11 April 1991, para. 5.6.

110 Luedicke, Belkacem and Koç v Germany (6210/73, 6877/75 and 7132/75), 28 November 1978, para. 50.

111 <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1433806057348&uri=CELEX:32010L0064>.

midis personit të dyshuar ose të akuzuar dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në lidhje me çfarëdo qoftë hetimi ose seancë gjyqësore gjatë procedurës, gjatë parashtrimit të ankesës ose parashtrësës procesuale. Kjo e drejtë përfshin edhe ndihmë përkatëse për personat me dëmtim të dëgjimit dhe të folurit. Autoritetet duhet të sigurojnë edhe procedurë ose mekanizëm për përcaktimin e asaj nëse personi i dyshuar ose i akuzuar e flet dhe e kupton gjuhën e procedurës penale dhe a ka nevojë për ndihmën e interpretuesit. Përveç kësaj, shteti duhet të sigurojë mundësi që personi i dyshuar ose i akuzuar të mund ta kontestojë vendimin nëpërmjet të cilit përcaktohet se nuk ka nevojë për interpretues, si dhe mundësinë e ankesës në lidhje me cilësinë e interpretimit, nëse personi konsideron se ai nuk mjafton për mbrojtjen e drejtësisë në procedurë. Të gjitha këto të drejta në lidhje me interpretimin përfshihen në nenin 2 të Direktivës.


### **b) E drejta e përkthimit të dokumenteve me rëndësi thelbësore**

E drejta e përkthimit të dokumenteve me rëndësi thelbësore ka të bëjë me përkthimin me shkrim të të gjitha dokumenteve që konsiderohen si thelbësore për sigurimin e të drejtave të mbrojtjes dhe për sigurimin e drejtësisë në procedurë. Si dokumente thelbësore, në kuptim të Direktivës, llogariten: çfarëdo qoftë vendimi me të cilin personi privohet nga liria, kallëzimi penal ose propozim/aktakuza dhe cilido qoftë aktgjykim. Varësisht nga lënda, prej autoriteteve pritet që të vendosin nëse edhe ndonjë dokument tjetër mund të llogaritet si thelbësor për procedurën, ndërsa për personin e dyshuar dhe të akuzuar dhe mbrojtësin e tij mundësohet parashtrimi i kërkesës së arsyetuar për realizimin e kësaj të drejte. Megjithatë, kjo nuk ka të bëjë edhe me fragmentet e dokumenteve thelbësore që nuk janë relevante për të mundësuar që personi i dyshuar ose i akuzuar të njoftohet me lëndën kundër tij. Në rast të tillë, personi ose mbrojtësi i tij kanë mundësi të kontestojnë vendimin me të cilin përcaktohet se nuk ka nevojë për përkthimin e ndonjë dokumenti ose fragmenti të tij. Si përjashtim nga këto rregulla të përgjithshme për përkthimin me shkrim të dokumenteve, mund të sigurohet përkthim me gojë ose rezyme me gojë, me kusht që përkthimi i tillë të mos e cenojë drejtësinë e procedurës. Çdo heqje dorë nga kjo e drejtë doemos duhet të kushtëzohet me sugjerim, këshillim juridik ose me mënyrë tjetër që personit të dyshuar ose të akuzuar t'i bëhen të ditura pasojat nga heqja

dorë, si dhe përcaktimi nëse kjo është pa mëdyshje dhe në bazë vullnetare. E drejta e përkthimit të dokumenteve me rëndësi thelbësore përfshihet në nenin 3 të Direktivës.

### **c) Cilësia e interpretimit dhe e përkthimit dhe trajnimet**

Me qëllim që interpretimi dhe përkthimi të kenë cilësi, që të sigurojnë drejtësinë e procedurës, shteti duhet të tentojë të krijojë një regjistër ose regjistra të interpretuesve dhe përkthyesve të pavarur me kualifikime përkatëse. Pasi të themelohen, këto regjistra duhet t'u vihen në dispozicion mbrojtësve dhe organeve kompetente. Shteti, gjithashtu, duhet të sigurojë që interpretuesit dhe përkthyesit të jenë të besueshëm, në lidhje me atë që e kanë kuptuar gjatë punës së tyre. Në fund, autoritetet duhet të kërkojnë prej personave të angazhuar për trajnimin e gjykatësve, prokurorëve dhe personelit gjyqësor, të kyçur në procedura penale, që të përkushtojnë vëmendje në tiparet e komunikimit me ndihmë të interpretuesit, me qëllim që të sigurojnë komunikim efikas dhe efektiv. Cilësia e interpretimit dhe e përkthimit përfshihet në nenin 5, ndërsa trajnimet në nenin 6 të Direktivës.



## E drejta e përkthyesit dhe e interpretuesit në Republikën e Maqedonisë

Në përputhje me nenin 8 të Ligjit për Procedurë Penale (LPP),<sup>112</sup> gjuhë zyrtare në procedurën penale është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Në procedurë mund të përdoret edhe gjuhë tjetër zyrtare që e flasin më së paku 20% e qytetarëve. Kjo e drejtë e përfshin edhe përdorimin e alfabetit të asaj gjuhe. Duke pasur parasysh se komuniteti shqiptar është i vetmi që përfaqësohet me mbi 20% të popullatës së përgjithshme, si gjuhë tjetër zyrtare konsiderohet gjuha shqipe dhe alfabeti i saj.<sup>113</sup> E drejta e përkthyesit, përkatësisht interpretuesit përfshihet në nenin 9 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se i akuzuari<sup>114</sup> i cili flet në gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja ka të drejtë që në procedurë ta përdorë gjuhën dhe alfabetin e vet. Përveç kësaj, i akuzuari në procedurë para gjykatës ka të drejtë në ndihmë falas të përkthyesit, përkatësisht interpretuesit. Listën me emra të përkthyesve të përhershëm gjyqësor e azhuron Ministria e Drejtësisë.<sup>115</sup> Nga kjo listë me emra mund të shihet se në Republikën e Maqedonisë interpretimi dhe përkthimi gjyqësor sigurohet vetëm në 25 gjuhë botërore. Organi që e mban procedurën është i detyruar të sigurojë përkthim me gojë të asaj që personi dhe të tjerët e paraqesin, si dhe të dokumenteve dhe të materialit tjetër të shkruar të dëshmisë. Organi që e mban procedurën do të sigurojë që me shkrim të përkthehet materiali i shkruar, që është me rëndësi për procedurën apo për mbrojtjen e të akuzuarit. Personi, i cili nuk e flet gjuhën zyrtare, në gjykatë këshillohet për të drejtën e përkthyesit, gjegjësisht interpretuesit. Ky këshillim dhe deklaratë e personit shënohen në procesverbal para organit që e mban procedurën. Përkthimin e kryen përkthyesi,

112 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 150/2010 dhe 100/2012.

113 Në përputhje me Kapitullin IV të Ligjit për përdorimin e gjuhës që e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 101/2008 dhe 100/2011).

114 Sipas nenit 21(2) të LPP, me nocionin "i akuzuar" nënkuptohet personi kundër të cilit është vërtetuar aktakuza, është parashtruar propozim – aktakuzë, është parashtruar propozim për zbatimin e masës së sigurisë, është parashtruar padi private ose është parashtruar propozim për lëshimin e urdhërdënimit. Shprehja i akuzuar në LPP përdoret edhe si emër i përgjithshëm për të dyshuarin, të akuzuarin dhe të gjykuarin.

115 <http://www.pravda.gov.mk/sudskipreveduvaci/>.

përkatësisht interpretuesi gjyqësor. Në nenin 10 të LPP-së përcaktohet se qytetarët, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja (shqipja) dhe persona të tjerë të cilët nuk e flasin ose nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, parashtruesat mund t'i parashtrojnë në gjuhën dhe shkrimin e vet. Parashtruesat e tilla pastaj përkthehen u dërgohen palëve në procedurë me detyrë zyrtare. Të akuzuarit, i cili nuk e kupton gjuhën në të cilën mbahet procedura, i dërgohet përkthimi i aktakuzës në gjuhën me të cilën është shërbyer në procedurë. Në përputhje me nenin 38 të LPP, përkthyesit dhe interpretuesit teoritikisht mund të përjashtohen nëse ekzistojnë rrethana që shkaktojnë dyshime në paanshmërinë e tyre. Në përputhje me nenin 92 të LPP-së, në fund të procesverbalit do të nënshkruhen përkthyesi, përkatësisht interpretuesi nëse kanë qenë pjesëmarrës në procedurë. Neni 211 përcakton se marrja në pyetje e të akuzuarit do të kryhet nëpërmjet interpretuesit, në raste të parapara me LPP-në. Nëse i akuzuari është i shurdhër, me shkrim do t'i parashtrohen pyetje, ndërsa nëse është memec, do të thirret që të përgjigjet me shkrim. Nëse marrja në pyetje nuk mundet të kryhet në këtë mënyrë do të thirret si interpretues personi i cili mund të merret vesh me të akuzuarin (neni 221). Interpretuesi duhet të betohet se besnikërisht do t'i transmetojë pyetjet që i drejtohen të akuzuarit dhe deklaratat që ai i jep. Në përputhje me neni 449, një prej kushteve për përsëritjen e procedurës është nëse dëshmohet se aktgjykimi është bazuar mbi deklaratën e rrëshme të interpretuesit ose përkthyesit.

Nga praktika e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, kishim lëndë specifike K-617/14 kundër të akuzuarit B.S., 21 vjeçar, pjesëtarë i komunitetit rom, që u mbajt para Gjykatës Themelore në Kumanovë dhe Gjykatës së Apelit në Shkup. Në procesin konkret gjyqësor u dëmtuan tre shtetas të Afganistanit, vend në të cilin ka dy gjuhë në përdorim zyrtar: dariniane dhe pashtuane. Në mënyrë të dukshme nga shkresat e lëndës, si dhe gjatë seancës kryesore njëri prej të dëmtuarve kishte baza fillestare por, të pamjaftueshme të njohjes së gjuhës angleze, ndërsa në procedurë mori pjesë interpretuesi nga gjuha maqedonase në atë angleze. Dy të dëmtuarit e tjerë aspak nuk e flisnin gjuhën angleze, por marrja e tyre në pyetje u realizua në mënyrë që përkthyesi gjyqësor fillimisht i përkthente të dëmtuarit me njohje të dobëta të gjuhës angleze, i cili pastaj

u përkthente të dëmtuarve të tjerë, e pastaj ata i drejtoheshin atij, ai interpretuesit, ndërsa interpretuesi pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Provë e mjaftueshme se të dëmtuarit nuk e flisnin gjuhën angleze ishte deklarata e njërit dëshmitarë, i cili gjatë shqyrtimit kryesor dëshmoi se edhe pse ka njohje të dobët të gjuhës angleze, prapë se prapë të dëmtuarve u është drejtuar në atë gjuhë, ndërsa ka kuptuar se ata nuk e flasin mirë gjuhën angleze. Nëpërmjet mënyrës së tillë, aspak nuk është e mundur të kontrollohet deklarata e të dëmtuarve që rezultoi me përcaktim paushal dhe të paplotë të gjendjes faktike dhe me shqiptim të sanksionit me burg. Edhe pse në përputhje me nenin (415)(1)(12) të LPP-së cenimi thelbësor i dispozitave të procedurës penale ekziston edhe kur gjykata ka shkelur dispozitat për përdorimin e gjuhës në procedurë, Gjykata e Apelit në Shkup nëpërmjet aktgjykimit KZh. nr. 1737/14 e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë, duke e zvogëluar vetëm sanksionin penal.

## E drejta e informimit në procedurë penale

E drejta e informimit në procedurë penale nënkupton obligimin që autoritetet ta informojnë personin e dyshuar ose të akuzuar për të drejtat e tij gjatë procedurës. Këta persona duhet të informohen për listën e plotë të të drejtave që garantohen nëpërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe vendore. Njoftimi i tillë, varësisht nga rrethanat dhe nga faza e lëndës, mund të referohet në këto të drejta: njoftimi për shkaqet e arrestimit ose paraburgimit, qasja deri te avokati, ndihma falas juridike, interpretuesi dhe përkthyesi, e drejta e heshtjes, të mos dëshmojë kundër vetvetes, të njoftohet personi tjetër ose përfaqësia konsullore për privimin nga liria, të thirren dhe të merren në pyetje dëshmitarët, të prezantohen prova ose të propozohet grumbullimi i tyre, dëmshtëpblimi për paraburgim të paligjshëm ose të pabazë, etj.

## Direktiva 2012/13/BE mbi të drejtën e informimit në procedurë penale

Direktiva 2012/13/BE mbi të drejtën e informimit në procedurë penale, që hyri në fuqi më 2.6.2014,<sup>116</sup> është Direktiva e dytë, e miratuar në sferën e të drejtës procesuale penale, pas hyrjes në fuqi të *Marrëveshjes së Lisbonës*. Në parathënien e Direktivës thuhet se thirrja e personave të dyshuar ose të akuzuar, që janë arrestuar ose paraburgosur, duhet të kuptohet gjatë thirrjes në çfarëdo qoftë situatë, gjatë procedurës penale, personat e dyshuar ose të akuzuar janë privuar nga liria në kuptim të nenit 5(1)(c) dhe interpretimit të tij nëpërmjet praktikës së GjEDNJ-së.<sup>117</sup> Direktiva i përcakton rregullat në lidhje me të drejtën e informimit të personave të dyshuar dhe të akuzuar, sa u përket të drejtave të tyre në procedurë penale, si dhe akuzave kundër tyre (neni 1). Rregullat që dalin nga Direktiva zbatohen nga momenti kur personi nga autoritetet njoftohet me detyrë zyrtare ose në mënyrë tjetër, se është i dyshuar ose i akuzuar për kryerjen e veprës penale, e deri në përfundim të procedurës. Me përfundim të procedurës nënkuptohet vendimi përfundimtar lidhur me pyetjen nëse e ka kryer veprën dhe atje ku është e mundur, shqiptimi i dënimit dhe zgjidhja sipas ankesës (neni 2).

### a) E drejta e informimit mbi të drejtat

Për të gjithë personat e dyshuar dhe të akuzuar, me qëllim që të mundësohet shfrytëzimi efektiv i të drejtave, Direktiva imponon informimin e tyre në kohë, më së paku për ato të drejta që u janë në dispozicion:

- e drejta e qasjes për avokat;
- e drejta e ndihmës falas juridike dhe kushtet nën të cilat ajo mund të merret;

116 <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1433812388644&uri=CELEX:32012L0013>.

117 Çdo njeri ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk guxon të privohet nga liria, përveç në bazë të ligjit në rastet e mëposhtme: nëse është i arrestuar ose i paraburgosur për shkak të nxjerrjes para autoritetit kompetent gjyqësor, kur ekziston dyshim me arsye se ky person ka kryer veprë penale ose kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që ky person të parandalohet të kryejë veprë penale ose pas kryerjes së veprës penale të ikë.

- e drejta që të njoftohet për akuzën;
- e drejta e interpretuesit dhe përkthyesit; dhe
- e drejta e heshtjes.

Njoftimi për këto të drejta duhet të jepet me gojë ose me shkrim, në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke e marrë parasysh cilëndo qoftë nevojë të veçantë të personave vulnerabil të cilët janë të dyshuar ose të akuzuar. E drejta e informimit mbi të drejtat përfshihet në nenin 3 të Direktivës.

### **b) Letër mbi të drejtat gjatë arrestimit**

Për personat e dyshuar ose të akuzuar, të cilët janë arrestuar ose paraburgosur, autoritetet në kohë dhe me shkrim duhet t'u sigurojnë Letër mbi të drejtat. Këtyre personave duhet t'u jepet mundësi që ta lexojnë Letrën mbi të drejtat dhe t'u mundësohet që Letrën ta mbajnë me vete gjatë privimit të tyre nga liria. Përveç informimit për të drejtat e përfshira në nenin 3 të Direktivës, Letra mbi të drejtat duhet t'i përmbajë edhe:

- të drejtën e qasjes në dokumentet e lëndës;
- të drejtën e njoftimit të përfaqësisë konsullore dhe të personit tjetër;
- të drejtën e ndihmës urgjente mjekësore; dhe
- numrin maksimal të orëve ose ditëve gjatë të cilave personi i dyshuar ose i akuzuar mund të privohet nga liria para se të nxirret para organit gjyqësor.

Përveç kësaj, Letra mbi të drejtat duhet të përmbajë edhe informata të përgjithshme për çfarëdo qoftë mundësie që të kontestohet ligjshmëria e arrestimit, rishikimi i arrestimit, gjegjësisht paraburgimi dhe mundësia për të parashtruar kërkesë për lirim me kusht. Letra mbi të drejtat duhet të përpilohet në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Direktiva përmban model indikativ të Letrës mbi të drejtat, që është bartur në Aneksin I të kësaj analize. Letra personave të dyshuar ose akuzuar duhet t'u jepet në gjuhën që e kuptojnë. Në rast se Letra nuk është e arritshme në gjuhën përkatëse, personat duhet të njoftohen mbi të drejtat e tyre me gojë në gjuhën që e kuptojnë, ndërsa letra e përkthyer në gjuhën që e kuptojnë duhet t'ju dorëzohet pa shtyrje të panevojshme. E

drejta për Letrën mbi të drejtat gjatë arrestimit përfshihet në nenin 4 të Direktivës.

### **c) E drejta e informimit për akuzën**

Autoritetet janë të detyruara t'i informojnë personat e dyshuar dhe të akuzuar për veprën penale për të cilën dyshohen ose akuzohen se e kanë kryer. Informimi duhet të jetë në kohë dhe të përmbajë aq detaje sa që nevojiten për t'u siguruar drejtësia e procedurës dhe praktikimi efektiv i të drejtave nga ana e mbrojtjes. Përveç kësaj, më së voni deri në parashtrimin e akuzës në gjykatë, autoritetet duhet të sigurojnë njoftim të hollësishëm në lidhje me akuzën, duke përfshirë edhe natyrën dhe klasifikimin juridik të veprës penale, si dhe shkallën e pjesëmarrjes nga personi i akuzuar. E drejta e njoftimit për akuzë përfshihet në nenin 6 të Direktivës.

### **ç) Qasja në dokumentet e lëndës**

Në rastet kur personi është i arrestuar ose i paraburgosur, në cilëndo qoftë fazë të procedurës, autoritetet personit ose mbrojtësit të tij duhet t'i sigurojnë qasje në dokumentet që kanë të bëjnë me rastin konkret dhe gjenden në posedim të organeve kompetente, ndërsa konsiderohen thelbësore për kontestimin efektiv të ligjshmërisë gjatë arrestimit ose paraburgimit. Qasja në dokumentet e lëndës duhet të sigurohet në afat të arsyeshëm, me qëllim të praktikimit efektiv të të drejtave të mbrojtjes, e më së voni që nga parashtrimi i akuzës për vlerësim deri në miratimin e aktgjykimit. Nëse gjatë procedurës autoritetet arrijnë në posedim të provave të reja materiale, qasja në to duhet të sigurohet me kohë. Si përjashtim i këtyre rregullave, me kusht që të mos cenohet drejtësia e procedurës, qasja në materiale të caktuara mund të refuzohet nëse qasja e tillë mund të çojë në kërcënim serioz të jetës ose të drejtave themelore të personit tjetër ose nëse refuzimi i tillë është i domosdoshëm në mënyrë rigorozë për mbrojtjen e interesit të rëndësishëm publik. Si shembull për këto përjashtime janë rastet në të cilat qasja do të thotë dëmtim të hetimeve rrjedhëse ose nëpërmjet qasjes seriozisht mund të cenohet siguria kombëtare e shtetit. Refuzimi i qasjes mund të bëhet vetëm me vendim të organit gjyqësor, ose më së paku të jetë lëndë e revizionit gjyqësor. E drejta e qasjes në dokumentet e lëndës përfshihet në nenin 7 të Direktivës.

## E drejta e informimit në procedurën penale të Republikës së Maqedonisë

Neni 12 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë përcakton se liria e njeriut është e pacenueshme dhe se personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria duhet me patjetër të informohet menjëherë për shkaqet e thirrjes, arrestimit apo privimit të tij nga liria dhe me të drejtat e tij të përcaktuara me ligj dhe prej tij nuk mund të kërkohet deklaratë. Në pajtim me neni 34 të Ligjit për policinë,<sup>118</sup> gjatë zbatimit të autorizimeve policore si thirrje, privim nga liria, arrestim dhe ndalim, nëpunësi policor doemos duhet që menjëherë ta informojë personin në gjuhën që e kupton, për shkaqet e thirrjes, privimit nga liria, arrestimit ose ndalimit dhe në mënyrë të qartë ta këshillojë për të drejtën e heshtjes, të drejtën që të këshillohet me mbrojtësin, të drejtën e mbrojtësit gjatë procedurës policore, të drejtën e ndihmës mjekësore nëse personi e kërkon atë, si dhe për të drejtën që të njoftohet një anëtarë i familjes së tij ose person i afërt i tij. E drejta e ndihmës mjekësore, sipas nevojës ose me kërkesë të të akuzuarit, përcaktohet edhe në nenin 69 (3) të LPP-së, si dhe në nenin 160 (6) të LPP-së në të cilin përcaktohet se kontroll mjekësor do të ofrohet çdoherë kur personi do të ankohet në lëndim, dhimbje ose sëmundje. Nëpunësi për pranim në stacionin policor çdoherë duhet të pyet nëse personi vuan nga ndonjë sëmundje dhe nëse është në ndonjë trajtim mjekësor, gjegjësisht nëse merr ndonjë ilaç.

Në nenin 69 të LPP-së përcaktohet se i akuzuari së pari doemos duhet që në mënyrë të qartë të këshillohet për të drejtën që të heshtë, për të drejtën që të këshillohet me avokat dhe të ketë mbrojtës sipas zgjedhjes së tij gjatë marrjes në pyetje. Në përputhje me nenin 70 të LPP-së, secili i akuzuar ka të drejtë në kohë dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, e posaçërisht të ketë qasje në dokumente dhe të njoftohet me provat kundër tij dhe në dobi të tij. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 79, gjatë procedurës penale, mbrojtësi ka të drejtë t'i shqyrtojë dokumentet dhe provat, të shikojë dhe të marrë përshkrim nga procesverbalet dhe dokumentet tjera në veprimet në të cilat mbrojtja ka pasur të drejtë të merr pjesë, e që ruhen në prokurorinë publike. Në lidhje me paraburgimin e mundshëm, në përputhje me nenin 169 të LPP-së, vendimi

për paraburgim menjëherë i dorëzohet personit për të cilin ka të bëjë, por jo më gjatë se gjashtë orë nga nxjerrja e tij para gjykatësit në procedurë paraprake.

Në nenin 206 të LPP-së përcaktohet se para çdo hetimi gjyqësor i akuzuari detyrimisht do të informohet dhe këshillohet:

- pse akuzohet dhe cilat janë bazat e dyshimit kundër tij;
- se nuk është i obliguar që ta paraqesë mbrojtjen e vet, e as t'u përgjigjet pyetjeve të parashtruara, por nëse jep deklaratë ajo mundet të shfrytëzohet në procedurën kundër tij;
- se mund të marrë mbrojtës me zgjedhje të vet me të cilin mundet vet të këshillohet dhe i cili mund të marrë pjesë në hetim;
- se mund të deklarohet për veprën e cila i ngarkohet dhe t'i paraqesë të gjitha faktet apo provat që i shkojnë në dobi;
- se ka të drejtë shikimi në dokumente dhe t'i shikojë sendet që janë konfiskuar;
- se ka të drejtë e ndihmës falas të përkthyesit, përkatësisht interpretuesit nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që shfrytëzohet gjatë marrjes në pyetje; dhe
- se ka të drejtë kontrolli nga mjeku gjatë trajtimit mjekësor ose për shkak të përcaktimit të tejkalimeve eventuale policore.

I akuzuari mund të heqë dorë vullnetarisht nga ndonjë e drejtë, por marrja e tij në pyetje nuk mund të fillojë nëse deklarata se heq dorë nga ndonjë e drejtë nuk shënohet me shkrim dhe derisa nuk nënshkruhet nga ai. Personi nuk mund të heqë dorë nga e drejta e mbrojtësit nëse mbrojtja është e obliguar. Nëse është vepruar në kundërshtim me ndonjë rregull, deklarata e të akuzuarit nuk mundet të shfrytëzohet gjatë procedurës gjyqësore.

Në një analizë të mëparshme, e titulluar "Mbrojtja efektive në procedurat penale të Republikës së Maqedonisë", në pyetjen „Nëse, në praktikë, personi informohet për të drejtat e tij para se të merret në pyetje?“, nga 90 të anketuar përfaqësues të policisë dhe të organeve gjyqësore, 63% janë përgjigjur me "çdoherë",

118 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 114/2006, 6/2009, 145/2012, 41/2014 dhe 33/2015.



26% ndonjëherë dhe 11% asnjëherë.<sup>119</sup> Në lidhje me pyetjet „Në cilën mënyrë, në praktikë, i akuzuari informohet mbi të drejtat e tij?“, 74% nga të anketuarit janë përgjigjur “me gojë”, 21% „me shkrim“ dhe 5% se „personi aspak nuk informohet“. Për të drejtën e qasjes në dokumentet e lëndës, 24% janë përgjigjur se ajo e drejtë është siguruar, 41% se nuk është siguruar dhe 35% se sigurohet ndonjëherë. Për të drejtën e njoftimit të përfaqësisë konsullore dhe personit tjetër, 72% janë përgjigjur me “po”, 17% me „jo“ dhe 11% me „ndonjëherë“. Për të drejtën e ndihmës mjekësore, 58% - „po“, 10% - „jo“ dhe 32% - „ndonjëherë“. Për të drejtën e mbrojtësit, 56% - „po“ dhe 44% - „jo“. Në lidhje me pyetjen „Nëse, respektohet në praktikë, ndalimi që në procedurë gjyqësore të përdoret deklarata nga i akuzuari i cili para se të merret në pyetje, nuk është këshilluar mbi të drejtat?“, 80% janë përgjigjur me „po“, ndërsa 20% me „jo“.<sup>120</sup>

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### Konkluzione

1. Masa e paraburgimit në raste të caktuara përdoret si dënim ose si frikësim. Paraburgimi zgjat shumë dhe ekziston përdorim i pamjaftueshëm i masave alternative.
2. Ekziston mbipopullim në repartet e paraburgimit, ndërsa kushtet janë jonjerëzore dhe johumane.
3. Ligji për procedurë penale, Ligji për policinë dhe Ligji për drejtësi për fëmijët, në masë të madhe i përmbyjnë zgjidhjet e parapara nëpërmjet standardeve minimale për mbrojtjen e të drejtave procesuale të personave të dyshuar dhe të akuzuar në nivel të BE-së. Edhe krahas konkluzionit të tillë pozitiv, problemet me realizimin e të drejtave procesuale kanë të bëjnë me zbatimin e zgjidhjeve ligjore në praktikë. Një problem plotësues paraqet edhe numri i vogël i hulumtimeve empirike nëpërmjet të cilëve do të ishin të mundshme konkluzionet relevante për zbatimin real të të drejtave procesuale.
4. Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e

interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale janë mjaft të paqarta në kuptim të momentit prej kur personave të dyshuar dhe të akuzuar duhet t'u sigurohet e drejta. Kjo në veçanti ka të bëjë me procedurën paraprake që mbahet para policisë dhe / ose prokurorisë publike. Problemet në implementimin e kësaj të drejte në praktikë kanë të bëjnë me Listën e emrave të përkthyesve të përhershëm gjyqësor, sipas të cilës, përkthimi, gjegjësisht interpretimi sigurohet në vetëm 25 gjuhë botërore, si dhe sigurimi i përkthyesit ose interpretuesit në gjuhën për të cilën të akuzuarit kanë vetëm njohuri bazike.

5. Nuk ekziston mekanizëm për përcaktim nëse personi i dyshuar ose i akuzuar e flet dhe e kupton gjuhën e procedurës penale, nëse ka nevojë për ndihmë të interpretuesit dhe nëse përkthimi dhe interpretimi janë me cilësi që të sigurohet mbrojtje e drejtësisë në procedurë. Interpretuesit dhe përkthyesit mundet të përjashtohen vetëm nëse gjykata konsideron se janë të njëanshëm. Përveç kësaj, nuk ekziston mundësi për parashtrimin e ankesës me të cilën personi i dyshuar ose i akuzuar mundet ta kontestojë vendimin nëpërmjet të cilit përcaktohet se nuk ka nevojë për interpretues.
6. Nuk ceken në mënyrë eksplicite “dokumentet thelbësore” që duhet të përkthehen me patjetër, e që sipas Direktivës 2010/64/BE çdoherë janë vendimi për privim nga liria, kallëzimi penal, propozim/aktakuza, cilido qoftë aktgjykim, si dhe dokumente tjera që mund të konsiderohen si thelbësore. Për shkak të gjendjes së tillë, nuk parashihet në mënyrë eksplicite as e drejta që të dyshuarit, të akuzuarit dhe avokatët e tyre të mundet të parashtrajnë kërkesë me arsyetim për realizimin e kësaj të drejte.
7. Në programet e trajnimit të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë nuk është i inkuorporuar trajnimi i detyrueshëm i së drejtës së interpretimit dhe përkthimit në procedurë penale, me çka nga gjykatësit dhe prokurorët nuk mundet të pritët që të kenë paranojë përkatëse për karakteristikat e të komunikuarit me ndihmën e interpretuesit.
8. Legjislati kombëtar nuk parashih që personat e dyshuar dhe të akuzuar të informohen për të drejtën e ndihmës falas juridike dhe për kushtet nën të cilat mund të fitohet, e as që ekziston dispozitë eksplicite nëpërmjet të cilës policia do të ketë për detyrë që personat të cilët janë privuar nga liria

<sup>119</sup> Gordan Kallajxhiev dhe të tjerë, Fondacioni Shoqëria e Hapur e Maqedonisë, qershor 2014, fq. 76.

<sup>120</sup> Ibid., fq. 77-78.

t'i informojë për të drejtën e interpretuesit dhe përkthyesit. Nuk ekziston as dispozitë nëpërmjet të cilës përcaktohet se policia dhe organet tjera gjyqësore duhet të kenë parasysh çfarëdo qoftë nevojë të veçantë të personave vulnerabil të cilët janë të dyshuar ose të akuzuar. Në praktikë, gjykatat nuk sigurojnë informata për të drejtat e cekura, as me gojë, e as me shkrim.

9. Ligji për ndihmë falas juridike nuk i përfshin të gjithë personat e varfër dhe nuk mundëson qasje të njëjtë në drejtësi për qytetarët e rrezikuar social. Diskriminimi nuk parashihet si sferë për të cilën mundet të lejohet ndihmë falas juridike.
10. Policia dhe prokuroria nuk kanë për obligim që personave të dyshuar dhe të akuzuar në kohë dhe me shkrim t'u dorëzojë Letër mbi të drejtat, para marrjes së parë në pyetje, siç parasheh Direktiva 2012/13/BE.
11. Në legjislacionin kombëtarë nuk ekziston dispozitë eksplicite nëpërmjet të cilës policisë do t'i urdhërohet që personit të arrestuar ose paraburgosur t'i sigurojë qasje në dokumente që llogariten si thelbësore për kontestimin efektiv të ligjshmërisë së arrestimit ose paraburgimit.
12. Në legjislacionin kombëtar nuk ekziston dispozitë eksplicite nëpërmjet të cilës do të parashihet se qasja për avokat ka të bëjë edhe me personat të cilët nuk janë të dyshuar apo akuzuar, por gjatë procedurës hetimore nga policia do të fitojnë status të tillë, në kuptim të Direktivës 2013/48/BE. Përveç kësaj, nuk parashihet një marrëdhënie e veçantë ndaj nevojave të personave vulnerabil, të dyshuar dhe akuzuar gjatë realizimit të të drejtave të garantuara me Direktivë.

## Rekomandime

1. Gjykatësit të cilët vendosin për përcaktimin dhe vazhdimin e masës së paraburgimit, ndërsa në raste të veprave më të lehta penale duhet ta marrin parasysh faktin se bëhet fjalë për vepër më të lehtë penale për të cilën nuk duhet të shqiptohet kjo masë, veçanërisht kur bëhet fjalë për persona të rinj të cilët më parë nuk kanë kryer vepër penale.
2. Të përmirësohen kushtet në repartet e paraburgimit dhe t'u sigurohen të drejtat minimale personave të paraburgosur, në përputhje me Ligjin për procedurë penale dhe me standardet ndërkombëtare.
3. Gjatë ndryshimeve dhe plotësimeve të ardhshme të Ligjit për procedurë penale, Ligjit për polici dhe Ligjit për drejtësi për fëmijë duhet të kihet parasysh nevoja e aproksimit midis legjislacionit kombëtar dhe standardeve minimale për mbrojtjen e të drejtave procesuale të personave të dyshuar dhe akuzuar në nivel të BE-së. Për implementim të suksesshëm të zgjidhjeve aktuale dhe të nevojshme, e domosdoshme është analizë gjithëpërfshirëse empirike e zbatimit të të drejtave në sferën e procedurës penale. Në një analizë të tillë duhet të kyçen të gjitha palët e tanguara, siç janë përfaqësuesit e gjyqësisë, prokurorisë, ministrive përkatëse, punonjësit shkencorë, sektori civil, por edhe personat të cilët janë ose kanë qenë të dyshuar dhe akuzuar në procedurë penale.
4. Nevojitet një riformulim ose saktësim plotësues i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale në pjesën e përcaktimit të momentit nga i cili personave të dyshuar dhe të akuzuar duhet t'u sigurohet e drejta, përkatësisht të sigurohen të drejtat në fillim të procedurës paraprake që mbahet para policisë dhe/ose prokurorisë publike. Autoritetet duhet të përipiqen për përfshirjen e përkthyesve dhe interpretuesve në Listën me emra të përkthyesve të përhershëm gjyqësor, të cilët njohin gjuhë të ndryshme nga ato 25 për të cilat ekzistojnë përkthyes, përkatësisht interpretues. Në praktikë, përkthyesi dhe interpretuesi duhet ta flasin gjuhën amë, e jo gjuhën që i akuzuari e kupton pjesërisht.
5. Duhet të zhvillohet mekanizëm ligjor dhe praktik për të përcaktuar nëse personi i dyshuar ose i akuzuar e

- flet dhe e kupton gjuhën e procedurës penale, a ka nevojë për ndihmën e interpretuesit dhe nëse përkthimi dhe interpretimi janë me cilësi që siguron mbrojtje të drejtësisë në procedurë. Ky mekanizëm duhet të aplikohet edhe në kontrollin e cilësisë së përkthimit, përkatësisht interpretimit dhe mundësisë që nëse kjo cilësi është e dobët, interpretuesi ose përkthyesi të zëvendësohet.
6. Nevojitet miratimi i dispozitës ligjore në të cilën vendimi për privim nga liria, kallëzimi penal, propozim/aktakuza, cilido qoftë aktgjykim, si dhe dokumentet tjera që llogariten si thelbësore do të konsiderohen si dokumente që doemos duhet të përkthehen, si dhe mundësia që të dyshuarit, të akuzuarit dhe avokatët e tyre përkthimin e tillë ta kërkojnë nëpërmjet parashtrësës përkatëse dhe të arsyetuar.
  7. Në programet për trajnim të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë të inkorporohet modul për trajnim të detyrueshëm të së drejtës së interpretimit dhe përkthimit në procedurë penale, nëpërmjet të cilës gjykatësit dhe prokurorët publik do të përfitojnë njohuri përkatëse për karakteristikat e të komunikuarit me ndihmën e interpretuesit.
  8. Nevojitet miratim i dispozitave ligjore nëpërmjet të cilave personat e dyshuar dhe të akuzuar do të njoftohen për të drejtën e ndihmës falas juridike dhe kushtet në të cilat ajo mund të realizohet, si dhe përcaktimi i obligimit që personat, të cilët janë të privuar nga liria, të njoftohen për të drejtën e interpretuesit dhe përkthyesit gjatë procedurës policore. Nevojitet edhe miratimi i dispozitës nëpërmjet të cilës do të përcaktohet se policia dhe organet e tjera gjyqësore, duhet të kenë parasysh çfarëdo qoftë nevojë të veçantë të personave vulnerabil të cilët janë të dyshuar ose të akuzuar. Për implementimin e këtij rekomandimi në praktikë është mirë që në lokalet e policisë dhe organeve gjyqësore të ekzistojnë broshura, në disa gjuhë botërore, nëpërmjet të cilave të akuzuarit mund të njoftohen me këtë të drejtë. Ligji për ndihmë juridike falas të ndryshohet në mënyrë që të lehtësohen kriteret për realizimin e të drejtës së ndihmës juridike falas. Diskriminimi të vendoset si sferë në të cilën mundet të lejohet ndihma juridike falas.
  9. Në legjislacionin kombëtar nevojitet që të inkorporohet instituti "Letër mbi të drejtat" që personave të dyshuar dhe të akuzuar t'u dorëzohet me shkrim, në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, kështu do t'u jepet mundësi që ta lexojnë dhe ta mbajnë me vete gjatë privimit nga liria. Përveç informimit për të drejtat themelore, Letra duhet të përmbajë edhe informatë për numrin maksimal të orëve ose ditëve, gjatë të cilave personi i dyshuar ose i akuzuar mund të privohet nga liria para se të nxirret para gjykatës, për mundësinë që të kontestohet ligjshmëria e arrestimit, rishqyrtimin e arrestimit, përkatësisht paraburgimit dhe mundësinë për parashtrimin e kërkesës për lirim me kusht.
  10. Nevojitet miratimi i dispozitës në legjislacionin kombëtar nëpërmjet të cilës policia do të obligohet që personit i cili është i arrestuar ose i paraburgosur t'i sigurojë qasje në dokumentet që konsiderohen thelbësore për kontestimin efektiv të ligjshmërisë së arrestimit ose paraburgimit.
  11. Nevojitet miratim i dispozitës në legjislacionin kombëtar nëpërmjet të cilës e drejta e qasjes deri te avokati do të zbatohet edhe ndaj personave të cilët nuk janë të dyshuar ose të akuzuar, por gjatë procedurës së hetimit nga policia do të përfitojnë një status të tillë, si dhe dispozitave nëpërmjet të cilave do të parashihet marrëdhënie e veçantë ndaj nevojave të personave vulnerabil, të dyshuar dhe akuzuar gjatë realizimit të të drejtave në procedurën penale.

## **ANEKSI I – Modeli indikativ i Letrës mbi të drejtat**

Qëllimi i vetëm i këtij modeli është që t'i ndihmojë autoritetet kombëtare në përpilimin e Letrës mbi të drejtat. Vendet anëtare nuk detyrohen ta shfrytëzojnë këtë model. Kur do t'i përpilojnë letrat e tyre mbi të drejtat, shtetet anëtare mund ta plotësojnë këtë model, me qëllim që ta harmonizojnë me rregullat e tyre kombëtare dhe me informata plotësuese dhe të dobishme. Letrat mbi të drejtat vendet anëtare duhet t'i sigurojnë me patjetër gjatë arrestimit ose paraburgimit. Kjo nuk i parandalon vendet anëtare të sigurojnë njoftime me shkrim për të dyshuarit dhe të akuzuarit në procedura tjera penale.

### **JU I KENI KËTO TË DREJTA**

#### **A. NDIHMË NGA AVOKATI / E DREJTA PËR NDIHMË JURIDIKE**

Keni të drejtë për bisedë të besueshme me avokat. Avokati është i pavarur nga policia. Kontaktoni policinë nëse ju nevojitet kontakt me avokat, policia do t'ju ndihmojë. Në raste të caktuara, ndihma mund të jetë falas. Për më shumë informata kontaktoni me policinë.

#### **B. INFORMIMI PËR AKUZËN**

Keni të drejtë të dini pse jeni arrestuar ose paraburgosur dhe për çfarë dyshoheni ose akuzoheni se keni kryer.

#### **C. INTERPRETIMI DHE PËRKTHIMI**

Nëse nuk e flisni ose kuptoni gjuhën e policisë ose autoriteteve të tjera kompetente, keni të drejtë për ndihmë falas të interpretuesit. Interpretuesi mund t'ju ndihmojë të flisni me avokatin dhe duhet ta ruajë me patjetër përmbajtjen e bisedave në fshehtësi. Më së paku keni të drejtë në përkthim të fragmenteve relevante të dokumenteve të rëndësishme, duke përfshirë çfarëdo qoftë urdhri të gjykatësit me të cilin lejohet arrestimi ose paraburgimi juaj, cilido qoftë kallëzim penal ose propozim / aktakuzë dhe cilido qoftë aktgjykim. Në disa raste mund t'ju sigurohet përkthim me gojë i rezymesë.

#### **Ç. E DREJTA E HESHTJES**

Gjatë marrjes në pyetje nga policia ose autoritetet e tjera kompetente, nuk është e domosdoshme t'u përgjigjeni pyetjeve për veprën e supozuar penale. Avokati juaj mundet t'ju ndihmojë të vendosni për këtë.

#### **Ç. QASJA NË DOKUMENTE**

Kur jeni i arrestuar ose i paraburgosur ju (ose avokati juaj) keni të drejtën e qasjes deri te dokumentet e rëndësishme nëpërmjet të cilave do ta kontestoni arrestimin ose paraburgimit e juaj. Nëse lënda e juaj është dërguar në gjykatë, ju (ose avokati juaj) keni të drejtën e qasjes deri te provat materiale pro apo kundër jush.

#### **D. INFORMIMI I PERSONIT TJETËR PËR ARRESTIMIN OSE PARABURGIMIN TUAJ / INFORMIMI I PËRFAQËSISË SUAJ KONSULLORE**

Kur jeni i arrestuar ose i paraburgosur, duhet t'i thoni policisë nëse dëshironi që të informoni dikë për arrestimin tuaj, për shembull anëtarin e familjes ose punëdhënësin. Në raste të caktuara, e drejta që të informoni personin tjetër për arrestimin tuaj mund të kufizohet. Në rast të tillë, policia do t'ju informojë për këtë.

Nëse jeni person i huaj, duhet t'i thoni policisë se dëshironi që përfaqësia konsullore ose ambasada juaj të informohen. Ju lutemi, t'i thoni policisë nëse dëshironi të kontaktoni ndonjë përfaqësues të përfaqësisë konsullore ose ambasadës tuaj.

#### **DH. NDIHMA URGJENTE MJEKËSORE**

Kur jeni i arrestuar ose i paraburgosur, keni të drejtë në ndihmë urgjente mjekësorë. Ju lutemi, bëjini të ditur policisë se keni nevojë për një ndihmë të tillë.







Институт  
за  
европска  
политика.  
Скопје



ЦЕНТАР ЗА  
УПРАВУВАЊЕ СО  
ПРОМЕНИ

 ХЕЛСИНШКИ 

КОМИТЕТ ЗА ЧОВЕКОВИ  
ПРАВА НА РЕПУБЛИКА  
МАКЕДОНИЈА